



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E DREJTËSISË
 KARTELË SHOQËRUESE E PRAKTIKËS

Dërgues: KLSH

Nr.Prot: 813/9 Data: 31.12.19

Shkurtimi i lëndës: Dergohet raporti perfundimtar

Për trajtim nga:	<i>Ej Ziri / Z. Moran / Z. Thaçi / Z. Thaçi</i>
(struktura të tjera të ngarkuara)	<i>At kontaktet polici i punës për ndryshim dhe zbatim e rishpalljes të KLSH.</i>
Me porosi:	<i>brenda dt. 15/02.</i>

MINISTRI

ZV.MINISTRI

KABINETI I MINISTRIT

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Afati: Normal (7 ditë) Prioritet (3 ditë) Urgjent (brenda ditës) Pa afat/për dijeni
 Tjetër: ___ ditë

Data: 07. 01.2020

Nr.Prot: 7036/15

Nënshkrimi:(TITULLARI)

Marrë në dorëzim: _____ Nënshkrimi _____

Kalon për trajtim (struktura): _____

Me porosinë: _____

Marrë në dorëzim: _____ Nënshkrimi _____

Kalon për trajtim (struktura): _____

Me porosinë: _____

Marrë në dorëzim: _____ Nënshkrimi _____

Kalon për trajtim (struktura): _____

Me porosinë: _____

Trajtimi i materialit përfunduar më: _____,

Specialisti

Trajtimi i materialit përfunduar më: _____,

Eprori në shkallë hierarkike

Trajtimi i materialit përfunduar më: _____,

Eprori në shkallë hierarkike

Trajtimi i materialit përfunduar më: _____,

Eprori në shkallë hierarkike

Sh. Jona
Ministria e Drejtësisë
Ministër i Drejtësisë

7036
MINISTRIA E DREJTËSISË
Nr. 7036/15 Prot.
Datë 07/01/2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa: Rruga "Abdi Toptani" Nr. 1;

E-mail: klsh.org.al; web-site: www.klsh.org.al

Nr. 813/1 Prot.
/9

Tiranë, më 31/12/2019

Lënda: Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për Auditimin me objekt, "Përputhshmëri dhe Rregullshmëri Financiare" të ushtruar në Ministrinë e Drejtësisë

Drejtuar: Znj. Etilda GJONAJ
MINISTËR I DREJTËSISË

TIRANË

E nderuara tj. Ministre,
Nga auditimi "Mbi Përputhshmërinë dhe Rregullshmërinë Financiare", i ushtruar në Ministrinë e Drejtësisë, sipas programit të auditimit nr. 813/1 prot, datë 18.10.2019, për veprimtarinë nga data 01.01.2019 deri më datën 31.10.2019, u konstatuan mangësi dhe parregullsi në veprimtarinë institucionale, në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, të cilat janë trajtuar më hollësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bashkëlidhur kësaj shkrese.

Bazuar në nenet 6, 15, 25 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", si dhe Vendimin nr. 182, datë 31/12/2019, të Kryetarit të KLSH-së¹, për përmirësimin e gjendjes, ju rekomandojmë zbatimin e masave të mëposhtme:

A. OPINIONI I AUDITIMIT

-Nga auditimi mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Ministrisë së Drejtësisë, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat ky institucion realizon misionin e tij, (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), janë konstatuar disa mangësi dhe parregullsi. Gjatë auditimit në terren janë të marrë të dhëna të mjaftueshme të cilat mundësojnë dhënien e opinionit.

Opinion i kualifikuar mbi përputhshmërinë

Sipas opinionit të KLSH-së, nga auditimi i përputhshmërisë¹, i mbështetur në ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin Ministria e Drejtësisë, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat në

¹ Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së"

gjykimin profesional të audituesit shtetëror të pavarur janë materiale por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e *një opinioni të kualifikuar të përputhshmërisë*².

Baza për opinionin e kualifikuar (ISSAI 4000³)

Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs), ISSAI-n 4000 "Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë". Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, mbështetur në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë të ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut dhe materialitetit për subjektin e audituar.

Nga evidencat e marra për veprimtarinë e Ministrisë së Drejtësisë rezultoi se:

Struktura e auditimit të brendshëm paraqitet thujse inekzistente dhe me mangësi personeli të tejzgjatura. Mungon baza ligjore e rregullative për shërbimin e përkthimit dhe prej një kohe të gjatë ka vijuar pagesa e përkthyesve të njohur, të përgjithshme në organet tatimore, e cila krijuan një situatë të disfavorshme dhe jokonkurrese për operatorët ekonomikë të licensuar. Mungon argumentimi, mbi caktimin e numrit të personelit për udhëtimet jashtë vendit si dhe në procedurat e blerjes së biletave në një afat të ngushtë kohor nga dita e nisjes. Transferimi i sistemeve IT, mbetet i përfunduar megjithëse institucioni vazhdon të paguaj nga buxheti i vetë, vlera financiare për mirëmbajtjen e tyre. Nuk arrijnë të zgjidhen në kohë problematikat e shfaqura në institucionet e varësisë. Institucioni vijon funksionimin në mungesë të një rregullore të përshtatur me strukturën e tij organizative. Mungon zbatimi i plotë i dispozitave ligjore që rregullojnë proceset e punës në fushën e MFK-së etj. Mangësitë dhe të metat e mësipërme evidentojnë dobësi në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar të institucionit.

Ne arritëm në konkluzionin se, problematikat e konstatuara kanë ekspozuar institucionin drejt risqeve për përmbushjen e detyrimeve, në zbatim të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë së tij.

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si *më poshtë*:

B. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1- **Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se, shërbimi i përkthimit zyrtar nuk dispononte ende një bazë ligjore të plotë e cila të rregullonte këtë shërbim, kjo sa i përket procedurave të njohjes si përkthyes, licensimin e tyre, si dhe gjithë aspekteve të nevojshme për një profesion i cili nuk mund të kryhet nga çdokush që njeh një gjuhë të huaj. Ky shërbim në dispozitat ligjore aktuale nuk është klasifikuar ende si një profesion i rregulluar dhe ai nuk përfshihet në, profesionet e parashikuara në ligjin nr. 10171, datë 22.10.2009 "Për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Shqipërisë", apo në profesionet e përcaktuara me ligje të veçanta e si i tillë ai nuk gëzon ende bazën e tij rregullative, pavarësisht se "de facto" shërbimi i përkthimit zyrtar mbetet administrativisht i kufizuar, vetëm për personat emrat e të cilëve publikohen nga Ministria e Drejtësisë çdo vit në faqen e saj zyrtare. Në vijimësi, Ministria e Drejtësisë ka thirrur konkurrime për njohje/kontraktim referuar udhëzimeve të

² Një opinion i kualifikuar shprehet kur efekti ose efektet e mundshme të një çështjeje, nuk janë aq materiale sa të justifikojnë dhënien e *opinionit të kundërt* ose një *refuzim të opinionit*

³ ISSAI 4000 – Udhërrëfytyri i Auditimit të Përputhshmërisë

përbashkëta të hartuara midis Ministrisë së Drejtësisë dhe ish Ministrisë së Financave të cilët përcaktonin kriteret e përzgjedhjes për përkthyes të jashtëm dhe tarifën e shërbimit për ata që do të kontraktoheshin nga Ministria e Drejtësisë. Për këtë procedurë institucioni i është referuar Udhëzimit të përbashkët nr. 3165 datë 12.05.2004, i ndryshuar, për njohjen e përkthyesve dhe kontraktimin e tyre, udhëzim i cili në pjesën hyrëse ku trajtohet mbështetja e tij ligjore, i referohet nenit 12 të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, dispozitë kjo e shfuqizuar rreth 12 (dymbëdhjetë) vite më parë, e megjithatë ai është përdorur në vijimësi si bazë për njohjen e përkthyesve të rinj si dhe kontraktimin e plotë të trupës përkthyesë çdo vit. Pra edhe pa një bazë ligjore të dedikuar për përfitimën e titullit “përkthyes zyrtar” institucioni ka vijuar konkurrimet dhe kontraktimet.

Problematikë shfaqet edhe në aspektin e ndarjes së drejtë të punës tek përkthyesit e listës me të cilët është lidhur kontrata vjetore, si dhe risqet e mundshme për përkthimin e materialeve me rëndësi të veçantë, apo të dokumenteve të klasifikuar. Pavarësisht detyrimit ligjor të Ministrisë së Drejtësisë për përkthimin e akteve në afate ligjore të përcaktuara, kryerja në mënyrë dinamike e këtij shërbimi brenda kornizave ligjore dhe administrative është gjithashtu një detyrim ligjor dhe përzgjedhja subjektive e përkthyesve nuk legjitimohet nga kërkesat e ngutshme për përkthime nga ana e saj. Problematikat e përmendura më sipër evidentojnë nevojën për një rregullim të ri ligjor mbi profesionin e “Përkthyesit zyrtar” duke iu referuar ligjit organik të MD, ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 5 pika 3, neni 52 pika 3, etj. Nevojë për rregullim paraqet edhe procesi i përzgjedhjes së përkthyesve të jashtëm për shërbimet e kërkuara nga ana e ministrisë, duke u orientuar drejt trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues në përzgjedhje, si dhe reduktimin e riskut në nxjerrjen e informacionit të klasifikuar gjatë procesit të përkthimit. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 63-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

1.1 Rekomandimi: Ministria e Drejtësisë, të ndër marrë nismat e nevojshme administrative e ligjore për plotësimin e kuadrit ligjor për “Përkthyesin zyrtar”, për të garantuar profesionistë mbi bazën e meritokracisë, shërbime përkthimi sa më cilësore dhe një veprimtari të rregulluar nga akte ligjore të mirëpërcaktuara.

Brenda datës 29.02.2020

1.2 Rekomandimi: Ministria e Drejtësisë, të plotësoj gjithashtu bazën ligjore mbi procedurat e përzgjedhjes dhe kontraktimit të përkthyesve të jashtëm, duke u orientuar drejt trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues të operatorëve ekonomikë si dhe duke treguar vëmendje të veçantë në reduktimin e riskut të mundshëm për rrjedhjen e informacionit të klasifikuar gjatë procesit të përkthimit.

Brenda datës 29.02.2020

C. MASA ORGANIZATIVE

1- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Drejtësisë rezultoi se,

a. Kjo njësi auditimi referuar strukturës organizative të miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 238 datë 13.12.2017 është e organizuar në nivel drejtorie dhe ka të parashikuar një staf prej pesë punonjësish (1+4), Drejtorin dhe 4 specialistë. Prej muajit Dhjetor 2017 pozicioni i drejtuesit të kësaj njësie rezulton vakant duke krijuar një boshllëk në drejtimin e saj. Me Urdhrin nr. 2969 datë 12.03.2018 të Ministrit të Drejtësisë, një specialist i kësaj drejtorie është caktuar për kryerjen e detyrave të Drejtorit në DAB deri në emërimin e drejtuesit të përhershëm. Drejtuesi i komanduar e ka ushtruar funksionin deri në marrjen e masës së pezullimit ndaj tij në muajin Tetor 2019. Aktualisht kjo drejtori megjithëse ka si objekt auditimi aparatit e MD-së dhe rreth 34 institucione varësie, funksionon vetëm me dy auditues, nga të cilët një auditues është emëruar në këtë funksion më datë 23.08.2019 dhe

ndodhet në periudhë prove. Kjo përbërje, krijon risk të lartë për drejtimin, sai përket funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë e varësisë, por dhe vetë Mministrinë e Drejtësisë.

b. Sipas të dhënave rezultoi se, DAB ka hartuar planin vjetor të auditimit për vitin 2019 dërguar Drejtorisë së Harmonizimit Financiar në të cilin parashikohet të realizohen 12 auditime nga 17 të tillë të parashikuar në planin strategjik 2018-2020, pra me 5 (pesë) auditime më pak. Për periudhën nën auditim Janar-Tetor 2019 janë zhvilluar 7 (shtatë) angazhime auditimi nga të cilat, 3 (tre auditime) janë auditime të paplanifikuara në planin vjetor dhe vetëm 4 (katër) janë pjesë e planit. Nga angazhimet e zhvilluara gjithsej, në 3 (tre) auditime ka përfunduar angazhimi, në 2 (dy) auditime është hartuar raporti paraprak dhe në 2 (dy) raste auditimi ndodhet në proces. Në materialet e paraqitura nuk gjenden shpjegime lidhur me devijimet në planin vjetor dhe shtimin e tre auditimeve të reja. Gjithashtu ndryshimet e planit nuk rezultojnë të jenë miratuar prej Komitetit të Auditimit të Brendshëm referuar VKM nr. 114 datë , Kreu III. pikës 1/b të tij.

c. Në planin vjetor të auditimeve për vitin 2020 nuk rezultojnë të jenë përfshirë auditimet të cilat nuk mund të realizohen gjatë vitit 2019 të cilat aktualisht janë 8 (tetë) të tillë. Nga të gjitha hallkat përgjegjëse, për hartimin, monitorimin si dhe miratimin e planit vjetor mungojnë shpjegimet lidhur me spostimin/anashkalimin e subjekteve të parashikuara për auditim gjatë vitit 2019 por të përealizueshëm në kushtet aktuale. Mospërfshirja e tyre në planin e ardhshëm si auditime të përealizuara, shkaktohet vijueshmërinë dhe ul besueshmërinë për hartimin e një plani bazuar në një vlerësim objektiv të riskut për vitin në vijim.

Për periudhën nën auditim Janar-Tetor 2019, nëse do të shohim veprimtarinë audituese në harkun kohor do të shohim se, ajo zë vetëm një pjesë të shkurtër kohore përgjatë periudhës dhe mbulimi me auditim nuk ka qenë i plotë duke sjellë mosezaurim të planit vjetor të parashikuar.

d. Në angazhimet e kryera gjatë periudhës nën auditim rezultoi se, thuajse në të gjitha rastet njësia që do të auditohej nuk është njoftuar 10 ditë përpara si dhe në dosje nuk gjendet argumentim lidhur me këtë mungesë si përcaktohet në pikën 4.1.4 të Manualit të Auditimit të Brendshëm/2016.

Në planin e auditimit për vitin 2019 por dhe planet strategjike 2018-2020 dhe 2019-2021 nuk parashikohen auditime tematike për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna drejt subjekteve të audituar.

Mungesa e veprimeve aktive për zbatimin e rekomandimeve në një kohë të shpejtë nuk i lejon manaxhimin të lartë mundësi të informohet mbi masat e marra nga subjekti i audituar, çka mund të ndikojë në ngadalësimin e zbatimit apo mospëzbatim të tyre.

Në programet e auditimit përfshihet si drejtim i veçantë auditimi dhe Teknologjia e Informacionit, megjithëse specialistët në grupet e auditimit nuk janë të diplomuar apo të kenë formim profesional të nevojshëm për këtë fushë auditimi referuar pikës 2.4.4 të Manualit të Auditimit/2016. Auditimi për këtë fushë mjaftohet me verifikime sipërfaqësore dhe nuk jep siguri mbi sistemet e audituara.

Stafi i paplotësuar gjatë periudhës nën auditim, tkurrja e numrit të auditimeve gjithsej, përzgjedhja tematike, shpërndarja disproporcionale sipas periudhave, të programeve të auditimit, si dhe afatet e shkurtra për përmbushjen e tyre, nuk krijojnë siguri të arsyeshme për përmbushjen e plotë dhe me cilësisë të objektivit të kësaj strukture për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë e sektorit publik. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 46-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

1.1 Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, të merren masa, për plotësimin e vendeve vakante në strukturën e miratuar në nivel specialisti dhe Drejtuesi si dhe të ndërmerren hapat e nevojshëm administrativë dhe ligjorë për zgjerimin e kësaj strukture, me qëllim garantimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe evidentimin e rasteve të keqpërdorimit të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike.

Menjëherë

*Si përmirësim
detyrë për Auditues*

1.2 Rekomandimi: Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të rishikoj planin vjetor për vitin 2020 duke përfshirë në të edhe subjektet të cilat nuk janë audituar prej saj gjatë vitit 2019. Plani i rishikuar, pas mendimit të Komitetit të Auditimit dhe miratimit nga Titullari i Institucionit, të paraqitet rregullisht pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit në MFE me shpjegimet përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

1.3 Rekomandimi: Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të programoj auditime të plota, brenda afate të arsyeshme, dhe të shtrirë në gjithë periudhën vjetore, duke respektuar rigorozisht periudhën e njoftimit si dhe të gjitha hapat e tjerë të hartimit, miratimit dhe dërgimit të raporteve përkatës drejt subjektit të audituar, duke mos krijuar tejkalime afatesh procedural të cilët krijojnë risk të lartë në veprimtarinë e kësaj njësie.

Në vijimësi

2- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, në raportin Përfundimtar të Auditimit të mbajtur nga DAB të Ministrisë së Drejtësisë pranë Drejtorisë së Përmbarimit Tiranë, janë evidentuar të ardhura të realizuara të pa derdhura në buxhetin e shtetit konkretisht, të ardhurat e krijuara për vitin 2017 dhe 10/mujorin e vitit 2018 e cila përbëhet nga gjoha gjyqësore, të ardhura nga interesi, tarifë ekzekutimi në shumën **45,431,414 lekë**, nuk janë administruar konform Ligjit nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare“, neni 6 “Transferimi i të ardhurave nga taksat kombëtare në Buxhetin e Shtetit“, neni 11 “Tarifa shërbimi“, 11/2 “Deklarata për pagesën e tarifave kombëtare” dhe këto të ardhura të krijuara në vite nuk janë derdhur në Buxhetin e Shtetit brenda 15 ditëve nga përfundimi i muajit në të cilin është kryer arkëtimi, si parashikohet në legjislacionin përkatës, por janë lënë në llogarinë përmbarimore pranë bankave të niveleve të dyta, megjithëse kuadri ligjor ka qenë i plotë për transferimin e tyre në Buxhetin e Shtetit. Po kështu zëri “Të tjera” në këtë llogari, në shumën 32,511,553 lekë, nuk është sistemuar sipas dosjeve në ekzekutim (debitorëve) në mënyrë analitike. Nga ana e DAB janë rekomanduar masat përkatëse drejtuar kësaj njësie për përmirësimin e gjendjes por nuk janë marrë masa për shtrirjen e rekomandimit në sistem, pasi fenomeni mund të paraqitet i shtrirë edhe në subjekte të tjerë të kësaj natyre. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 46-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të dërgoj një kopje të raportit të Auditimit të mbajtur pranë Drejtorisë së Përmbarimit Tiranë në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarimit dhe të kërkoj, ndjekjen nga ana e saj të problematikës së degëve nëpërmjet nxjerrjes së shkresave njoftuese/qarkoreve lidhur me “Llogarinë Përmbarimore”, me theks të veçantë derdhjen në buxhet të të ardhurave përmbarimore (tarifë/gjobë/interesa) si dhe sistemimin e zërit “Të tjera” në këtë llogari.

Brenda datës 31.01.2020

3- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i KLSH i cili u krye paralelisht edhe në Institutin e Mjekësisë Ligjore, institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, mbi bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit mbi realizimin e procedurave të prokurimit publik, në zbatim të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 56 (titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar), rezultoi se;

-Drejtuesi i institucionit z. Bledar Xhemali nuk gjendet në cilësinë e Nëpunësit Autorizues (NA) të institucionit, por në këtë cilësi është caktuar zj. Valbona Sulejmanllari me detyrë “Përgjegjës sektori në sektorin e menaxhimit të akteve dhe laboratorit”. Kjo sipas shkresave të Ministrisë së Drejtësisë nr. 5083 prot, datë 22.09.2017 dhe nr. 12396/1 prot, datë 19.09.2017 nga Ministria e Financave me lëndë “Mbi caktimin e Nëpunësit Autorizues të Përkohshëm për IML” sipas rrethanave faktike dhe juridike, si më poshtë vijon:

-Evidentohet se, B.Xhemali gëzon statusin e nëpunësit civil, pasi ka filluar marrëdhënien e punës në këtë institucion, me aktin administrativ nr. 5762/1 prot, datë 26.11.2013, të Ministrit, në pozicionin "Drejtor i Institutit të Mjeksisë ligjore" të cilin e ka mbajtur deri më datë 20.06.2017, deri në daljen e aktit administrativ nga ish-Ministri i Drejtësisë me shkresë nr. 4052/3 datë 20.06.2017 "Njoftim mbi fillimin e ecurisë disiplinore", shoqëruar me vendimin përfundimtar nr. 4052/8 prot, datë 28.06.2017 "Për marrjen e masës disiplinore "largim nga shërbimi civil" për z.Bledar Xhemali."

Për sa më sipër, Z.Xhemali e ka ankimuar këtë vendim, duke rifituar vendin e punës dhe rikthimi në detyrë në bazë të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nr. 3462 datë 13.09.2017, me ekzekutim të përkohshëm, deri në daljen e vendimit të Gjykatës së Apelit Administrativ (vendimi është në proces ankimi nga MD).

Evidentohet vonesë në lidhje me miratimin e nëpunësit autorizues (NA) nga Ministria e Drejtësisë në koordinim me Ministrinë e Financave, pasi referuar situatës së trajtuar më sipër ky vendim është marrë i mirëqenë dhe si rrjedhojë me ardhjen në detyrë të z. Bledar Xhemali (Drejtor IML) duhet që t'i kalonin dhe detyrat e NA që janë të përcaktuara në bazë të ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar neni 19, ligji nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar neni 12, për rrjedhojë dhe ushtrimin e kompetencave në fushën e prokurimeve publike në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 56 (titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar).

Gjithashtu, rezultoi se, nga Ministria e Drejtësisë, nuk është bërë ende kërkesë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për ndryshimin e Nëpunësit Autorizues të Përkohshëm, ndonëse nga IML me shkresat nr. 1616 prot, datë 21.09.2018 dhe nr. 1855 prot, datë 09.03.2019, është kërkuar ndryshimi respektiv për caktimin e titullarit të institucionit në pozicionin e nëpunësit autorizues. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 63-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Se gjatë auditimit në bazë të kësaj

3.1 Rekomandimi: Nga Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të merren masa për emërimin dhe realizimin e ndryshimit të Nëpunësit Autorizues të Përkohshëm, referuar shkresës së IML me nr. 1616 prot, datë 21.09.2018 dhe nr. 1855 prot datë 09.03.2019, me të cilat është kërkuar ndryshimi respektiv, për caktimin e titullarit të institucionit z. Bledar Xhemali në pozicionin e nëpunësit autorizues.

Menjëherë

4- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, për periudhën Janar -Shtator 2019 u evidentuan mospërputhje midis vlerës totale të Fondit të Pagave Bruto dhe Listëpagesave mujore. Sipas librit të pagave Fondi Bruto paraqitej në shumën 98,107,476 lekë, ndërsa pasqyrimi në listëpagesën mujore të deklaruar pranë organeve tatimore ishte paraqitur në shumën 98,582,444 lekë me një ndryshim në (+474,968 lekë).

Po kështu vlera e pagave neto të punonjësve për këtë periudhë sipas librit të pagave paraqitej në shumën 76,392,807 lekë, ndërsa llogaritja e pagës neto pas ndalesave të punëmarrësit sipas listëpagesës mujore të deklaruar pranë organeve tatimore llogaritej në shumën 76,861,999 lekë, me një ndryshim në (+469,192 lekë). Diferencat e evidentuara midis dy dokumenteve nuk janë të argumentuara dhe përbëjnë një pasqyrim jo të saktë të treguesve, librit të pagës dhe listëpagesës mujore të deklaruar. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 32-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Te jepet opinion nga financiar

4.1 Rekomandimi: Ministria e Drejtësisë, të marri masat e nevojshme për kontabilizimin e saktë të pagave dhe kontributeve në sistemin informatik për periudhën Janar-Shtator 2019 dhe kuadrin e vlerave midis librit të pagave dhe listëpagesave mujore.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICËNCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi pagesat e kryera nga Ministria e Drejtësisë gjatë periudhës Janar-Shtator 2019, rezultoi se, gjatë kësaj periudhe janë kryer pagesa për përkthyesit e njohur nga kjo ministri në listat zyrtare të publikura të cilët sipas të dhënave të institucionit ishin të pa regjistruar në organet tatimore dhe ndaj tyre është mbajtur tatim në burim në masën prej 15 përqind të vlerës së shërbimit, i cili më pas është paguar nga MD në buxhetin e shtetit në shumën 8,812,236 lekë. Me këtë mënyrë veprimi institucion vijonte prej vitesh.

Vlera totale e shërbimit të kryer nga kjo kategori përkthyesish është **58,748,240 lekë** (8,812,236/15%) ose rreth ¼ e shpenzimeve 9 mujore. Vlerat e përkthimit të paguara prej saj janë bazuar në Udhëzimin e përbashkët MD dhe MF nr. 3165 datë 12.05.2004 “Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes, dhe tarifat e shpërblimit të përkthyesve të jashtëm, si dhe tarifat e përkthimit zyrtar që duhet të paguajnë të tretët” ndryshuar me udhëzimin e përbashkët botuar në fletoren zyrtare nr. 63/2005.

Në Ministrinë e Drejtësisë përkthimi i materialeve të cilat dërgohen drejt institucioneve homologe apo anasjelltas kryhen aktualisht nëpërmjet:

- ✓ përkthyesve të punësuar pranë institucionit
- ✓ përkthyesve të njohur të listës të regjistruar pranë organeve tatimore
- ✓ përkthyesve të njohur të listës të pa regjistruar pranë organeve tatimore

a. Evidentohet se, institucioni nuk disponon një mekanizëm të plotë dhe transparent për shpërndarjen e materialeve të përkthimit drejt përkthyesve të njohur prej saj duke bërë që një numër i kufizuar përkthyesish të kryejnë shërbimin në favor të kësaj ministrie por edhe prej tyre të ketë diferenca domethënëse në vlerat e përfituara, çka në situatën e një çmimi fiks të rregulluar “përkthehet” në më shumë punë e marrë. Kjo mënyrë ka krijuar pabarazi në këtë kategori profesioni ende “të parregulluar”.

b. Kontraktimi individual i përkthyesve të cilët megjithëse ushtrojnë veprimtari fitimprurëse nuk janë të regjistruar në organet fiskale siguron një trajtim të pabarabartë dhe diskriminues si dhe krijon një standard jo të përshtatshëm institucional. Nga përkthyesit e kontraktuar kategoria “Të regjistruar” janë pagues të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, tatimeve, TVSH apo Tatim i Thjeshtuar mbi Fitimin/ Tatim mbi Fitimin si dhe Taksa vendore ndërsa kategoria “Të paregjistruar” taksohet në mënyrë lineare me nivelin 15% Tatimit në Burim. Edhe nëse të licensuarit do të kontribuonin/paguanin në buxhetin e shtetit njëllon në vlerë absolute, përsëri orientimi tek kategoria e të paregjistruarve, do të ishte e padrejtë, pasi në këtë mënyrë kjo vlerë shërbimi nuk do të ndihmonte zhvillimin dhe forcimin e profesionistëve të licensuar të cilët janë të lidhur drejtpërdrejtë me këtë veprimtari në të ardhurat e tyre, ndryshe nga kategoria tjetër të ardhurat e të cilës u referohemi si të ardhura plotësuese. Aktualisht mënyra e veprimit nga ana e institucionit lë pjesën e konsiderueshme të shërbimit/të ardhurave tek kategoria e dytë e përkthyesve, pra atyre të paregjistruar.

Në dispozitat ligjore aktuale për kryerjen e pagesave nga insitucionet publike ndeshemi vetëm me termin “operator ekonomik” referuar ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 52 “Kryerja e shpenzimeve”, ku sqarohet qartë mënyra si kryhet pagesa ndaj “operatorit ekonomik” dhe dokumenti përkatës për tu paraqitur për pagesë. Pra dokumenti bazë i cili rregullon, strukturën, parimet dhe bazat e procesit buxhetor, marrëdhëniet financiare mbi të cilat kryhet pagesa, jep në mënyrë shteruese mënyrën e pagesës dhe definicionin e “përfituesit”. Gjithashtu mënyra e dakordësuar nga MD bie në kundërshtim edhe me parashikimet ligjit nr. 9920 “Për Procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, neni 41 “Identifikimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare pa u regjistruar”, pika 1 dhe 2 e tij. Nëse organet tatimore do të evidentonin raste pagesash për përkthyes të paregjistruar, ato menjëherë duhet të merrnin masat e parashikuara në legjislacionin tatimor, bllokim deri në heqje të licencës për një periudhë gjashtëmujore

për këta përkthyes referuar dispozitave të mësipërme. Në këtë rast organet tatimore hipotetikisht duhet ti drejtoshin vet MD për zbatimin e këtyre masave. Pra shihet qartë se pagesa e drejtpërdrejtë ndaj individëve referuar dispozitave të mësipërme, por jo vetëm, paraqesin mospërputhje të plotë me legjislacionin në tërësi.

c. Moment tjetër me rëndësi nga ana jonë lidhur me përkthimet e akteve është siguria mbi dokumentacionet e përkthyer nga operatorët e regjistruar dhe individët të cilët ndryshe nga subjektet e regjistruar janë më pak të shfaqur në aspekt të transparencës dhe veprimtarisë publike. Pavarësisht kësaj, mungesa e një sistemi rregullator lidhur me marrjen në dorëzim të dokumentacionit, në vlerësimin tonë e ka ekspozuar njësinë drejt risqeve të vazhdueshëm në këtë drejtim për të dy kategoritë e përkthyesve të kontraktuar.

Sa më lartë arrijmë në konkluzionin se, vlera prej **58,748,240 lekë** e shpenzuar nga ana e institucionit për shërbime përkthimi në përkthyes të paregjistruar nuk rezulton të ketë patur efektivitetin dhe eficientën e pritshme. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 63-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

1.1 Rekomandimi: Nga Ministria e Drejtësisë, të merren masat e nevojshme për ndërprerjen e shërbimeve të marra nga përkthyes të paregjistruar në organet fiskale, kjo në zbatim të dispozitave ligjore që rregullojnë, funksionimin e sistemit buxhetor, taksat dhe tatimet, si dhe për të shmangur diskriminimin e operatorëve ekonomikë kundrejt konkurrencës së pandershme.

Menjëherë

1.2 Rekomandimi: Nga Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me organet përkatëse, të merren masat e nevojshme hartimin e një baze rregullative mbi përkthimin e dokumentacioneve të klasifikuara, me qëllim eliminimin e risqeve të mundshëm gjatë kësaj veprimtarie.

Menjëherë

2- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, Ministria e Drejtësisë vijon të paguajë pa të drejtë nga buxheti i vetë kostot e mirëmbajtjes për katër nga pesë sistemet të cilat janë në funksionim. Vetëm gjatë periudhës Janar-Tetor 2019 shpenzimet e mirëmbajtjes së tyre arrijnë shumën prej **5,862,400 lekë** ndërkohë që këto shpenzime duhet të ishin përballuar nga AKSHI. Në kontratën e mirëmbajtjes të lidhura midis MD dhe operatorit ekonomik fitues nuk janë reflektuar ende ndryshimet e parashikuara në pikën 18 dhe 19, dhe 24 të VKM nr. 673, datë 22.11.2017, "Për Organizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, e ndryshuar,

Mospërfundimi i procesit të transferimit të sistemeve pranë AKSHI-t referuar përcaktimeve ligjore në fuqi e kanë ekspozuar institucionin drejt shpenzimeve të panevojshme nga buxheti i vetë lidhur me shpenzimet e mirëmbajtjes për këto sisteme por jo vetëm. Megjithëse dy nga pesë sistemet funksionale TI janë alokuar fizikisht tek AKSHI, ato vijnë të reflektohen në regjistrin e aktiveve të Ministrisë së Drejtësisë, çka tregon mangësi dhe veprime të ngadalta nga ana e grupeve të punës të institucioneve respektive. Vlera e shpenzuar nga ana e institucionit për mirëmbajtjen e sistemeve TI, prej **5,862,400 lekë**, përbën një shpenzim të kryer, jo në përputhje me parimet e efektivitetit dhe eficientës. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 46-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

2.1 Rekomandimi: Institucioni të marrë masat e nevojshme, për hostimin e sistemeve IT pranë AKSHI-t referuar përcaktimeve të VKM nr. 673 datë 22.11.2017, e ndryshuar, duke dokumentuar plotësisht transferimin e tyre fizik dhe kontabël si dhe eliminimin e kostove të panevojshme nga buxheti i institucionit për shërbimet e mirëmbajtjes së tyre.

Menjëherë

3- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, pjesën më të madhe në zërin "shpenzime" ose rreth 33% e tyre, e zënë blerjet nëpërmjet sistemit dinamik të biletave të transportit ajror ndërkombëtar. Për

vitin 2019, ky zë është parashikuar në vlerën 7,000,000 lekë dhe deri në periudhën 30.10.2019 (periudha objekt i auditimit) është realizuar në vlerën 5,634,090 lekë.

Në 07 (shtatë) procedura të audituara nga 32 gjithsej, me një vlerë shërbimi të paguar që shkon **2,464,643 lekë**, dokumentacioni bashkëlidhur praktikës nuk arrin të argumentoj numrin e nevojshëm për pjesëmarrje në këto takime/evente.

Në të gjitha rastet procedura realizohet në një afat shumë të shkurtër nga data e udhëtimit, duke sjellë si pasojë, mungesë të studimit të tregut rrjedhojë e afateve të limituara dhe rrit riskun e përzgjedhjes së çmimit më të lartë, pasi biletat e avionit bliheshin ditën e nisjes apo ditë të afërt me nisjen, kur edhe çmimet kapin nivelet e tyre të larta.

Mbi mungesën e argumentimit të numrit të pjesëmarrësve në procedurat e sistemit dinamik të blerjeve për bileta të transportit ndërkombëtar, Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 20468 prot, datë 11.11.2019, ka sjellë gjithashtu në vëmendje të Ministrisë së Drejtësisë shpenzimet për udhëtime dhe dieta, si dhe marrjen e masave të menjëhershme për kufizimin e numrit të pjesëmarrësve, pasi nga analiza e kryer nga kjo ministri mbi përdorimin e fondeve buxhetore vërehen rritje të konsiderueshme të nivelit të shpenzimeve në zërin udhëtime dhe dieta për periudhën Janar-Tetor 2019. Lidhur sa më sipër, evidenton nevojën për një qasje më të kujdesshme nga ana e hallkave përkatëse për përdorimin me ekonomikitet të fondeve shtetërore në këtë drejtim. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 37-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

3.1 Rekomandimi: Nga Titullari i Institucionit, të merren masa që pas ardhjes së ftesës nga organizatorët për takime/evente jashtë vendit, të nxirret menjëherë autorizimi i pjesëmarrjes në to, në mënyrë që të minimizohet risku i blerjes së biletave me çmim më të lartë si rezultat i kryerjes së procedurës së prokurimit në data të afërta me datën e nisjes së udhëtimit.

3.2 Rekomandimi: Të argumentohet numri i pjesëmarrësve në takime/vente të organizuara jashtë vendit në mënyrë që të optimizohet numri i tyre dhe për rrjedhojë dhe shpenzimet që kryhen për këtë qëllim.

Në vijimësi

E. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenet 58 dhe 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, *i rekomandohet* Titullarit të institucionit, që nëpërmjet një grupi pune, të bëjë vlerësimin dhe shqyrtimin e shkeljeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit sipas përgjegjësisë individuale dhe të nisë menjëherë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse.

F. SHËNIM I KRYETARIT

Për Shkak se:

a. Procedura e prokurimit ” Rehabilitimi emergjent i arkivës dhe rrjeti kompjuterik i zyrës së arkiv-protokollit të Ministrisë së Drejtësisë” me fond limit në vlerën prej 60,208,742 lekë pa tvsh, nuk u auditua sepse grupi i auditimit nuk dispononte certifikatë sigurie për auditimin e kësaj procedure sipas kërkesave të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror” i ndryshuar, dhe akteve nënligjore përkatëse;

b. Koha e auditimit në dispozicion të grupit të auditimit ishte e kufizuar;

c. Ankesa e z. Drita nuk u trajtua në këtë auditim për shkak të afateve të auditimit dhe shtrirjes në kohë të çështjeve të ngritura.

Kontrolli i Lartë i Shtetit (Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore), në tremujorin e dytë të vitit 2020 do të përsërisë këtë auditim për të gjithë periudhën e vitit 2019, me qëllim që rezultatet e këtij auditimi të pasqyrohen në Raportin e Zbatimit të Buxhetit Faktik 2019, i cili do të paraqitet nga KLSH në Kuvendin e Shqipërisë në fund të muajit Shtator 2020.

Gjithashtu, Kontrolli i Lartë i Shtetit do të ndjek me vëmendje të veçantë dhe do vlerësojë marrjen e masave, nga Ministria e Drejtësisë për zbatimin e rekomandimeve të lëna ku midis të tjerash do të veçonim, plotësimin e boshllëkut ligjor lidhur me profesionin e përkthyesit ligjor si dhe rregullimin e procesit të kontraktimit të shërbimit të përkthimit nga institucioni, riformatimin e strukturës së auditimit të brendshëm dhe përmirësimin cilësor të saj, reflektimin e dobësive në shpenzimet e kryera për pjesëmarrjet në evente, etj.

Përmbushja e plotë e këtyre rekomandimeve por edhe masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të KLSH^{së}, por të gjendura në proces zbatimi, do të jenë në fokusin e auditimeve vijuese në këtë institucion.


Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” për masat e marra nga ana Juaj të përgatiten programe me afate dhe persona përgjegjës dhe për zbatimin e rekomandimeve të njoftohet Kontrolli i Lartë i Shtetit **brenda 20 ditëve** nga marrja e kësaj kërkesë.

Në vijim e në zbatim të nenit 30, pika 2 e këtij ligji, kërkohet ndjekja e realizimit të tyre në vazhdimësi duke nxjerrë aktet e nevojshme administrative dhe nisjen e procedurave disiplinore e administrative apo hartimin e padive gjyqësore për shpërblimin e dëmit dhe mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna, nga ana Juaj të raportohet (*me shkrim*) pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit **brenda 6 muajve** nga marrja e njoftimit të Raportit Përfundimtar të auditimit dhe rekomandimeve.

me respekt

Bujar LESKAJ





◆
KONTROLLI I PARTI
V. 2
KONTROLLI I PARTI
◆

RAPORT PËRFUNDIMTAR

PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË

MINISTRINË E DREJTËSISË

Tiranë, 2019



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E
DREJTËSISË”

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI
“PËRPUTHSHMËRI DHE RREGULLSHMËRI FINANCIARE”

		<i>Faqe</i>
I	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	2-6
II	HYRJA	6-8
a.	Qëllimi dhe Objektivat	7-7
b.	Identifikimi i çështjes	7-7
c.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	8-8
d.	Përgjegjësitë e audituesve	8-8
e.	Kriteret e vlerësimit	8-9
f.	Standardet e auditimit	9-9
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	10-10
IV	GJETJET DHE REKOMANDIMET	11-70
	Drejtimi 1: <i>Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm:</i>	11-32
	Drejtimi 2: <i>Përputhshmëria ligjore për marrëdhëniet e punës dhe të pagave, realizimi i fondit të pagave, shpërblimeve, sigurimeve shoqërore e të tjera personeli:</i>	32-37
	Drejtimi 3: <i>Auditimi i veprimeve financiare të institucionit:</i>	37-43
	Drejtimi 4: <i>Prokurimet e fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime:</i>	43-46
	Drejtimi 5: <i>Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe veprimtarisë së strukturës së auditimit të brendshëm:</i>	46-62
	Drejtimi 6: <i>Probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit:</i>	63-70
V	KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT	71-80
VI	ANEKSE	81-82



KONTROLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në "MINISTRINË E DREJTËSISË"

I- PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Një përshkrim i shkurtër i auditimit

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi "Ministrinë e Drejtësisë", më poshtë e emërtuar "MD", për periudhën 01.01.2018 deri më 30.10.2019 me objekt "Auditim përputhshmërie dhe rregullshmërie financiare" Auditimi u orientua në pesë drejtime kryesore të përcaktuara në programin e auditimit. Në këtë auditim u angazhuan 5 (pesë) auditues të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Konkluzionet përkatëse paraqiten në mënyrë më të hollësishme në pjesën e IV dhe V, të këtij Raporti Përfundimtar dhe konsistojnë kryesisht në;

-Institucioni ka funksionuar për një kohë të gjatë në mungesë të një rregullore e cila të përshtatet me strukturën e tij organizative. Pavarësisht deklarimeve pranë DAP, institucioni vijon me një numër të lartë vendesh pune vakantë, mes të cilëve evidentohen edhe nivel drejtues. Evidentohen mangësi në procesin e blerjes së biletave për takime/vente ndërkombëtare dhe nuk arrin të argumentohet qartë nevoja e numrit të pjesëmarrësve në to.

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm paraqitet thajse "amorfe" sa i përket numrit të personelit por edhe duke mos përbushur rolin e saj, si "garant" për funksionimin e sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit. Nuk arrin të zgjidhen në kohë problematikat e shfaqura në institucionet e varësisë si në rastin e Nëpunësit Autorizues të Institutit të Mjekësisë Ligjore. Mungon një bazë e konsoliduar rregulluese mbi profesionin e përkthyesit zyrtar, si për procedurat konkurruese për njohjen edhe kontraktimin e tyre prej MD-së. Përkthimet pavarësisht karakterit sekret ose jo, janë kryer nga individë të cilët janë njohur nga MD si përkthyes por që rezultojnë të paregjistruar në organet tatimore, çka ka stimuluar konkurrencë të padrejtë drejt operatorëve ekonomikë dhe në mungesë të akteve rregullues, informacionet e klasifikuara mbeten të ekspozuara drejt risqeve të larta. Evidentohen procedura të paplota për transferimin e sistemeve IT duke riskuar kryerjen transferimit sipas detyrimeve ligjore. Megjithëse dy prej tyre fizikisht janë hostuar tek AKSHI, vlerat kontabël të tyre vijnë të reflektohen në regjistrin e aktiveve të Ministrisë e cila vijon të paguajë me pa të drejtë nga buxheti i vetë, shpenzimet e mirëmbajtjes për to. Mungon zbatimi i plotë i dispozitave ligjore që rregullojnë proceset e punës në fushën e MFK-së etj.

Në përfundim të procedurës audituese, akt-konstatimit, Projekt Raportit të mbajtur, observacioneve të paraqitura, u rekomanduan masat përkatëse për përmirësimin e situatës.

I.b. Një përmbledhje e gjetjeve kryesore dhe rekomandimet përkatëse paraqitet sa më poshtë:

NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDË SIA	REKOMANDIMI
1.	Nga auditimi mbi pagesat e kryera nga Ministria e Drejtësisë gjatë periudhës Janar-Shtator 2019, rezultoi se, gjatë kësaj periudhe janë kryer pagesa për përkthyesit e njohur nga kjo ministri në listat zyrtare të publikura të cilët sipas të dhënave të institucionit ishin të pa regjistruar në organet tatimore dhe ndaj tyre është mbajtur tatim në burim në masën prej 15 përqind të vlerës së shërbimit, i cili më pas është paguar nga MD në buxhetin e shtetit në shumën 8,812,236 lekë. Me këtë mënyrë veprimi institucion vijonte prej	Drejtimi nr. 6 <i>"Probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit."</i>	E lartë	- Nga Ministria e Drejtësisë, të merren masat e nevojshme për të ndërpërjeten e shërbimeve të mar nga përkthyes të paregjistruar në organet fiskale, kjo në zbatim të dispozitave ligjore që rregullojnë funksionimin e sistemit buxhet taksat dhe tatimet, si dhe për të shmangur diskriminimin operatorëve ekonomikë kundër konkurrencës së pandershme.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

<p>vitesh.</p> <p>Vlera totale e shërbimit të kryer nga kjo kategori përkthyesish është 58,748,240 lekë (8,812,236/15%) ose rreth ¼ e shpenzimeve mujore. Vlerat e përkthimit të paguara prej saj janë bazuar në Udhëzimin e përbashkët MD dhe MF nr. 3165 datë 12.05.2004 “Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes, dhe tarifat e shpërblimit të përkthyesve të jashtëm, si dhe tarifat e përkthimit zyrtar që duhet të paguajnë të tretët” ndryshuar me udhëzimin e përbashkët botuar në fletoren zyrtare nr. 63/2005.</p> <p>Në Ministrinë e Drejtësisë përkthimi i materialeve të cilat dërgohen drejt institucioneve homologe apo anasjelltas kryhen aktualisht nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none">✓ përkthyesve të punësuar pranë institucionit✓ përkthyesve të njohur të listës të regjistruar pranë organeve tatimore✓ përkthyesve të njohur të listës të pa regjistruar pranë organeve tatimore <p>a. Evidentohet se, institucioni nuk disponon një mekanizëm të plotë dhe transparent për shpërndarjen e materialeve të përkthimit drejt përkthyesve të njohur prej saj duke bërë që një numër i kufizuar përkthyesish të kryejnë shërbimin në favor të kësaj ministrie por edhe prej tyre të ketë diferenca domethënëse në vlerat e përfituara, çka në situatën e një çmimi fiks të rregulluar “përkthehet” në më shumë punë e marrë. Kjo mënyrë ka krijuar pabarazi në këtë kategori profesioni ende “të parregulluar”.</p> <p>b. Kontraktimi individual i përkthyesve të cilët megjithëse ushtrojnë veprimtari fitimprurëse nuk janë të regjistruar në organet fiskale siguron një trajtim të pabarabartë dhe diskriminues si dhe krijon një standard jo të përshtatshëm institucional. Nga përkthyesit e kontraktuar kategoria “Të regjistruar” janë pagues të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, tatimeve, TVSH apo Tatim i Thjeshtuar mbi Fitimin/ Tatim mbi Fitimin si dhe Taksa vendore ndërsa kategoria “Të paregjistruar” taksohet në mënyrë lineare me nivelin 15% Tatimit në Burim. Edhe nëse të licensuarit do të kontribuonin/paguanin në buxhetin e shtetit njëllë në vlerë absolute, përsëri orientimi tek kategoria e të paregjistruarve, do të ishte e padrejtë, pasi në këtë mënyrë kjo vlerë shërbimi nuk do të ndihmonte zhvillimin dhe forcimin e profesionistëve të licensuar të cilët janë të lidhur drejtpërdrejtë me këtë veprimtari në të ardhurat e tyre, ndryshe nga kategoria tjetër të ardhurat e të cilës u referohemi si të ardhura plotësuese. Aktualisht mënyra e veprimit nga ana</p>	<p><i>Trajtuar më hollësisht në faqet nr 63-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.</i></p>	<p>- Nga Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me organet përkatëse, të merren masat e nevojshme hartimin e një baze rregullative mbi përkthimin e dokumentacioneve të klasifikuara, me qëllim eliminimin e risqeve të mundshëm gjatë kësaj veprimtarie.</p>
---	---	---



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në "MINISTRINË E DREJTËSISË"

<p>e institucionit të pjesën e konsiderueshme të shërbimit/të ardhurave tek kategoria e dytë e përkthyesve, pra atyre të përegjistruar.</p> <p>Në dispozitat ligjore aktuale për kryerjen e pagesave nga institucionet publike ndeshemi vetëm me termin "operator ekonomik" referuar ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 52 "Kryerja e shpenzimeve", ku sqarohet qartë mënyra si kryhet pagesa ndaj "operatorit ekonomik" dhe dokumenti përkatës për tu paraqitur për pagesë. Pra dokumenti bazë i cili rregullon, strukturën, parimet dhe bazat e procesit buxhetor, marrëdhëniet financiare mbi të cilat kryhet pagesa, jep në mënyrë shteruese mënyrën e pagesës dhe definicionin e "përfituesit". Gjithashtu mënyra e dakordësuar nga MD bie në kundërshtim edhe me parashikimet ligjit nr. 9920 "Për Procedurat tatimore në RSH", i ndryshuar, neni 41 "Identifikimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare pa u regjistruar", pika 1 dhe 2 e tij. Nëse organet tatimore do të evidentonin raste pagesash për përkthyes të përegjistruar, ato menjëherë duhet të merrnin masat e parashikuara në legjislacionin tatimor, bllokim deri në heqje të licencës për një periudhë gjashtëmujore për këta përkthyes referuar dispozitave të mësipërme. Në këtë rast organet tatimore hipotetakisht duhet të drejtoheshin vet MD për zbatimin e këtyre masave. Pra shihet qartë se pagesa e drejtpërdrejtë ndaj individëve referuar dispozitave të mësipërme, por jo vetëm, paraqesin mospërputhje të plotë me legjislacionin në tërësi.</p> <p>c. Moment tjetër me rëndësi nga ana jonë lidhur me përkthimet e akteve është siguria mbi dokumentacionet e përkthyer nga operatorët e regjistruar dhe individët të cilët ndryshe nga subjektet e regjistruar janë më pak të shfaqur në aspekt të transparencës dhe veprimtarisë publike. Pavarësisht kësaj, mungesa e një sistemi rregullator lidhur me marrjen në dorëzim të dokumentacionit, në vlerësimin tonë e ka ekspozuar njësinë drejt risqeve të vazhdueshëm në këtë drejtim për të dy kategoritë e përkthyesve të kontraktuar.</p> <p>Sa më lartë arrijmë në konkluzionin se, vlera prej 58,748,240 lekë e shpenzuar nga ana e institucionit për shërbime përkthimi në përkthyes të përegjistruar nuk rezulton të ketë patur efektivitetin dhe efikasitetin e pritshme.</p>			
--	--	--	--



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

2.	<p>Nga auditimi rezultoi se, Ministria e Drejtësisë vijon të paguajë pa të drejtë nga buxheti i vetë kostot e mirëmbajtjes për katër nga pesë sistemet të cilat janë në funksionim. Vetëm gjatë periudhës Janar-Tetor 2019 shpenzimet e mirëmbajtjes së tyre arrijnë shumën prej 5,862,400 lekë ndërkohë që këto shpenzime duhet të ishin përballuar nga AKSHI. Në kontratën e mirëmbajtjes të lidhura midis MD dhe operatorit ekonomik fitues nuk janë reflektuar ende ndryshimet e parashikuara në pikën 18 dhe 19, dhe 24 të VKM nr. 673, datë 22.11.2017, “Për Organizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, e ndryshuar,</p> <p>Mospërfundimi i procesit të transferimit të sistemeve pranë AKSHI-t referuar përcaktimeve ligjore në fuqi e kanë ekspozuar institucionin drejt shpenzimeve të panevojshme nga buxheti i vet lidhur me shpenzimet e mirëmbajtjes për këto sisteme por jo vetëm. Megjithëse dy nga pesë sistemet funksionale IT janë alokuar fizikisht tek AKSHI, ato vijnë të reflektohen në regjistrin e aktiveve të Ministrisë së Drejtësisë, çka tregon mangësi dhe veprime të ngadalta nga ana e grupeve të punës të institucioneve respektive.</p>	<p>Drejtimi nr. 5 <i>“Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe veprimtarisë së strukturës së auditimit të brendshëm”</i></p> <p><i>Trajtuar më hollësisht në faqet nr 46-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.</i></p>	E lartë	<p>- Institucioni të marri masat e nevojshme, për hostimin e sistemeve IT pranë AKSHI-t referuar përcaktimeve të VKM nr. 673 datë 22.11.2017, e ndryshuar, duke dokumentuar plotësisht transferimin e tyre fizik dhe kontabël si dhe eliminimin e kostove të panevojshme nga buxheti i institucionit për shërbimet e mirëmbajtjes së tyre.</p>
3.	<p>Nga auditimi rezultoi se, pjesën më të madhe në zërin “shpenzime” ose rreth 33% e tyre, e zënë blerjet nëpërmjet sistemit dinamik të biletave të transportit ajror ndërkombëtar. Për vitin 2019, ky zë është parashikuar në vlerën 7,000,000 lekë dhe deri në periudhën 30.10.2019 (periudha objekt i auditimit) është realizuar në vlerën 5.634.090 lekë.</p> <p>Në 07 (shtatë) procedura të audituara nga 32 gjithsej, me një vlerë shërbimi të paguar që shkon 2,464,643 lekë, dokumentacioni bashkëlidhur praktikës nuk arrin të argumentoj numrin e nevojshëm për pjesëmarrje në këto takime/vente. Në të gjitha rastet procedura realizohet në një afat shumë të shkurtër nga data e udhëtimit, duke sjellë si pasojë, <u>mungesë të studimit të tregut rrjedhojë e afateve të limituara dhe rrit riskun e përzejedhjes së çmimit më të lartë</u>, pasi biletat e avionit bliheshin ditën e nisjes apo ditë të afërt me nisjen, kur edhe çmimet kapin nivelet e tyre të larta.</p> <p>Mbi mungesën e argumentimit të numrit të pjesëmarrësve në procedurat e sistemit dinamik të blerjeve për bileta të transportit ndërkombëtar, Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 20468 prot, datë 11.11.2019, ka sjellë gjithashtu në vëmendje të Ministrisë së Drejtësisë shpenzimet për udhëtime dhe dieta, si dhe marrjen e masave të menjëhershme për kufizimin e numrit të pjesëmarrësve, pasi nga</p>	<p>Drejtimi nr. 3 <i>“Auditimi i veprimeve financiare të institucionit.”</i></p> <p><i>Trajtuar më hollësisht në faqet nr 37-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit</i></p>	E lartë	<p>- Nga Titullari i Institucionit, të merren masa që pas ardhjes së ftesës nga organizatorët për takime/vente jashtë vendit, të nxirret menjëherë autorizimi i pjesëmarrjes në to, në mënyrë që të minimizohet risku i blerjes së biletave me çmim më të lartë si rezultat i kryerjes së procedurës së prokurimit në data të afërta me datën e nisjes së udhëtimit.</p> <p>- Të argumentohet numri i pjesëmarrësve në takime/vente të organizuara jashtë vendit në mënyrë që të optimizohet numri i tyre dhe për rrjedhojë dhe shpenzimet që kryhen për këtë qëllim.</p>



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në "MINISTRINË E DREJTËSISË"

	analiza e kryer nga kjo ministri mbi përdorimin e fondeve buxhetore vërehen rritje të konsiderueshme të nivelit të shpenzimeve në zërin udhëtime dhe dieta për periudhën Janar-Tetor 2019. Lidhur sa më sipër, evidenton nevojën për një qasje më të kujdesshme nga ana e hallkave përkatëse për përdorimin me ekonomikitet të fondeve shtetërore në këtë drejtim.			
4.	<p>Nga auditimi mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Drejtësisë rezultoi se,</p> <p>a. Kjo njësi auditimi referuar strukturës organizative të miratuar me Urdhrin Kryeministrit nr. 238 datë 13.12.2017 është e organizuar në nivel drejtorie dhe ka të parashikuar një staf prej pesë punonjësish Drejtorin dhe 4 specialistë. Prej muajit Dhjetor 2017 pozicioni i drejtuesit të kësaj njësie rezultoi vakant duke krijuar një boshllëk në drejtimin e saj. Aktualisht kjo drejtori megjithëse ka si objekt auditimi aparatit e MD-së dhe rreth 34 institucione varësie, funksionon vetëm me dy auditues. Kjo përbërje, krijon risk të lartë për drejtimin, sai përket funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë e varësisë, por dhe vetë Ministrinë e Drejtësisë.</p> <p>b. Sipas të dhënave rezultoi se, DAB ka hartuar planin vjetor të auditimit për vitin 2019 dërguar Drejtorisë së Harmonizimit Financiar në të cilin parashikohet të realizohen 12 auditime nga 17 të tillë të parashikuar në planin strategjik 2018-2020, pra me 5 (pesë) auditime më pak. Në materialet e paraqitura nuk gjenden shpjegime lidhur me devijimet në planin vjetor dhe shtimin e tre auditimeve të reja</p> <p>c. Në planin vjetor të auditimeve për vitin 2020 nuk rezultojnë të jenë përfshirë auditimet të cilat nuk mund të realizohen gjatë vitit 2019 të cilat aktualisht janë 8 (tetë) të tillë.</p> <p>d. Në angazhimet e kryera gjatë periudhës nën auditim rezultoi se, thuajse në të gjitha rastet njësia që do të auditohet nuk është njoftuar 10 ditë përpara si dhe në dosje nuk gjendet argumentim lidhur me këtë mungesë si përcaktohet në pikën 4.1.4 të Manualit të Auditimit të Brendshëm/2016.</p> <p>Stafi i paplotësuar, tkurrja e numrit të auditimeve gjithsej, përzgjedhja tematike, shpërndarja disproporcionale sipas periudhave, të programeve të auditimit, si dhe afatet e shkurtra për përmbushjen e tyre, nuk krijojnë siguri të arsyeshme për përmbushjen e plotë dhe me cilësisë të objektivit të kësaj strukture.</p>	<p>Drejtimi nr. 5 <i>"Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe veprimtarisë së strukturës së auditimit të brendshëm."</i></p> <p><i>Trajtuar më hollësisht në faqet nr 46-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit</i></p>	E lartë	<p>- Nga ana e Ministrisë Drejtësisë, të merren masa, për plotësimin e vendeve vakantë në strukturën e miratuar në nivelin specialisti dhe Drejtuesi si dhe ndërmerrin hapat e nevojshëm administrativë dhe ligjorë për zgjerimin e kësaj strukture, me qëllim garantimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe evidentimit rasteve të keqpërdorimit të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike.</p> <p>- Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të rishikoj planin vjetor për vitin 2020 duke përfshirë në të edhe subjektet të cilat nuk janë audituar prej gjatë vitit 2019. Plani i rishikuar pas mendimit të Komitetit të Auditimit dhe miratimit nga Titullari i Institucionit, të paraqitur rregullisht pranë Drejtorisë Përgjithshme të Harmonizimit në MFE me shpjegimet përkatëse.</p> <p>- Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të programoj auditimet të plota, brenda afateve arsyeshme, dhe të shtrirë në gjithë periudhën vjetore, duke respektuar rigorozisht periudhën e njoftimit dhe të gjitha hapat e tjerë hartimit, miratimit dhe dërgimit të raporteve përkatës drejt subjektit të audituar, duke mos krijuar tejkalime afatesh procedural të cilat krijojnë risk të lartë veprimtarinë e kësaj njësie.</p>



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

II- HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Mbi Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi “Ministrinë e Drejtësisë”, më poshtë e emërtuar “MD”, në bazë të programit të auditimit tematik të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr. 813/1 prot, datë 18.10.2019, për periudhën e auditimit nga data 01.01.2019 deri më 30.10.2019, me afat auditimi nga data 18.10.2019 deri më 25.11.2019, dhe lloj auditimi “Auditim Përputhshmërie dhe Rregullshmërie Financiare” i cili u krye nga grupi i auditimit me përbërje:

1. Klarenc Xhaferaj (*Përgjegjës grupi*)
2. Valentina Golemi
3. Miranda Haxhia
4. Ervina Basha
3. Aldo Kume

Qëllimi i auditimit:

Qëllimi i auditimit është, dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional, e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve mbi të cilat është rënë dakord, mbi bazën e të cilave ushtron veprimtarinë “Ministria e Drejtësisë”. Vlerësimin e përputhshmërisë së veprimeve procedurale e administrative, të kryera me kriteret dhe kërkesat e legjislacionit. Evidentimi i shkeljeve të parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar, shfrytëzimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike, si dhe dhënia e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes në vijim. Raportimin e të gjitha çështjeve të tjera që dalin apo lidhen me auditimin, të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit i konsideron të rëndësishme për t’u bërë publike.

Objektivat e auditimit:

Objektivi i auditimit është vlerësimi, mbi besueshmërinë e sistemeve të ngritura, procedurave të ndjekura nga “Ministria e Drejtësisë”, gjatë realizimit të objektivave në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Përgjegjësia e drejtuesve të njësisë në mirëmenaxhimin e fondeve publike, duke garantuar parimet e transparencës, profesionalizmit, përgjegjshmërisë dhe sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik.

Identifikimi i çështjes:

Fushëveprimi i këtij auditimi është vlerësimi me siguri të arsyeshme i veprimtarisë së “Ministrisë së Drejtësisë”, për periudhën objekt auditimi nga 01.01.2019 deri më 30.10.2019, në përputhje me aktet ligjore të cilat rregullojnë veprimtarinë e këtij institucioni dhe konkretisht:

Masat e marra nga ana e Institucionit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, veprimeve financiare të kryera gjatë kësaj periudhe, marrëdhëniet e punës dhe realizimin e shpenzimeve lidhur me to, zbatimin e legjislacionit mbi realizimin e procedurave të prokurimit publik dhe marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, funksionaliteti i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe njësisë së auditimit të brendshëm, si dhe çështje të tjera të cilat lidhen me aktivitetin në tërësi.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në "MINISTRINË E DREJTËSISË"

Përgjegjësia e Drejtimit për Përputhshmërinë me legjislacionin në fuqi:

Është detyrimi i menaxherëve të njësive, që, në kryerjen e veprimtarive, të respektojnë parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar, të ligjshmërisë e të transparencës në administrim, si dhe të përgjigjen për veprimet e tyre dhe rezultatet që burojnë prej tyre përpara organit që i ka emëruar ata ose të cilëve u ka deleguar përgjegjësinë sipas përcaktimeve në Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar.

-*Nëpunësi autorizues* është përgjegjës për veprimet dhe vendimet e nxjerra gjatë veprimtarisë funksionale.

-*Nëpunës zbatues*, i caktuar si është personi përgjegjës sipas kuadrit normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të treguesve financiarë.

Përgjegjësia e Audituesit të KLSH për auditimin e Përputhshmërisë dhe rregullshmërisë

Përgjegjësia jonë (*Audituesit e KLSH-së*) është që nëpërmjet auditimit të realizuar:

-Të vlerësojë nëse, informacionet mbi çështjet në të gjitha aspektet materiale janë në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi, masa e ndjekjes nga subjekti i audituar i rregullave, legjislacionit dhe akteve normative, politikave, kodeve të miratuara apo kushtet e përcaktuara (*ISSAI 4000*), nuk paraqesin devijime materiale nga kriteret e vlerësimit, si pasaktësi apo gabime dhe janë në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtrohet-veprimtaria e subjektit të audituar. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI), bazuar në këto standarde në aplikojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese:

-Të kryejë në mënyrë efektive auditimin. (*ISSAI 1300*)

-Të vlerësojë nëse është siguruar evidenca e mjaftueshme dhe e përshtatshme e auditimit dhe nëse bazuar në këtë evidence ai mund të formojë konkluzionet përkatëse. (*ISSAI 1500/ISA 300*)

-Të kryejë procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objektiv.

Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10 "Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t", si dhe ISSAI 30 "Kodi Etik", apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të vlerësuar përputhshmërinë e aktivitetit. Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse çështjet subjekt auditimi, që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë në veprimtarinë e subjektit të audituar.

Dokumentimi i rezultateve të auditimit:

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën, dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Në përfundim të auditimit, mbi bazën e evidencave të marra, akt-verifikimit dhe akt-konstatimeve të mbajtur, Projektraportit, u përgatit Raporti Përfundimtar i Auditimit.

Kriteret e vlerësimit:

-Ligji nr. 8678, datë 14.5.2001 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar,

-Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

- Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar,
- Ligji nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”,
- Ligji nr. 10 325 datë 23.09.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, i ndryshuar,
- Ligji nr. 9920 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar,
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar
- VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar,
- VKM nr. 673 datë 22.11.2017, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar,
- VKM nr. 83 datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisve të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar,
- VKM nr. 160, datë 02.03.2016 “Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e komitetit të auditimit të brendshëm në njësitë publike.
- Udhëzimi i përbashkët MD dhe MF nr. 3165 datë 12.05.2004, i ndryshuar,
- Akte të tjera ligjore dhe nënligjore të detyrueshëm për zbatim.

Standardet e Auditimit

Auditimi u bazua në:

- Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren “Për Procedurat e Auditimit” miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së Nr. 107 datë 08.09.2017, i ndryshuar, referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit si:
- Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë. Referencë në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve IFAC.

Materialiteti dhe metodologjia e bazuar në risk

Kontrolli i Lartë i Shtetit konsideron një nivel sasior materialiteti deri në 2% në nivel grupi dhe llogarie. Në disa raste, gabimi edhe pse jo material nga ana sasiore, mund të shfaqet material nga *ana cilësore* “Një çështje ose grup çështjesh mund të jenë materiale ose për shkak të sasisë, natyrës (karakteristikave të brendshme) ose në varësi të kontekstit të tyre” për vet impaktin real por dhe ndjeshmërinë publike që ka veprimtaria e institucionit. Çështjet që janë materiale nga natyra ose përmbajtja duhet të zbulohen; ato do të lidhen me përputhmërinë e veprimtarisë së institucionit, duke u përfshirë kështu në konkluzionet e auditimit. Megjithatë, mbetet në gjykimin e KLSH-së, që çështje të veçanta në varësi të rëndësisë dhe impaktit të tyre, të merren në konsideratë në raportin e auditimit.

Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit

Metodat dhe teknikat e kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit u bazuan kryesisht në metodologjinë e aplikuar gjatë fazës së planifikimit;

- Raporte dhe informacione* nga shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve që lidhen direkt me objektivat e auditimit të marra në formë elektronike dhe shkresore.
- Intervistimi i personelit* që ka patur role specifike.

Objektivi i audituesve ishte identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara drejt anomalive materiale.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

Ministria e Drejtësisë organizohet dhe funksionon në përputhje me:

- a) Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- b) ligjin për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave;
- c) ligjin për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore;
- ç) ligjin për nëpunësin civil;
- d) ligjet e tjera të posaçme që parashikojnë rregulla lidhur me Ministrinë e Drejtësisë; dhe
- dh) ligjin nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar.

Ministria e Drejtësisë, ushtron funksione dhe ka në kompetencë hartimin dhe ndjekjen e politikave, përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe ushtrimin e shërbimeve të nevojshme lidhur me sistemin gjyqësor, sistemin e ekzekutimit të vendimeve penale a civile, sistemin e shërbimeve të lira juridiko-profesionale, bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën civile dhe penale, fushat e tjera të drejtësisë dhe të kompetencës së saj sipas ligjit, si dhe për bashkërendimin, harmonizimin dhe reformimin e legjislacionit shqiptar në tërësi.

Institucioni ushtron kompetenca, mbështet, bashkëpunon dhe koordinon veprimtarinë e saj, sipas këtij ligji, lidhur me organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, me institucionet e sistemit të burgjeve, të shërbimit të provës, të profesioneve të lira, me përjashtim të rasteve kur në ligje të posaçme parashikohet ndryshe. Pas rikonceptimit të ministrive gjatë muajit Shtator, me vendimin nr. 506, datë 13.09.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Drejtësisë”, Këshilli i Ministrave ka përcaktuar fushën e përgjegjësisë shtetërore të saj. të cilës veç të tjerash i është ngarkuar edhe roli i Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit, bashkërendimi i punës për hartimin e politikave si dhe përgatitja e akteve ligjore e nënligjore për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.

Në përputhje me ligjin e vet organik dhe VKM, të sipërpërmendur objekti i veprimtarisë së “MD” shtrihet në 26 fusha të përcaktuara.

Në përputhje me fushat e veprimtarisë, shërbimet civile të Ministrisë së Drejtësisë ushtrohen nga:

1. Sekretari i Përgjithshëm
2. Drejtoritë e Përgjithshme
3. Drejtoritë
4. Sektorët

Struktura e aparatit të MD-së për periudhën objekt auditimi i referohet ndryshimit të fundit miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 238 datë 13.12.2017 në të cilën parashikohen;

-149 punonjës të strukturuar në Kabinet, katër Drejtori të Përgjithshme dhe Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm. Gjithashtu referuar akteve ligjore janë bërë pjesë e stafit:

-05 (pesë) punonjës me kontratë të përkohshme përcaktuar MD-së për vitin 2019 me VKM nr. 16 datë 16.01.2019;

-08 (tetë) punonjës me kontratë 1(një) vjeçare të lidhur për studentë të ekselencës si dhe;

-17 punonjës të rinj të punësuar mbi bazën e VKM nr. 277 datë 16.05.2018 në kuadër të programit kombëtar të praktikave të punës pranë institucioneve publike.



KONTROLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

✦ Drejtimi 1: “Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm”

Në bazë të programit të auditimit nr.1437/1 prot, datë 04.01.2019 KLSH ka ushtruar auditim pranë Ministrisë së Drejtësisë. Me shkresën nr.1437/9 datë 31.07.2019 subjektit të audituar i është dërguar Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe masat e rekomanduara.

Ministria e Drejtësisë, me shkresë nr.5844/5 prot datë 21.10.2019, ka informuar pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit, në lidhje mbi hartimin e programit të punës dhe të plan veprimit, për të realizuar maksimalisht, zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit nga KLSH-ja, duke mosrespektuar afatin 20 ditor, në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga ana e KLSH me shkresat përcjellëse janë lënë 20 (njëzetë) rekomandime gjithsej, nga këto:

- Masa Organizative 16 (gjashtëmbëdhjetë);
- Masa Shpërblim Dëmi 1 (një);
- Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin dhe menaxhimin me ekonomicitet eficient dhe efektivitet të fondeve publike 1(një);
- Masa Administrative 1(një);
- Masa Disiplinore e administrative 1 (një)

Niveli i zbatimit të rekomandimeve:

- Zbatuar plotësisht: 4 (katër) rekomandime
- Në proces ndjekje: 16 (gjashtëmbëdhjetë)rekomandime
- Pa realizuar: 0 rekomandime

Më hollësisht, auditimi i zbatimit të rekomandimeve:

A. MASA ORGANIZATIVE

Gjetja 1:

Nga auditimi i procedurës me objekt “Sistemi Elektronik për Dixhitalizimin e Arkivës Gjyqësore”, realizuar në MD në vitin 2017, u konstatua se:

- Në bazë të Urdhër Prokurimi nr. 527/6, datë 14.04.2017, është prokuruar kontrata me fond limit në vlerën prej 26,666,667 lekë pa tvsh, ku është marrë miratimi nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), si për fondin e parashikuar, hartimin e kriterëve për kualifikim, si dhe për vendodhjen e instalimit të softit. Rezultoi se, AK ka paraqitur vendndodhje të ndryshme të instalimit të softit, ndryshe në projektin e miratuar nga AKSHI, ndryshe në DT dhe ndryshe në kontratën e lidhur me operatorin fitues. Këto veprime tregojnë mos seriozitet nga AK, duke vepruar në kundërshtim me bazën ligjore të prokurimit publik.

-Njësia e prokurimit, ka hartuar e miratuar DT, duke mos argumentuar vendosjen e kriterëve për kualifikim dhe kriterëve të veçanta në rubrikën e DST nga 3.3.1 deri në 3.3.24, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”,i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 61, pika 2, veprim ky që ka zvogëluar konkurrencën, pasi në tender janë paraqitur vetëm 2 operatorë ekonomike.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në "MINISTRINË E DREJTËSISË"

-Me shpalljen e operatorit ekonomik fitues "Soft Solution" shpk është lidhur Kontratë Shërbimi nr. 527/9 datë 26.05.2017, e cila nga pikëpamja formale, ka mangësi në këta elementë: objekti, qëllimi, vendndodhja e instalimit të softit, afati i kontratës dhe kushtet e veçanta. Këto fakte tregojnë mangësitë e AK, përsa i përket formulimit dhe miratimit të kontratës, në kundërshtim me DT.

- Sipas Urdhër të titullarit AK me nr. 527/10 datë 29.05.2017, është miratuar ngritja e grupit të punës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës, i cili duhet të pasqyrojë nëpërmjet procesverbaleve, për çdo verifikim të shërbimit të ofruar, në mbështetje të kontratës. Nga auditimi, rezultoi që grupi i mësipërm nuk ka paraqitur asnjë procesverbal për shërbimin e ofruar, por është justifikuar, në proces-verbalin datës 09.02.2018 duke u shprehur se, "*.....nuk ka pasur dijeni si dhe nuk mbajnë asnjë përgjegjësi ligjore dhe kontraktuale të shkaktuar nga mosndjekja e kontratës*". Ky fakt tregon se, sistemi i kontrollit të brendshëm për sektorin e burimeve njerëzore nuk ka funksionuar, para dhe pas ndryshimit të organikës, në bazë të Urdhrit nr. 166 të Kryeministrit, datë 05.10.2017 "Për miratimin e strukturës dhe Organikës së Ministrisë së Drejtësisë", pasi edhe ish-sekretari i përgjithshëm i periudhës respektive nuk ka marrë asnjë masë.

-Sipas shkresës nr. 3774 prot, datë 06.06.2017, nga operatori ekonomik fitues "Soft & Solution" shpk është dorëzuar fatura tatimore shitje nr. 224, datë 06.06.2017, me vlerë totale të ofertës fituese **prej 31,224,000 lekë me TVSh**, e firmosur vetëm nga përfaqësuesi i operatorit ekonomik. Kjo faturë tatimore nuk është likuiduar nga Ministria e Drejtësisë.

Sipas Faturës tatimore është kërkuar të paguhet, çdo element përbërës i kontratës duke përfshirë dhe mirëmbajtja të përcaktuar sipas DT, e cila do të realizohej me periudhë kohore prej 48 muaj. Pra lëshimi i faturës tatimore, nga ana e operatorit ekonomik Soft & Solution shpk është në kundërshtim me, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" dhe me dokumentat e tenderit, duke kërkuar pagesën e krijimit të softit dhe implementimi menjëherë, ku sipas DT e kishte për 45 ditë për krijimin e softit dhe shërbimin e mirëmbajtjes për 48 muaj. Këto shërbime nuk janë të dokumentuar nga AK deri në momentin e kryerjes së këtij auditimi, pasi ende kjo kontratë nuk është realizuar në mënyrë të suksesshme. *(Drejtuesit aktual të MD, si nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues, i periudhës së tanishme nuk marrin përsipër të shpjegojnë mënyrën sesi është paraqitur, kjo faturë tatimore shitje, pasi në kohën kur është dorëzuar kjo faturë në organikën e MD, figuronin punonjës të tjerë të administratës).*

- Nga auditimi u konstatua se, ecuria për zbatimin e kontratës, është vijuar me Urdhrin e titullarit të AK-së nr. 8610/2 datë 08.08.2018 nga ish-nëpunësi autorizues i kohës, duke ngritur grup pune, ku qëllimi kryesor është përshkrimi ecurisë dhe zgjidhjet e mundshme, për ekzekutimin përfundimtar të kontratës. Në bazë të MEMO-s nr. 23/1, datë 23.10.2018, grupi i punës, është shprehur se, "*..sistemi i instaluar në ambientin "test" të Ministrinë e Drejtësisë, nuk mund të vlerësohet nga ana teknike, sepse aplikacioni "softëar" nuk mund të përbëjë sistem të plotë dhe funksional, kjo për shkak të mungesës së saktë të vendndodhjes, e cila duhet të jetë pranë Arkivit Qendror të Gjyqësorit në Lundër, të mungesës së infrastrukturës së nevojshme dhe të domosdoshme të pajisjeve si dhe në mungesë të burimeve njerëzore nga ana e AK-së, për implementimin e saj.*", pra grupi i punës ka argumentuar se ecuria e implementimit të kontratës nuk mund të bëhet, për shkak të problematikave, të cilat janë si pasojë e veprimeve të mëparshme të AK.

Nisur sa më sipër, nga ana e nëpunësit autorizues, (Elira Kokona në detyrë nga shtatori 2017 deri në tetor 2018 dhe Aurel Lamçe në detyrë në tetor 2018 deri në fillim shkurti 2019) në cilësinë e titullarit të AK, nuk janë analizuar arsyet dhe shkaqet, e mos ekzekutimit të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

kontratës në mënyrë të suksesshme, veprime të cilat mund të krijojnë risqe ekonomike në disfavor të Buxhetit të Shtetit, duke bërë të mundur që, kontrata nr. 527/9 prot, datë 26.05.2017 të mos jetë efektive, efiçente dhe me ekonomicitet në vlerën prej 31,224,000 (tridhjetë e një milion e dyqind e njëzetë e katër mijë) lekë me tvsh, pasi gjithë hallkat e realizimit të procedurës tenderuese, kanë rezultuar me performacë të ulët.

Si dhe më kryesorja nga institucioni i MD si AK nuk është marrë asnjë masë administrative/masë disiplinore, për shkeljet e konstatuara, të rregullave të prokurimeve publike, të ligjit nr. 152/2013 01.10.2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, (Trajtuar më hollësisht në faqet 62-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Sa më sipër është rekomanduar:

Ministria e Drejtësisë, të ndjekë të gjitha hapat ligjore dhe administrative, për të bërë të mundur revokimin e Kontratës së Shërbimit nr. 527/9 prot, datë 26.05.2017 me objekt “Sistemi Elektronik për Dixhitalizimin e Arkivës Gjyqësore”, me qëllim mos krijimin e efekteve financiare negative, duke shmangur koston buxhetore në vlerën prej 31,224,000 lekë me tvsh.

Përgjigjia e subjektit:

Grupi i punës i ngritur me urdhërin e Ministrit të Drejtësisë nr.424, datë 04.09.2019 mbi ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të raportit përfundimtar të auditimit të KLSH "Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë në Ministrinë e Drejtësisë" do të analizojë dhe shqyrtojë të gjithë dokumentacionin e Kontratës së Shërbimit Nr. 527/9 prot, datë 26.05.2017 me objekt "Sistemi Elektronik për Dixhitalizimin e Arkivës Gjyqësore".

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe është *në proces zbatimi*.

Gjetja 2:

Nga auditimi i procedurës së prokurimit, të klasifikuara në nivelin “E kufizuar”, me objekt “Rikonstruksioni i Kolegjit të Apelit –VETTING-ut”, viti 2017, realizuar në MD, u konstatua se:

-Njësia e prokurimit, në DT për kritereve specifike (teknike dhe profesionale), në pikën 2.4 të ka kërkuar “Licencë restaurimi për shoqëri ndërtimi të miratuara nga Ministria e Kulturës ose nën kontraktimi me një subjekt të licencuar në kategorinë si dhe Punime restaurimi në monumentet e arkitekturës për shoqëri ndërtimi në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës. Në rast bashkimi operatorësh secili duhet të disponojë licencën e Restaurimit”, Kërkesa që, “Në rast bashkimi operatorësh secili duhet të disponojë licencën e Restaurimit”, bie në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar neni 45, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 74 pika 3, ku citohet se secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të përmbushë, kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP-së dhe të përcaktuara në DT. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me % e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim të përcaktuar në marrëveshje. Rrjedhimisht, kërkesa e mësipërme sforcon kërkesat kualifikuese dhe zvogëlon konkurrencën, ku një operator, i cili nuk disponon licensë restauruese nuk mund të kryej bashkim operatorësh apo aktmarrëveshje për realizim punimesh. Pra përjashtohen



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në "MINISTRINË E DREJTËSISË"

OE, duke i mohuar mundësinë e bashkimit të OE, ku nuk mund të realizohej ndarje e punimeve.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 62-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Gjetja 2.1:

Nga auditimi i procedurës me objekt "Përshtatje emergjente e ambienteve të godinës së Ministrisë së Drejtësisë" viti 2018, u konstatua se,

Njësia e prokurimit, në vendosjen e kriterëve të kapacitetit teknik (2.3.f,g) nuk ka argumentuar numrin e punonjësve, në përputhje me volumin e objektit dhe kohën e realizimit, kjo në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 61 pika 2.

Gjithashtu, sipas DT, pika (2.3 .e) ka kërkuar që mjeku i ndërmarrjes të ketë kontratën e punës të vlefshme dhe licenca profesionale të marra nga Ministria e Shëndetësisë, sipas përcaktimeve të VKM nr. 742, datë 06.11.2003 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 692, datë 13.12.2001 "Për masat e veçanta të sigurimit dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë" ku citohet në pikën 12/1. Marrja në punë e mjekut është e detyrueshme për të gjitha subjektet, veprimtaria e të cilave klasifikohet sipas vendimeve nr. 459, datë 22.7.1998 "Për substancat e rrezikshme", nr. 419, datë 4.8.2000 "Për objektet e rrezikshme" dhe nr. 207, datë 9.5.2002 "Për përcaktimin e punëve të vështira ose të rrezikshme" të Këshillit të Ministrave, pavarësisht nga numri i të punësuarve.

Sipas VKM-së nr. 632, datë 15.7.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 108, datë 9.2.2011, "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë", pika 1, pika 3, gërma "b" dhe pika 4 gërma "b" thuhet shprehimisht se "*Vendimi nr. 692, datë 13.12.2001, i Këshillit të Ministrave, "Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë", shfuqizohet*".

Pra, Njësia e prokurimit me miratim të titullarit të AK, ka vendosur një kriter të panevojshëm dhe të kundraligjshëm, me aktet nënligjore të mësipërme, për pasojë ka sjellë uljen e konkurrencës së operatorëve ekonomikë.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 62-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Sa më sipër është rekomanduar:

Në çdo procedure prokurimi, kërkesat e veçanta kualifikuese të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e kontratës me qëllim rritjen e konkurrencës nëpërmjet pjesëmarrjes të sa më shumë Operatorëve Ekonomik për mirë përdorimin e fondeve publike me, efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet.

Përgjigjia e subjektit:

Në lidhje me rekomandimin e KLSH-së (Sektori i Prokurimeve), gjatë hartimit të kriterëve për kualifikim të procedurave të prokurimit të zhvilluara janë marrë në konsideratë vërejtjet e KLSH-së, këto vërejtje do të mbahen në konsideratë edhe në vijimësi.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe është **zbatuar**.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Gjetja 3:

Nga auditimi i procedurës së prokurimit, të klasifikuara në nivelin “E kufizuar”, me objekt “Blerje pajisje të teknologjisë dhe informacionit dhe pajisjeve të tjera për mobilimin e zyrave të Kolegjit të Apelit–Vetting-ut”, viti 2017, realizuar në MD, u konstatua se:

- AK, ka miratuar Urdhër Prokurimi nr.3/2 datë 04.12.2017, me objekt kontrate për mallra dhe shërbim, duke i vendosur në një procedurë të vetme, blerje pajisje teknologjie (FV), dhe mobilim (FV).

- Komisioni i Hartimit të Dokumenteve të Tenderit ka përlogaritur vlerën e fondit limit për mobilim prej 10,535,400 lekë pa tvsh, e barasvlershme me 30% e vlerës totale së kontratës prej 31,283,040 lekë pa TVSh, ku është konstatuar se, mungon plani mobilimit, specifikimet teknike, preventivi me zërat dhe sasi të përkatëse. Ndërsa, përlogaritja e sistemeve dhe pajisjeve elektronike në total, është bërë sipas projekt zbatimit, duke u mbështetur në shkresën nr. 3589/1, datë 24.11.2017, dhe ka marrë miratimin nga institucioni i AKSHI-it.

- Komisioni i Hartimit të Dokumenteve të Tenderit, ka hartuar DT duke përcaktuar kriteret për kualifikim dhe mbështetur në Udhëzimin nr. 806 datë 30.01.2015, të Ministrit të Drejtësisë për “Zbatimin e VKM nr. 701, datë 22.10.2015 “Për miratimin e rregullores “për sigurimin e informacionit të klasifikuar në fushën industriale” Kreu II/2, germa 5(e), ka ftuar 3 operatorë ekonomikë për të marrë pjesë në prokurim.

Nga auditimi pranë faqes on-line të Qendrës Kombëtare të Biznesit, në lidhje me objektin e veprimtarisë së operatorëve të ftuar, rezultoi se, OE “PC STORE” shpk, OE “KREATIX”shpk dhe OE “IT PARTNERS”shpk, nuk kanë objekt aktiviteti në fushën e mobilimit, por vetëm në fushën e IT, ndonëse në DT në pikën 2.1 Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë, është kërkuar që “*Operatori ekonomik duhet të paraqesë ekstraktin e regjistrimit në QKB ku të ketë të përfshirë në objektin e veprimtarisë së saj edhe objektin e kontratës në fjalë*”.

-Komisioni i Negocimit të Vlerësimit të Ofertave, në datën 12.12.2017, datë në të cilën është bërë hapja e ofertave dhe vlerësimi i dokumentacionit vendosi të kualifikojë në vend të pare dhe të shpallë fitues operatorin ekonomik “PC STORE” shpk me vlerë oferte 31,280,000 lekë pa tvsh dhe ka lidhur Kontrata me nr.3/15, datë 15.12.2017. OE fitues nuk e ka si objekt në aktivitetin e tij mobilimin, por vetëm pajisjet elektronike, e vërtetuar kjo nga të dhënat e Ekstrakti të QKB datë 26.09.2017 dhe noterizuar me nr. 2354 Rep datë 10.12.2017.

-Gjithashtu, me miratimin e VKM-së nr. 46 datë 31.01.2018 “Për disa ndryshime në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 518, datë 20.09.2017, për një ndryshim në Vendimin nr. 518 datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave, është shtuar sipërfaqja e ambienteve duke krijuar strukturën e re, të Komisionerit Publik të Vettingut. Për këtë arsye, AK ka marrë nga buxheti i shtetit shtesën e vlerës së pajisjeve elektronike dhe pajisjeve për mobilim në shumën 3,065,700 lekë pa tvsh, dhe ka lidhur me OE “PC STORE” shpk shtesën e kontratës me nr. 3/4, datë 28.03.2018.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 62-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Sa më sipër është rekomanduar:

Në cdo rast, prokurimi i mallra që kanë natyrë dhe specifika të ndryshme (si në rastin e mësipër), procedurat e prokurimit të realizohen, të ndara nga njëra tjetra.

Përgjigjia e subjektit:

Në lidhje me rekomandimin e KLSH-së, AK e Ministrisë së Drejtësisë (Sek. i Prokurimeve), gjatë argumentimit të përcaktimit të llojit të procedurave të prokurimit që do të realizohen, do të mbahet në konsideratë vërejtjet e KLSH-së edhe në vijimësi.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe është *në proces zbatimi*.

Gjetja 4:

Nga auditimi i procedurës me objekt “*Riparim-Shërbim i automjeteve të Aparatit të Ministrisë së Drejtësisë*” viti 2017 dhe viti 2018, u konstatua:

-Për përcaktimit e vlerës që duhet të financohej nga buxheti i shtetit për *riparimet dhe shërbimet që do i behen automjeteve (para llogaritjes së fondit limit)* nuk është marrë parasysh vlera kontabël dhe norma e amortizimit të cdo mjeti motorik në përputhje me ligjin nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, udhëzimin nr.30 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Po kështu, nuk ka evidenca për cdo mjet (letër shërbimesh) se sa kilometra ka përshkruar përgjatë viteve të mëparshme. Pra nuk ka dokumentacion dhe evidenca të mjaftueshme për të argumentuar gjendjen reale të përdorimit dhe nivelin e amortizimit të cdo automjeti, me qëllim identifikimi e saktë të nevojës për riparime dhe shërbim, mbi bazën e të cilave do të llogaritej dhe të kërkohej financimi buxhetor për të vijuar me pas me llogaritjen e fondit limit sipas përcaktimeve të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 62-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Sa më sipër është rekomanduar:

Nga Ministria e Drejtësisë, të merren masa, për të analizuar dhe vlerësuar saktë gjendjen teknike mbështetur në vlerën kontabël, në llogaritjen e amortizimit dhe në dokumentacionin teknik të çdo automjeti. Kjo analizë dhe vlerësim të bëhet me qëllim marrjen në konsideratë të raportit kosto-përfitim (leverdinë ekonomike) për shërbimet që kërkohet të kryhet për cdo mjet.

Përgjigjia e subjektit:

Në vijim të rekomandimit nr.4 të KLSH-së, nga sektori i shërbimeve në Ministrinë e Drejtësisë në bashkëpunim me strukturat drejtuese është punuar në drejtim:

1. Të përmirësimi të mbajtjes së dokumentacionit teknik të mjeteve.
2. Ndjekjes së konsumit të karburantit dhe km të përshkuara nga mjetet.
3. Ndjekjes së shpenzimeve të Riparim - Shërbimeve të mjeteve.
4. Marrjes në formë shkresore nga sektori i financës të Vlerës kontabël dhe amortizimit të mjeteve.

5. Përgatitjes së tabelave dhe pasqyrimin në keto tabela, të të gjitha shpenzimeve të transportit, mujore dhe progresive si:

- Vlera e mbetur e mjetit
- Km të përshkuar nga mjetet
- Konsum karburanti
- Shpenzime Riparim-Shërbime
- Shpenzime të tjera të transportit
- Shpenzime taksa fikse, siguracione

Zërat e transportit sa më sipër ndiqen në formë elektronike të programuar.

Kjo praktikë është realizuar për vitin 2019 duke filluar nga 1 Janari i këtij viti, sipas materialit të muajit Shtator 2019 dhe të periudhës 1 Janar 2019- 30 Shtator 2019.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe është **zbatuar**.

Gjetja 5:

Nga auditimi i përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare të procedurës me objekt "Hartimi i projekt-zbatimit për rehabilitimin e arkivës së Ministrisë", realizuar në vitin 2018, u konstatua se nga operatori ekonomik fitues "Atelier 4" shpk, në përlogaritjen e vlerës së kontratës të projektit-zbatimit, disa zëra punime janë të mbivendosura në preventivin e punimeve në vlerën 346,076 lekë me tvsh, e cila mund të përbëjë risk për dëm ekonomik nëse do të publikohej në tender mbi zbatimin e punimeve, kjo në kundërshtim me VKM nr. 629, datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre".

(Trajtuar më hollësisht në faqet 62-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Sa më sipër është rekomanduar:

Nga Autoriteti Kontraktor, të merren masa, për të analizuar dhe rishikuar preventivin e projekt-zbatimit dhe vlerën e përlogaritur të kontratës, në momentin, kur nga AK do të parashikohen fonde buxhetore për të realizuar rikonstrukcionin e ambienteve të arkivës së Ministrisë së Drejtësisë.

Përgjigjia e subjektit:

Në lidhje me rekomandim nr.5 njësia e prokurimit, ka kryer veprimet përpara zhvillimit të procedurës së prokurimit të klasifikuar duke kryer rishikimin e preventivëve nga projektuesi sipas rekomandimeve të lëna nga KLSH, duke zbritur vlerën e dhënë.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe është **zbatuar**.

Gjetja 6:

Nga auditimi i procedurave tenderuese të zhvilluara nga Ministria e Drejtësisë, në cilësinë e autoritetit kontraktor, për vitet buxhetore 2017 dhe 2018, u konstatua se, plotësimi dhe administrimi i dosjeve nuk paraqitet në nivelin e kërkuar, pasi nuk janë arkivuar, nuk janë nënshkruar nga marrësi dhe nga dorëzuesi, veprim ky në kundërshtim me ligjin nr. 9156 datë 06.11.2003 "Për arkivat" i ndryshuar, me LPP, Kreu II, neni 12, pika 3.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 62-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Sa më sipër është rekomanduar:

Spektori i prokurimit në Ministrinë e Drejtësisë të marrë masat e menjëhershme, që dosjet e prokurimeve të vitit 2017 dhe 2018, të inventarizohen dhe të arkivohen ne protokoll arkivën e Ministrisë.

Përgjigjia e subjektit:

Në zbatim të rekomandit të KLSH-së, Spektori i prokurimeve ka marrë masa dhe ka arkivuar dosjet e prokurimit të vitit 2017 dhe është në proces arkivimi të dosjeve të vitit 2018.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe është **në proces zbatimi**.



KONTROLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Gjetja 7:

Veprimtaria e Ministrisë së Drejtësisë ka vijuar të funksionojë me Rregulloren e Brendshme të miratuar nga Ministri i Drejtësisë me urdhër nr. 5745, datë 13.08.2008 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, ku ndryshimi i fundit është bërë me urdhrin nr. 371/1, datë 10.09.2013. Edhe pse ligji i organizimit dhe funksionimit të MD ka pësuar ndryshime në zbatim të urdhrin nr. 40, datë 30.03.2017, kjo nuk është shoqëruar me ndryshimin korrespondues në rregulloren e brendshme. Gjatë periudhës objekt auditimi, MD ka pasur ndryshime në strukturë, krijime të pozicioneve të reja, sektorëve të rinj apo shkrirje të drejtorive/ sektorëve të mëparshëm, të cilat nuk janë reflektuar në rregullore. Në kushtet e ndryshimit ligjor, ndryshimeve e shumta në strukturën e Drejtorive të Përgjithshme/ drejtoritë dhe sektorët brenda tyre parashtrajnë nevojën e një rregulloreje të re të funksionimit, duke qenë se reflektimi i tyre do të sillte shumë modifikime dhe shfuqizime, që do të çonin në një produkt final të vështirë për tu lexuar.

Në rregulloren në fuqi, si dhe draft rregulloren e re të marrë në konsideratë gjatë auditimit u konstatua se, detyrat dhe përgjegjësitë e departamenteve / drejtorive / sektorëve nuk janë të përcaktuara qartë. Në draft rregulloren e re e funksionimit të MD, janë bërë ndryshime, por vazhdojnë të konstatohen problematikat e rregullores ende në fuqi. Megjithëse MD ka aktualisht 11 drejtori dhe 28 sektorë, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre janë të përshkruara në Kreun III, “funksionimi i strukturave organizative” vetëm në 6 nene të përgjithshme, për 6 struktura përgjegjëse, duke shfaqur problematikë në ndarjen apo evidentimin e përgjegjësisë për çdo njësi organizative. Në draft rregullore mungon emërtimi i drejtorive të përgjithshme, drejtorive dhe sektorëve; Neni 24 “Struktura përgjegjëse për auditimin e brendshëm” mbështetet mbi një ligj të shfuqizuar dhe mungon përshkrimi i punës për pozicion. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e MD”, i ndryshuar, “Neni 9 “Për përmbushjen e kompetencave të veta, Ministri i Drejtësisë miraton rregulla të hollësishme për administrimin e përditshëm të veprimtarisë, funksionimin e brendshëm, përshkrimin e punës të punonjësve, rregullin dhe disiplinën në institucion”; me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar Neni 9 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues”, Pika 4a) propozimin të e sistemit të rregullave dhe procedurave të brendshme të njësisë, Pika 4f) Ndarjen e përgjegjësisë që lidhen me vendimmarrjen, kontrollin, zbatimin dhe vendosjen e linjave të raportimit, në përputhje me përgjegjësitë e deleguara.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 33-42 të Raportit të Auditimit).

Sa më sipër është rekomanduar:

MD të analizojë dhe reflektojë me hollësi në draft Rregulloren e Brendshme: të gjitha ndryshimet e ndodhura në strukturë; të detajohen qartësisht përshkrimet e punës për çdo pozicion; të rifreskohet baza ligjore mbi të cilën mbështeten nene të veçanta brenda draft rregullores.

Përgjigjia e subjektit:

Grupi i punës në vijim, do të qartësojë detyrat e drejtorive të përgjithshme, drejtorive dhe sektorëve, në përputhje me ndryshimet ligjore dhe strukturore me qëllim ndarjen e detyrave dhe përgjegjësisë sipas strukturës dhe organikës së Ministrisë së Drejtësisë në fuqi.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe është *në proces zbatimi*.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Gjetja 8:

MD, nuk ka hartuar planin strategjik në mënyrë periodike për të reflektuar objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit, të cilat janë në zbatim të strategjisë ndërsektoriale. Mos hartimi i Planin Strategjik, në institucion ka shkaktuar mos rishikimin e vazhdueshëm të objektivave të programeve, aktiviteteve dhe projekteve, që duhet të realizohen përmes proceseve të punës. Sa më sipër gjithashtu ndikon në mos përcaktimin e qartë të proceseve të punës, Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; neni 21, pika 2, si dhe Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar nga Ministri i Financave.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 114-124 të Raportit të Auditimit).

Sa më sipër është rekomanduar:

Të merren masa, për të hartuar Planin Strategjik, i cili duhet të përmbajë objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit, për arritjen e qëllimeve strategjike, me persona konkretë përgjegjës për realizimin e tyre. Objektivat strategjike duhet të jenë të lidhura me planin financiar buxhetor përmes objektivave të përcaktuara në mënyrë të qartë për programet, projektet dhe aktivitetet.

Përgjigjia e subjektit:

Plani Strategjik është hartuar dhe diskutuar me të gjitha strukturat e Ministrisë së Drejtësisë dhe grupi i punës për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve do të marrë masat për formalizimin e këtij dokumenti.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe në *proçes zbatimi*.

Gjetja 9:

Nga auditimi u konstatua se, edhe pse është ngritur GMS për vitet objekt auditimi mungon dokumentimi i takimeve periodike të realizuara apo problematikave të trajtuara, duke mos ofruar kështu siguri të arsyeshme mbi kryerjen ose jo të mbledhjeve të GMS-së. Nga GMS nuk është rishqyrtuar vlerësimi i riskut, të cilat duhet të ishin reflektuar në raportin vjetor, i cili duhet të ishte përgatitur nga GMS, për të evidentuar nëse risqet janë duke u rritur ose zvogëluar, me qëllim marrjen e vendimeve nga ana e menaxhimit për reagimin e duhur ndaj riskut.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar” neni 27, Manualin mbi zbatimin e MFK-së pika 4.2.9 “Grupi për menaxhimin strategjik”. Udhëzimit nr. 16 datë 16.07.2016 “Për Përgjegjësitë dhe Detyrat e Koordinatorit të Menaxhimit Financiar...”, pikën 2.2.4

(Trajtuar më hollësisht në faqet 114-124 të Raportit të Auditimit).

Sa më sipër është rekomanduar:

Nëpunësi autorizues gjatë mbledhjeve të GMS të marrë masa për dokumentimin e mbledhjeve dhe çështjeve/problematikave të trajtuara nga anëtarët e grupit të GMS, me qëllim gjurmimin e vendimeve të marra përgjatë takimeve të grupit dhe ndjekjen e zbatimit e tyre.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Përgjigjia e subjektit:

Në vijimësi NA do të marrë të gjitha masat për dokumentimin e takimeve periodike të GMS-së, ndër të tjera edhe do të analizojë vlerësimin i riskut në çdo takim të GMS-së.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe në *proçes zbatimi*.

Gjetja 10:

Menaxherët dhe punonjësit në Ministrinë e Drejtësisë kanë mungesë të njohurive për ligjin e menaxhimit financiar dhe kontrollin, mungesë të theksuar të njohurive në menaxhimin e riskut, si dhe monitorimi i tij. Nga institucioni konstatuam se janë organizuar trajnime me qëllim njohjen dhe shkëmbimin e përvojave mbi praktikat më të mira në fusha të ndryshme, por nuk janë organizuar trajnime mbi njohuritë e ligjit të MFK-së, për rritjen e kapaciteteve profesionale të menaxherëve dhe punonjësve në lidhje me funksionimin e kontrollet e brendshme., në përputhje me Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar neni 20, gërma d dhe Manualin e MFK, Kapitulli III, Mjedisi i kontrollit të brendshëm “Profesionalizmi i stafit”.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 114-124 të Raportit të Auditimit).

Sa më sipër është rekomanduar:

Strukturat përgjegjëse (Sektorët /Drejtoritë dhe kështu me radhë sipas hierarkisë) të marrin masat e duhura për parashikimin e nevojave për zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve, dhe në bazë të këtyre parashikimeve të hartojnë dhe kryejnë trajnime specifike për punonjës të administratës mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe manualin e nxjerrë në zbatim të tij (në veçanti për menaxhimin e riskut pasi u konstatua se, menaxherët e njësisë nuk zotërojnë informacion për qëllimet dhe rëndësinë e tij).

Përgjigjia e subjektit:

Me urdhërin nr.467, datë 11.10.2019 "Për miratimin e regjistrit të riskut të Ministrisë së Drejtësisë" është miratuar regjistri i riskut për të gjitha strukturat e Ministrisë së Drejtësisë. Gjithashtu në vijim të këtij rekomandimi, Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, me shkresën Nr.5844/3, datë 13.09.2019, drejtuar Shkollës Shqiptare të Administratës Publike, ka kërkuar planifikimin e trajnimeve për punonjësit e Ministrisë së Drejtësisë. ASPA me shkresën Nr.623/1, datë 14.10.2019, ka caktuar datën 21 Tetor 2019, për diskutim më të detajuar dhe për modalitetet e zhvillimit të aktivitetit. Më pas është dakortësuar me Shkollën e Administratës Publike për zhvillimin e trajnimit me temë “Menaxhimi Strategjik” u zhvillua në datat 21-22 nentor 2019.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe është *zbatuar*.

Gjetja 11:

Në Ministrinë e Drejtësisë u konstatua se nuk janë marrë masa për hartimin e gjurmës së auditimit për institucionin, e cila është një instrument menaxhimi që mundëson nga njëra anë ndjekjen e ecurisë së një procesi nga fillimi në fund dhe në anën tjetër, ndjekjen e ecurisë së këtij procesi përgjatë strukturave të njësisë, apo ndërmjet vetë njësisë dhe institucioneve të jashtme. Veprime në kundërshtim me nenin 16 të Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015 “Për disa



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 114-124 të Raportit të Auditimit).

Sa më sipër është rekomanduar:

Strukturat përgjegjëse të marrin masat e duhura për të siguruar kontrolle efikase në menaxhimin e parasë publike, nëpërmjet procedurave të shkruara, rregullave të specifikuara mbi ndarjen e detyrave. Pagesat të realizohen vetëm në rastet kur shpenzimi i realizuar është i shoqëruar me te gjithë dokumentacionin përkatës

Përgjigjia e subjektit:

Me urdhërin e Ministrit të Drejtësisë Nr.469, datë 11.10.2019 "Për miratimin e hartës së proceseve të punës të Ministrisë së Drejtësisë" është miratuar harta e proceseve të punës për të gjitha strukturat e Ministrisë së Drejtësisë. Gjithashtu në kuadër të MFK, me Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë Nr.447, datë 30.09.2019 është miratuar gjurma për përgatitje e Programit Buxhetor Afatmesëm.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe në *proçes zbatimi*.

Gjetja 12:

Në MD për sa i përket zbatimit të veprimtarisë së auditimit të brendshëm, përgjatë vitit 2018 u konstatua se ka funksionuar pa drejtuesin e njësisë AB, pa 1 specialist, si dhe pa komitet auditimi. Si drejtues ka shërbyer i ngarkuar në detyrë një prej specialistëve të njësisë, me të drejtë ushtrimi të kësaj detyre deri në emërimin e drejtorit të ri dhe Komitetit të auditimit i ka përfunduar mandati më datë 06.04.2018. Mungesa e plotësisimit të organikës dhe mungesa e një Komiteti të AB, si mbështetës i njësisë së auditimit të brendshëm, gjatë përmbushjes së përgjegjësisë të saj, krijon vështirësi në mirëfunksionimin e kësaj drejtorie dhe përmbushjes së rolit përkatës. Veprime në kundërshtim me VKM nr. 160, datë 2.3.2016 “Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e komitetit të auditimit të brendshëm në njësitë publike” dhe Urdhër të Kryeministrit nr. 166 datë 05.10.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së MD.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 125-136 të Raportit të Auditimit).

Sa më sipër është rekomanduar:

Strukturat përgjegjëse të MB të marrin masa të menjëhershme për plotësimin e organikës së Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm dhe krijimin e Komitetit të AB, për të siguruar mbarëvajtjen e funksionit auditues të njësisë.

Përgjigjia e subjektit:

Për zbatimin e këtij rekomandimi, është krijuar Komitetit i Auditimit të Brendshëm me Urdhrin Nr.182, datë 06.03.2019 dhe me shkresën e Departamentit të Administratës Publike me Nr.4960, datë 23.08.2019, është zbatuar procedura e emërimit (nëpunës civil në periudhë prove), për specialist në Drejtorinë e Auditimit në Ministrinë e Drejtësisë. Në lidhje me plotësimin e vendeve vakant të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm në MD, janë kryer shpalljet për pozicionet,

1Drejtore Auditimit

Referuar njoftimeve të faqes zyrtare të Departamentit të Administratës Publike, procedura



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë ka përfunduar pa fitues për këtë pozicion.

2. Specialist në Drejtorinë e Auditimit (2 pozicione)

Referuar njoftimeve të faqes zyrtare të Departamentit të Administratës Publike, procedura e lëvizjes paralele ka përfunduar pa fitues edhe për këto pozicione. Gjithashtu, referuar njoftimit të faqes zyrtare, është kryer testimi me shkrim, si dhe intervista e strukturuar me gojë dhe ka rezultuar si fituese znj. Adriana Kalemaj dhe më pas me aktin 4960, datë 23.08.2019 të Departamentit të Administratës Publike, znj. Adriana Kalemaj është emëruar në pozicionin Specialist në Drejtorinë e Auditimit. Një pozicion specialisti aktualisht përsëri është vakant. Pozicionet e pa plotësuara, janë në proces rishpallje.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe në *proçes zbatimi*.

Gjetja 13:

Konstatohet se praktikat e auditimit të brendshëm, rezultojnë të pa inventarizuar, sipas kërkesave të parashikuara në “Normat tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë” të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”. Shkresat dhe/ose dokumentet, që lidhen me të, nuk janë evidentuar me të njëjtin numër progresivisht me fraksion, deri në mbyllje të praktikës, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”. Praktikrat (dosjet) e auditimit mbahen në zyrat e Drejtorisë së auditimit të Brendshëm dhe nuk janë arkivuar në protokoll/ arkivin e Ministrisë. Gjatë auditimit të dosjeve të angazhimeve të realizuara u konstatua se, mungonin dokumentet origjinalë mbi të cilat ishin bërë fotokopjet e përfshira në dosje, si dhe mungonte dosja e angazhimit për auditimin e këshillimit, të iniciuar nga titullari me urdhër të MD nr. 413/2, datë 06.02.2017, në 22 zyrat vendore të provës. Auditimi për këto zyra është raportuar në njësinë e harmonizimit në MFE si i përfunduar, por për të nuk është krijuar një dosje me dokumentet përkatës, në të fund të të cilës të jetë raporti apo memo përkatëse, sipas përcaktimeve të Manualit të AB.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 125-136 të Raportit të Auditimit).

Sa më sipër është rekomanduar:

Nga Drejtoria e AB pasi të jenë gjetur dokumentet origjinalë për të gjitha angazhimet e vitit 2017 dhe 2018, të kryhet arkivimi i dosjeve të përfunduara, si dhe të krijohet dosja e angazhimit për auditimin në zyrat vendore të provës.

Përgjigjia e subjektit:

Referuar kësaj gjetje sqarojmë se: në praktikrat audituese të gjendura në zyrën e Drejtorisë së Auditimit, dosjet origjinale me dokumentat e auditimit janë në protokollin e Ministrisë së Drejtësisë, ndërsa letrat e punës së audituesve janë në zyrat e DAB. Meqënëse këto letra janë të audituesve të mëparshëm, të cilët janë larguar nga institucioni i Ministrisë së Drejtësisë, parashikohet të ngrihet një grup punë për evidentimin dhe arkivimin e tyre në përputhje me ligjin nr.9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat". Sa i përket krijimit të dosjes së angazhimit për auditimin në zyrat vendore të Shërbimit të Provës, aktualisht struktura e Auditimit të Brendshëm e ka të pamundur krijimin e dosjes, për shkak të mungesës së personelit. Struktura e Auditimit të Brendshëm, përbëhet nga 5 punonjës (1+4) por ka të emëruar vetëm 2 specialistë. Me plotësimin e strukturës së AB do të bëhet krijimi i dosjes së lartpërmendur.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar nga subjekti, në *proçes zbatimi*.

Gjetja 14: Gjatë auditimit të planit vjetor të auditimit me raportimin përkatës u konstatua mospërputhja e angazhimeve të auditimit, parashikuar në planin fillestar/ të ndryshuar vjetor të auditimeve, me realizimin e tyre. Gjatë fazës së planifikimit u konstatua përfshirja në planifikimin fillestar i angazhimeve në njësitë e varësisë, që kanë brenda strukturave njësi të veta auditimi, si DPB, ZQRPP, ALUIZNI dhe gjatë raportimit është shpjeguar mosrealizimi i këtyre auditimeve me ekzistencën e njësisë brenda këtyre institucioneve, si dhe përfshirje të Institutit të Integritetit të të Përndjekurve Politikë në planin fillestar 2018, ndërkohë që është një njësi jo më varësie e MD, që prej vitit 2014. Përfshirja e angazhimeve të tilla, të iniciuara nga vetë njësia e AB dhe jo nga titullari, flasin për një mos planifikim të mirë të funksionit auditues në MD.

Gjatë auditimit të dy formave të bashkëlidhura të raportimit, atë të shkruar dhe tabelor u konstatua se ekzistojnë diferenca midis pjesës narrative dhe tabelore të raportimit, të cilat flasin për mungesë koherence në raportim, ardhur si rezultat i heqjes së auditimeve jo të mirë planifikuara, i përfshirjes së auditimeve të tjera rastësore apo të mbetura pa u kryer në periudhën e mëparshme dhe plotësimit të pasqyrave për auditimet ende të papërfunduara. Mospërputhjet e mësipërme bien në kundërshtim me Manualin e AB, sipas të cilit “Të dhënat e paraqitura në pasqyra duhet të gjejnë argumentim të detajuar në pjesën e shkruar të dokumentit. Përgatitja e pasqyrave standard ka si qëllim që të vendosë në të njëjtën linjë dhe formë planifikimin dhe rezultatet e veprimtarisë së auditimit të brendshëm”

(Trajtuar më hollësisht në faqet 125-136 të Raportit të Auditimit).

Sa më sipër është rekomanduar:

DAB të marrë masa dhe të vlerësojë me përkushtimin e duhur fazën e planifikimit të punës së saj vjetore; si dhe të raportojë me përgjegjësi dhe saktësi në dy format narrative dhe tabelore, veprimtarinë e kryer prej saj.

Përgjigjia e subjektit:

Në lidhje me këtë sqarojmë se Ligji Nr 114/2015 dt 22.10.2015 2015 “ Për Auditimin e Brendshëm në sektorin public “ dhe manuali i Auditit të Brendshëm , nuk kanë parashikuar ndonjë përcaktim konkret në lidhje me formën e këtij miratimi. Këto dispozita kanë parashikuar dërgimin zyrtar nga titullari, të planeve strategjike dhe vjetore ,tek ministria e Financave Drejtorisë së harmonizimit të Auditimit të Brendshëm). Ky detyrim ligjor është kryer pasi plani strategjik dhe ai vjetor është dërguar zyrtarisht nga Ministria e Drejtësisë, Ministrisë së Financave me shkresën me nr 3438 dt 23.03.2018 dhe plani i Rishikuar me shkresën me nr 2906/2 prot dt 27.09.2018. Në këto kushte kemi realizuar detyrimet ligjore duke i dërguar zyrtarisht Ministrisë së Financave, planet Strategjike dhe vjetor. Në kushtet që këto akte kanë shprehur për miratim dhe nuk kanë shprehur ndonjë formë të miratuar për të shprehur miratim, realizimi i detyrimit për të dërguar këto plane në Ministrinë e Financave, duke pasur parasysh llojet e dokumentave të miratuara nga Normat Teknike Profesionale të shërbimit Arkivor, këto dokumenta janë dërguar nga titullari dhe janë të miratuara.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe në *proçes zbatimi*.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Gjetja 15:

Gjatë raportimeve të veprimtarisë së njësisë së AB, për vitin 2017 dhe 2018 nuk u konstatua, plotësimi dhe raportimi mbi nivelin e pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve, si në pjesën e shkruar ashtu dhe plotësimin e pasqyrës respektive nr. 5 të Manualit të AB. Në dosjen e auditimit të ushtruar në Agjencinë e Trajtimit të Pronës u konstatua moszbatim i njëpasnjëshëm i rekomandimeve. Mosndjekja e zbatimit të rekomandimeve dhe mos raportimi në lidhje me pranimin dhe zbatimin e tyre bie në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 “Për audituesin e brendshëm” Neni 14 Përgjegjësitë e drejtuesit të njësisë së auditimit të brendshëm “Drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm është përgjegjës për: Pika iv) veprimet e ndërmarra nga titullari i njësisë publike për zbatimin e rekomandimeve, si dhe çdo rekomandim të pazbatuar.” dhe Neni 6 “Roli i auditimit të brendshëm është t’i japë mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave të njësisë: Pika ç) duke ndjekur zbatimin e rekomandimeve të dhëna”.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 125-136 të Raportit të Auditimit).

Sa më sipër është rekomanduar:

Titullari i MD të marrë masa institucionale detyruese për moszbatimin e konstatuar të rekomandimeve, si dhe DAB të monitorojë dhe raportojë me përgjegjësi të plotë masën e pranimit, refuzimit dhe zbatimit të rekomandimeve të bëra, në funksion të zbatimit të rolit të auditimit të brendshëm dhe shtimit të vlerës në njësinë audituese dhe të audituar

Përgjigjia e subjektit:

Në lidhje me ndjekjen e Rekomandimeve, Drejtoria e Auditimit, në zbatim të manualit të auditimit për vitin 2018, ka vepruar me prioritet, gjatë hartimit dhe zbatimit, të programe të angazhimit të auditimit duke e paraqitur si pikë programi. Mungesa e paraqitjes së evidencës vjetore të raportimit, të nivelit të pranimit të rekomandimeve për disa subjekte, ka arsye se deri në momentin e raportimit, nuk janë marrë planet e veprimit, të subjekteve të audituara. Rekomandimet e auditimit për vitin 2018, janë caktuara me efekte të zgjatura dhe janë dërguar në pjesën e fundit të vitit, si rrjedhim duke pasur parasysh kohën që duhet për tu zbatuar, do të veprohet në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2019, sipas mundësive që ka pëercaktuar Manuali i Auditimit të Brendshëm, me shkresa raportuese dhe me programin në angazhimin pasardhës.

Në Raport është konstatuar se për vitin 2018 ka mospërputhje, midis pasqyrave të raportimit, në raportimin e evidencave, Sqarojmë se, auditimet e përmendura në proces, e kanë kaluar fazën e shqyrtimit të observacioneve dhe grupi i auditimit në momentin e raportimit dt 31.12.2018 ka qënë në kushtet e vendimit përfundimtar të vlerësimeve të proceseve të auditimit. Në këto kushte lind e drejta dhe detyrimi për të raportuar saktësisht realitetin. Këtë fakt e kanë pranuar: Manuali i Auditimit dhe udhëzimet e Drejtorisë së Harmonizimit për plotësimin e pasqyrave raportuese.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe në *proces zbatimi*.

Gjetje 16:

Gjatë auditimit të dosjes së angazhimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarrimit u konstatua se, bashkëlidhur projekt raportit të dërguar nga subjekti, ishte një shkresë e paprotokolluar “Mbi dërgimin e të dhënave për përmbarruesit gjyqësorë”, sipas të cilës Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit ka dërguar pas njohjes me projekt raportin e auditimit,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

të dhënat mbi përmbaruesit gjyqësorë për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, së bashku me urdhrat e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, për tu firmosur nga ministri, sipas konstatimeve të AB (shkresat bashkëlidhur nuk ishin të firmosura nga ministri). Nga shkresa nr. 2340, datë 21.02.2018 “Mbi dërgimin e projekt raportit të AB” u konstatua se në fund të përmbajtjes së saj i është kërkuar subjektit të audituar, dërgimi i planit të veprimit të firmosur nga njësia e audituar brenda 10 ditëve, që nënkupton marrje të masave nga subjekti i audituar për zbatim të rekomandimeve, që në fazën paraprake të projektit të auditimit. Sipas Manualit të AB, subjektit i dërgohet bashkë me projekt raportin e auditimit vetëm plani i veprimit i sugjeruar dhe i kërkuar kundërshtitë e mundshme të tij brenda 10 ditëve, por plani i veprimit i plotësuar dhe firmosur duhet të kërkohej vetëm pas raportit përfundimtar. Kërkimi i planit të veprimit në fazën e projekt raportit ka krijuar konfuzion në njësinë e audituar, e cila bie në kundërshtim me Manualin e AB, Pika 4.1.12. “Raportet e auditimit dhe plotësimi i plan veprimit nga njësia e audituar”... “Ky plan veprimi do të formojë bazat e punës për ndjekjen e procedurave në të ardhmen dhe i dërgohet njësisë së auditimit të brendshëm jo më vonë se 20 ditë pune pas dërgimit të raportit final”, si dhe Pika 4.1.13.1 “Procedurat e ndjekjes së rekomandimeve të auditimit”... Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të angazhimit të auditimit, plotësohet nga njësia publike e audituar sipas formatit të rekomanduar dhe pasi miratohet nga titullari i njësisë së audituar i dërgohet zyrtarisht NjAB që ka kryer angazhimin e auditimit jo më vonë se 20 ditë pune nga njohja me raportin përfundimtar të auditimit.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 125-136 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Sa më sipër është rekomanduar:

Nga DAB të merren masa, që në shkresat e propozuara për dërgim të projekt raportit të auditimit, të dërgohet plani i veprimit i sugjeruar, por të cilësohet dërgimi dhe firmosja e tij vetëm pas raportit përfundimtar, duke shfaqur rolin e duhur këshillues për veprimtarinë e njësive të audituara.

Përgjigjia e subjektit:

Në lidhje me konstatimin në raport, për kërkesën e auditimit në fazën e projekt raportit, për plan veprimin e zbatimit të rekomandimeve. Sqarojmë se kjo kërkesë është në funksion të pikes 4.1.11 Hapi 10; Përgatitja e projekt raportit të auditimit të brendshëm dhe raportimi i gjetjeve të auditimit të menaxheri i njësisë , ku parashikohet që pala e audituar të reagojë në lidhje me rekomandimet që në këtë fazë .Pra nënshkrimi i plan veprimit në këtë fazë , do të ketë rëndësinë e nivelit të pranimit të rekomandimeve në fazën e projekt raportit. Në raport janë konstatuar gjetje në lidhje me dosjet e auditimit. Sqarojmë se në lidhje me Autorizimin e subjektit Komiteti Shqiptar i Birësimeve që ka rezultuar pa nr protokollit , është një rast i vecuar, që ka ndodhur në sektorin e protokollit .Afati i nënshkrimit të autorizimit verifikohet nga dt që korensponduesi ka nënshkruar në hartimin e shkresës (dt 03.07.2018) dhe brenda 24 orësh është hartuar dhe dërguar i cili është nënshkruar me nr 7673 prot dt 06/07/2018. Me po këtë dosje është konstatuar se dërgimi i raportit përfundimtar i auditimit është bërë me një nr protokollit që nuk i përkiste këtij programi auditimi. Sqarojmë se raporti përfundimtar me shkresën me nr. 256 dt 14.01.2018 është lapsus që ndodh shpesh në fillimit e vitit ushtrimor sepse viti duhej të ishte shkruar 2019 dhe si rrjedhojë ky raport i përket auditimit të realizuar me programin nr 7673 prot dt 06.07.2018.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe në *proçes zbatimi*.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në "MINISTRINË E DREJTËSISË"

B.I. MASA SHPERBLIM DËMI

Gjetja 1:

Nga auditimi i përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare të procedurës me objekt "Përshtatje emergjente e ambienteve të godinës së Ministrisë së Drejtësisë" u konstatua se në kontratën "Përshtatje emergjente e ambienteve të godinës së Ministrisë së Drejtësisë", kapitulli i punimeve të prishjeve, zëri nr. 2, nr. anal 2.426/1 "Prishje muri tulle me pastrim në EC", zërat e prishje shtresave të tarracës (Analizë), çmontim dyer/dritare, metalike, çmontim kangiella metalike, prishje suvatimi, shtresa pllaka etj, në përlllogaritjen e fondit limit e miratuar nga AK, zërat e punimeve janë llogaritur në përputhje me VKM nr. 629, datë 15.07.2015. Nga verifikimi i analizave sipas manualeve për zërat nr. anal 2.426/1 "Prishje muri tulle me pastrim", dhe zërave të tjerë me analiza çmimesh, konstatohen se në strukturën e çmimit përfshihet edhe transporti i prishjeve. Gjithashtu sipas VKM nr. 629, datë 15.07.2015, për prishje të zërave të tjerë (të cilët nuk janë në manual), merret norma e kohës së punës me 60 % e ndërtimit të ri, në të cilën përfshihet edhe transporti i tyre. Ndërkohë, po në kapitullin e punimeve të prishjeve është përlllogaritur edhe zëri nr. 11 "Transport me krahë" me çmimin prej 637 lek/m³ (në përlllogaritjen e fondit limit) dhe çmimi i ofertuar nga OE "Eurondërtim 2000" shpk me 590 lek/ m³, i cili është zë pune i mbivendosur proceseve të prishjeve, pasi përfshihet në transport (brenda objektit) bashkë me ngarkimin në automjet, të cilat janë pjesë e shpenzimeve plotësuese prej 8% të çmimit.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 62-113 të Raportit të Auditimit).

Sa më sipër është rekomanduar:

Nga Ministria e Drejtësisë, të marrin masa, të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për dëmin ekonomik të konstatuar dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për shpërblimin e këtij dëmi në vlerën prej 92,040 lekë me TVSH, nga sipërmarrësi i punimeve.

Përgjigjia e subjektit:

Në zbatim të rekomandimit të lënë, nga KLSH, nga Nëpunësi autorizues (Sekretari i Përgjithëm) ka dërguar shkresën nr.7537prot datë 07.11.2019 me objekt "Për arkëtim detyrimi, sipas rekomandimit të KLSH-së", operatorit ekonomik "Erondërtimi 2000" shpk, së bashku me faturën për arkëtim nr.14 datë 06.11.2019, nëpërmjet së cilës, operatori duhet të derdhi për llogari të Ministrisë së Drejtësisë, në llogarinë e Degës së Thesarit Tiranë, shumën 92,040 lekë.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe *është në proces zbatimi.*

B.II. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN DHE MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

Gjetja 1:

Nga auditimi i procedurës me objekt "Sistemi Elektronik për Dixhitalizimin e Arkivës Gjyqësore", realizuar në MD në vitin 2017, u konstatua se:

- Në bazë të Urdhër Prokurimi nr. 527/6, datë 14.04.2017, është prokuruar kontrata me fond limit në vlerën prej 26,666,667 lekë pa tvsh, ku është marrë miratimi nga Agjencia Kombëtare



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), si për fondin e parashikuar, hartimin e kriterëve për kualifikim, si dhe për vendodhjen e instalimit të softit. Rezultoi se, AK ka paraqitur vendndodhje të ndryshme të instalimit të softit, ndryshe në projektin e miratuar nga AKSHI, ndryshe në DT dhe ndryshe në kontratën e lidhur me operatorin fitues. Këto veprime tregojnë mos seriozitet nga Titullari i AK zj. Juliana Hoxha, duke vepruar në kundërshtim me bazën ligjore të prokurimit publik.

-Njësia e prokurimit me përbërje (Marsuela Aliaj, Eris Adhami dhe Omela Bleta), ka hartuar e miratuar DT, duke mos argumentuar vendosjen e kriterëve për kualifikim dhe kriterëve të veçanta në rubrikën e DST nga 3.3.1 deri në 3.3.24, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 61, pika 2, veprim ky që ka zvogëluar konkurrencën, pasi në tender janë paraqitur vetëm 2 operatorë ekonomike.

-Me shpalljen e operatorit ekonomik fitues “Soft Solution”shpk është lidhur Kontratë Shërbimi nr. 527/9 datë 26.05.2017, e cila nga pikëpamja formale, ka mangësi në këta elementë: objekti, qëllimi, vendndodhja e instalimit të softit, afati i kontratës dhe kushtet e veçanta. Këto fakte tregojnë mangësitë e AK, përse i përket formulimit dhe miratimit të kontratës, në kundërshtim me DT.

- Sipas Urdhër të titullarit AK me nr. 527/10 datë 29.05.2017, me përbërje (z.Eris Adhami, ish-Drejtor i Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit, z.Eris Sheshi, ish- Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme dhe zj.Gentjana Markokaj, ish-përfaqësuese e Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor) është miratuar ngritja e grupit të punës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës, i cili duhet të pasqyrojë nëpërmjet procesverbaleve, për çdo verifikim të shërbimit të ofruar, në mbështetje të kontratës. Nga auditimi, rezultoi që grupi i mësipërm nuk ka paraqitur asnjë procesverbal për shërbimin e ofruar, por është justifikuar, në proces-verbalin datës 09.02.2018 duke u shprehur se, “.....nuk ka pasur dijeni si dhe nuk mbajnë asnjë përgjegjësi ligjore dhe kontraktuale të shkaktuar nga mosndjekja e kontratës”. Ky fakt tregon se, sistemi i kontrollit të brendshëm për sektorin e burimeve njerëzore nuk ka funksionuar, para dhe pas ndryshimit të organikës, në bazë të Urdhrit nr. 166 të Kryeministrit, datë 05.10.2017 “Për miratimin e strukturës dhe Organikës së Ministrisë së Drejtësisë”, pasi edhe ish-sekretari i përgjithshëm i periudhës respektive(zj.Elira Kokona) nuk ka marrë asnjë masë, në zbatim të detyrës si titullar i AK-së në bazë të urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr.3826/3. Datë13.10.2017 “Për delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor sekretarit të përgjithshëm.”, kjo në kundërshtim me neni 56 (titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar) i VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

-Sipas shkresës nr. 3774 prot, datë 06.06.2017, nga operatori ekonomik fitues “Soft & Solution” shpk është dorëzuar fatura tatimore shitje nr. 224, datë 06.06.2017, me vlerë totale të ofertës fituese **prej 31,224,000 lekë me TVSh**, e firmosur vetëm nga përfaqësuesi i operatorit ekonomik. Kjo faturë tatimore nuk është likuiduar nga Ministria e Drejtësisë.

Sipas Faturës tatimore është kërkuar të paguhet, çdo element përbërës i kontratës duke përfshirë dhe mirëmbajtja të përcaktuar sipas DT, e cila do të realizohej me periudhë kohore prej 48 muaj. Pra lëshimi i faturës tatimore, nga ana e operatorit ekonomik Soft & Solution”shpk është në kundërshtim me, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe me dokumentat e tenderit, duke kërkuar pagesën e krijimit të softit dhe implementimi menjëherë, ku sipas DT e kishte për 45 ditë për krijimin e softit dhe shërbimin e mirëmbajtjes për 48 muaj. Këto shërbime nuk janë të dokumentuar nga AK deri në momentin e kryerjes së këtij auditimi, pasi ende kjo kontratë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në "MINISTRINË E DREJTËSISË"

nuk është realizuar në mënyrë të suksesshme. *(Drejtuesit aktual të MD, si nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues, i periudhës së tanishme nuk marrin përsipër të shpjegojnë mënyrën sesi është paraqitur, kjo faturë tatimore shitje, pasi në kohën kur është dorëzuar kjo faturë në organikën e MD, figuronin punonjës të tjerë të administratës).*

- Nga auditimi u konstatua se, ecuria për zbatimin e kontratës, është vijuar me Urdhrin e titullarit të AK-së nr. 8610/2 datë 08.08.2018 nga ish-nëpunësi autorizues i kohës (zj. Elira Kokona), duke ngritur grup pune, ku qëllimi kryesor është përshkrimi ecurisë dhe zgjidhjet e mundshme, për ekzekutimin përfundimtar të kontratës. Në bazë të MEMO-s nr. 23/1, datë 23.10.2018, grupi i punës, është shprehur se, *"...sistemi i instaluar në ambientin "test" të Ministrinë e Drejtësisë, nuk mund të vlerësohet nga ana teknike, sepse aplikacioni "softëar" nuk mund të përbëjë sistem të plotë dhe funksional, kjo për shkak të mungesës të saktë të vendndodhjes, e cila duhet të jetë pranë Arkivit Qendror të Gjyqësorit në Lundër, të mungesës së infrastrukturës së nevojshme dhe të domosdoshme të pajisjeve si dhe në mungesë të burimeve njerëzore nga ana e AK-së, për implementimin e saj."*, pra grupi i punës ka argumentuar se ecuria e implementimit të kontratës nuk mund të bëhet, për shkak të problematikave, të cilat janë si pasojë e veprimeve të mëparshme të AK.

Nisur sa më sipër, nga ana e titullarit të AK të cilët janë në cilësinë dhe të nëpunësit autorizues, të cilët kanë ndryshuar kohë mbas kohe, nuk kanë analizuar arsyet dhe shkaqet, e mos ekzekutimit të kontratës në mënyrë të suksesshme, veprime të cilat mund të krijojnë risqe ekonomike në disfavor të Buxhetit të Shtetit, duke bërë të mundur që, kontrata nr. 527/9 prot, datë 26.05.2017 të mos jetë efektive, efiçente dhe me ekonomicitet në vlerën prej 31,224,000 (tridhjetë e një milion e dyqind e njëzetë e katër mijë) lekë me tvsh, pasi gjithë hallkat e realizimit të procedurës tenderuese, kanë rezultuar me performacë të ulët.

Si dhe më kryesorja nga institucioni i MD si AK nuk është marrë asnjë masë administrative/ masë disiplinore, për shkeljet e konstatuara, të rregullave të prokurimeve publike, të ligjit nr. 152/2013 01.10.2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, *(Trajtuar më hollësisht në faqet 52-103 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Sa më sipër është rekomanduar:

Ministria e Drejtësisë, të marrë masa, dhe të analizojnë me grup pune të veçantë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për përdorimin pa efektivitet, pa ekonomicitet dhe pa efiçencë të fondeve buxhetore në vlerën prej 31,224,000 lekë me tvsh.

Përgjigjia e subjektit:

Ministria e Drejtësisë do t'ju informojë në vijim mbi analizën që do të kryejë grupi i punës i ngritur me urdhrin nr. 424 datë 04.09.2019 dhe do të ndërmarë hapat e duhur bazuar në raportin e grupit të punës.

Komenti i grupit të auditimit:

Ky rekomandim është pranuar nga subjekti i audituar dhe është përfshirë në programin e punës dhe planin e veprimit të dërguar në KLSH. Mbi bazën e angazhimit të marrë, spjegimeve verbale të NA të institucionit si dhe duke qenë brenda periudhës 6 (gjashtë) mujore për raportimin e ecurisë së zbatimit rekomandimeve, konsiderohet ***në proces zbatimi.***

C. MASA ADMINISTRATIVE

Gjetja 1: Nga auditimi i procedurës me objekt "Sistemi Elektronik për Dixhitalizimin e Arkivës Gjyqësore", realizuar në MD në vitin 2017, u konstatua se:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

- Në bazë të Urdhër Prokurimi nr. 527/6, datë 14.04.2017, është prokuruar kontrata me fond limit në vlerën prej 26,666,667 lekë pa tvsh, ku është marrë miratimi nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), si për fondin e parashikuar, hartimin e kriterëve për kualifikim, si dhe për vendodhjen e instalimit të softit. Rezultoi se, AK ka paraqitur vendndodhje të ndryshme të instalimit të softit, ndryshe në projektin e miratuar nga AKSHI, ndryshe në DT dhe ndryshe në kontratën e lidhur me operatorin fitues. Këto veprime tregojnë mos seriozitet nga Titullari i AK zj. Juliana Hoxha, duke vepruar në kundërshtim me bazën ligjore të prokurimit publik.

-Njësia e prokurimit me përbërje (Marsuela Aliaj, Eris Adhami dhe Omela Bleta), ka hartuar e miratuar DT, duke mos argumentuar vendosjen e kriterëve për kualifikim dhe kriterëve të veçanta në rubrikën e DST nga 3.3.1 deri në 3.3.24, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 61, pika 2, veprim ky që ka zvogëluar konkurrencën, pasi në tender janë paraqitur vetëm 2 operatorë ekonomike.

-Me shpalljen e operatorit ekonomik fitues “Soft Solution”shpk është lidhur Kontratë Shërbimi nr. 527/9 datë 26.05.2017, e cila nga pikëpamja formale, ka mangësi në këta elementë: objekti, qëllimi, vendndodhja e instalimit të softit, afati i kontratës dhe kushtet e veçanta. Këto fakte tregojnë mangësitë e AK, përse i përket formulimit dhe miratimit të kontratës, në kundërshtim me DT.

- Sipas Urdhër të titullarit AK me nr. 527/10 datë 29.05.2017, me përbërje (z.Eris Adhami, ish-Drejtor i Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit, z.Eris Sheshi, ish- Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme dhe zj.Gentjana Markokaj, ish-përfaqësuese e Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor) është miratuar ngritja e grupit të punës për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës, i cili duhet të pasqyrojë nëpërmjet procesverbaleve, për çdo verifikim të shërbimit të ofruar, në mbështetje të kontratës. Nga auditimi, rezultoi që grupi i mësipërm nuk ka paraqitur asnjë procesverbal për shërbimin e ofruar, por është justifikuar, në proces-verbalin datës 09.02.2018 duke u shprehur se, “.....nuk ka pasur dijeni si dhe nuk mbajnë asnjë përgjegjësi ligjore dhe kontraktuale të shkaktuar nga mosndjekja e kontratës”. Ky fakt tregon se, sistemi i kontrollit të brendshëm për sektorin e burimeve njerëzore nuk ka funksionuar, para dhe pas ndryshimit të organikës, në bazë të Urdhrit nr. 166 të Kryeministrit, datë 05.10.2017 “Për miratimin e strukturës dhe Organikës së Ministrisë së Drejtësisë”, pasi edhe ish-sekretari i përgjithshëm i periudhës respektive(zj.Elira Kokona) nuk ka marrë asnjë masë, në zbatim të detyrës si titullar i AK-së në bazë të urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr.3826/3. Datë13.10.2017 “Për delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor sekretarit të përgjithshëm.”, kjo në kundërshtim me neni 56 (titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar) i VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

-Sipas shkresës nr. 3774 prot, datë 06.06.2017, nga operatori ekonomik fitues “Soft & Solution”shpk është dorëzuar fatura tatimore shitje nr. 224, datë 06.06.2017, me vlerë totale të ofertës fituese prej 31,224,000 lekë me TVSh, e firmosur vetëm nga përfaqësuesi i operatorit ekonomik. Kjo faturë tatimore nuk është likuiduar nga Ministria e Drejtësisë.

Sipas Faturës tatimore është kërkuar të paguhet, çdo element përbërës i kontratës duke përfshirë dhe mirëmbajtja të përcaktuar sipas DT, e cila do të realizohej me periudhë kohore prej 48 muaj. Pra lëshimi i faturës tatimore, nga ana e operatorit ekonomik Soft & Solution”shpk është në kundërshtim me, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe me dokumentat e tenderit, duke kërkuar pagesën e krijimit të softit dhe implementimi menjëherë, ku sipas DT e kishte për 45



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në "MINISTRINË E DREJTËSISË"

ditë për krijimin e softit dhe shërbimin e mirëmbajtjes për 48 muaj. Këto shërbime nuk janë të dokumentuar nga AK deri në momentin e kryerjes së këtij auditimi, pasi ende kjo kontratë nuk është realizuar në mënyrë të suksesshme. *(Drejtuesit aktual të MD, si nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues, i periudhës së tanishme nuk marrin përsipër të shpjegojnë mënyrën sesi është paraqitur, kjo faturë tatimore shitje, pasi në kohën kur është dorëzuar kjo faturë në organikën e MD, figuronin punonjës të tjerë të administratës).*

- Nga auditimi u konstatua se, ecuria për zbatimin e kontratës, është vijuar me Urdhrin e titullarit të AK-së nr. 8610/2 datë 08.08.2018 nga ish-nëpunësi autorizues i kohës (zj. Elira Kokona), duke ngritur grup pune, ku qëllimi kryesor është përshkrimi ecurisë dhe zgjidhjet e mundshme, për ekzekutimin përfundimtar të kontratës. Në bazë të MEMO-s nr. 23/1, datë 23.10.2018, grupi i punës, është shprehur se, *"...sistemi i instaluar në ambientin "test" të Ministrinë e Drejtësisë, nuk mund të vlerësohet nga ana teknike, sepse aplikacioni "softëar" nuk mund të përbëjë sistem të plotë dhe funksional, kjo për shkak të mungesës së saktë të vendndodhjes, e cila duhet të jetë pranë Arkivit Qendror të Gjyqësorit në Lundër, të mungesës së infrastrukturës së nevojshme dhe të domosdoshme të pajisjeve si dhe në mungesë të burimeve njerëzore nga ana e AK-së, për implementimin e saj."*, pra grupi i punës ka argumentuar se ecuria e implementimit të kontratës nuk mund të bëhet, për shkak të problematikave, të cilat janë si pasojë e veprimeve të mëparshme të AK.

Nisur sa më sipër, nga ana e titullarit të AK të cilët janë në cilësinë dhe të nëpunësit autorizues, të cilët kanë ndryshuar kohë mbas kohe, nuk kanë analizuar arsyet dhe shkaqet, e mos ekzekutimit të kontratës në mënyrë të suksesshme, veprime të cilat mund të krijojnë risqe ekonomike në disfavor të Buxhetit të Shtetit, duke bërë të mundur që, kontrata nr. 527/9 prot, datë 26.05.2017 të mos jetë efektive, eficiente dhe me ekonomicitet në vlerën prej 31,224,000 (tridhjetë e një milion e dyqind e njëzetë e katër mijë) lekë me tvsh, pasi gjithë hallkat e realizimit të procedurës tenderuese, kanë rezultuar me performacë të ulët.

Si dhe më kryesorja nga institucioni i MD si AK nuk është marrë asnjë masë administrative/masë disiplinore, për shkeljet e konstatuara, të rregullave të prokurimeve publike, të ligjit nr. 152/2013 01.10.2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, *(Trajtuar më hollësisht në faqet 52-103 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Sa më sipër është rekomanduar:

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike në nenet 23,46, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, si dhe nenet 1, 56, 61/2, 77 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në aktkonstatimin nr.1 vërejtjeve komentet e subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit përfundimtar të auditimit.

Mbështetur në nenet 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative" dhe bazuar në nenin 15 shkronja (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), për punonjësit e sipërcituar Gjetja 1 (Masa administrative).**

Përgjigjia e subjektit:

Ministria e Drejtësisë do t'ju informojë në vijim mbi analizën që do të kryejë grupi i punës i ngritur dhe do të ndërmarë hapat e duhur bazuar në raportin e grupit të punës.



KONTROLLI I LARTË I SHTEJIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Komenti i grupit të auditimit:

Ky rekomandim është pranuar nga subjekti i audituar dhe është përfshirë në programin e punës dhe planin e veprimit të dërguar në KLSH. Mbi bazën e angazhimit të marrë, spjegimeve verbale të NA të institucionit si dhe duke qenë brenda periudhës 6 (gjashtë) mujore për raportimin e ecurisë së zbatimit rekomandimeve, konsiderohet *në proces zbatimi*.

D. MASA DISIPLINORE E ADMINSTRATIVE

Gjetja 1:

Nga auditimi i procedurës së prokurimit, të klasifikuara në nivelin “E kufizuar”, me objekt “Blerje pajisje të teknologjisë dhe informacionit dhe pajisjeve të tjera për mobilimin e zyrave të Kolegjit të Apelit-Vetting-ut”, viti 2017, realizuar në MD, u konstatua se:

- AK, ka miratuar Urdhër Prokurimi nr.3/2 datë 04.12.2017, me objekt kontrate për mallra dhe shërbim, duke i vendosur në një procedurë të vetme, blerje pajisje teknologjic (FV), dhe mobilim (FV).

- Komisioni i Hartimit të Dokumenteve të Tenderit me përbërje (Marsuela Aliaj, Entela Muha dhe Eris Adhami) ka përllogaritur vlerën e fondit limit për mobilim prej 10,535,400 lekë pa tvsh, e barasvlershme me 30% e vlerës totale së kontratës prej 31,283,040 lekë pa TVSh, ku është konstatuar se, mungon plani mobilimit, specifikimet teknike, preventivi me zërat dhe sasitë përkatëse. Ndërsa, përllogaritja e sistemeve dhe pajisjeve elektronike në total, është bërë sipas projekt zbatimit, duke u mbështetur në shkresën nr. 3589/1, datë 24.11.2017, dhe ka marrë miratimin nga institucioni i AKSHI-it.

- Komisioni i Hartimit të Dokumenteve të Tenderit, ka hartuar DT duke përcaktuar kriteret për kualifikim dhe mbështetur në Udhëzimin nr. 806 datë 30.01.2015, të Ministrit të Drejtësisë për “Zbatimin e VKM nr. 701, datë 22.10.2015 “Për miratimin e rregullores “për sigurimin e informacionit të klasifikuar në fushën industriale” Kreu II/2, germa 5(e), ka ftuar 3 operatorë ekonomikë për të marrë pjesë në prokurim.

Nga auditimi pranë faqes on-line të Qendrës Kombëtare të Biznesit, në lidhje me objektin e veprimtarisë së operatorëve të ftuar, rezultoi se, OE “PC STORE” shpk, OE “KREATIX”shpk dhe OE “IT PARTNERS”shpk, nuk kanë objekt aktiviteti në fushën e mobilimit, por vetëm në fushën e IT, ndonëse në DT në pikën 2.1 Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë, është kërkuar që “Operatori ekonomik duhet të paraqesë ekstraktin e regjistrimit në QKB ku të ketë të përfshirë në objektin e veprimtarisë së saj edhe objektin e kontratës në fjalë”.

-Komisioni i Negocimit të Vlerësimit të Ofertave me përbërje (Risena Xhaja, Gojart Laçi dhe Lysjen Ali), në datën 12.12.2017, datë në të cilën është bërë hapja e ofertave dhe vlerësimi i dokumentacionit vendosi të kualifikojë në vend të pare dhe të shpallë fitues operatorin ekonomik “PC STORE” shpk me vlerë oferte 31,280,000 lekë pa tvsh dhe ka lidhur Kontrata me nr.3/15, datë 15.12.2017. OE fitues nuk e ka si objekt në aktivitetin e tij mobilimin, por vetëm pajisjet elektronike, e vërtetuar kjo nga të dhënat e Ekstrakti të QKB datë 26.09.2017 dhe noterizuar me nr. 2354 Rep datë 10.12.2017.

-Gjithashtu, me miratimin e VKM-së nr. 46 datë 31.01.2018 “Për disa ndryshime në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 518, datë 20.09.2017, për një ndryshim në Vendimin nr. 518 datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave, është shtuar sipërfaqja e ambienteve duke krijuar strukturën e re, të Komisionerit Publik të Vettingut. Për këtë arsye, AK ka marrë nga buxheti i shtetitshtesën e vlerës së pajisjeve elektronike dhe pajisjeve për mobilim në shumën 3,065,700 lekë pa tvsh, dhe ka lidhur me OE “PC STORE” shpk shtesën e kontratës me nr. 3/4, datë 28.03.2018.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 62-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Sa më sipër është rekomanduar:

Mbështetur në nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, nenin 59 “Kompetencat dhe procedurat për masat disiplinore” të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 171, datë 26.03.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil” i ndryshuar, i rekomandojmë Ministrin të Drejtësisë:

Të vlerësojë, në varësi të analizës së përgjegjësisë, shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara të procedurës së prokurimit, të klasifikuara në nivelin “E kufizuar” me objekt “Blerje pajisje të teknologjisë dhe informacionit dhe pajisjeve të tjera për mobilimin e zyrave të Kolegjit të Apelit –Vetting-ut”, viti 2017 dhe të trajtuara në Aktkonstatimin nr.3 dhe në Raportin Përfundimtar të Auditimit, dhe të kërkojë fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore nga “vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil” për personat e sipërcituar që gjenden në Gjetjen 1 (Masa administrative dhe disiplinore).

Përgjigjia e subjektit:

Ministri i Drejtësisë, nuk është shprehur akoma në lidhje me këtë rekomandim.

Komenti i grupit të auditimit:

Për sa më sipër ky rekomandim konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe është *proçes zbatimi*.

✚ Drejtimi 2: “Përputhshmëria ligjore për marrëdhëniet e punës dhe të pagave, realizimi i fondit të pagave, shpërblimeve, sigurimeve shoqërore e të tjera personeli”

a. Auditimi i Përputhshmërisë së Strukturës Organizative të miratuar.

- Nga auditimi i përputhshmërisë së strukturës organizative të institucionit, për periudhën 01 Janar 2018 – 30 Tetor 2019 u konstatua se, struktura dhe organika e MD-së, është hartuar dhe zbatuar në kërkesat e Ligjit nr. 8678 datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, në Rregulloren e Brendshme të miratuar nga Ministri i Drejtësisë me urdhër nr. 5745 datë 13.08.2008 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë” dhe ndryshimet e saj miratuar nga Ministri i Drejtësisë me urdhrat nr. 5588 datë 06.07.2009, nr. 8705/1 datë 03.11.2009, nr. 6037 datë 02.09.2011, nr. 371/1 datë 10.09.2013. Në mbështetje të Ligjit nr. 8678 datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, ndryshuar me ligjin nr. 9112 datë 24.7.2003, nr. 9694 datë 19.3.2007, nr. 33 datë 21.3.2012, nr. 40 datë 30.3.2017, Ministri i Drejtësisë miraton rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të ministrisë, por ndryshimi i fundit ligjor për funksionimin e MD, i datës 30.03.2017 nuk është i shoqëruar ende me një ndryshimet në rregulloren e brendshme të funksionimit të institucionit. Kjo problematikë është trajtuar edhe në auditimin e mëparshëm të KLSH pranë MD-së të cilës i janë adresuar rekomandimet përkatëse, të cilat vijojnë ende të papërbushura. (Trajtuar më hollësisht në drejtimin nr.1 të këtij Projekraporti).

Kryeministri ka miratuar strukturën dhe organikën e Ministrisë së Drejtësisë për vitet 2017 dhe 2018 përkatësisht me urdhrin nr. 76 datë 28.04.2016, i cili ka qëndruar në fuqi deri në urdhrin nr. 166 datë 05.10.2017, të ndryshuar, me urdhrin nr. 238 datë 13.12.2017.

Struktura organike e MD për periudhën 1 Janar 2018 – 30 Tetor 2019 është përmbledhur në tabelën e poshtëshënuar:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Tabela nr.2.1: “Struktura organike e MD 1Janar 2019– 30 Tetor 2019, Urdhri nr.238 dt.13.12.2017”

1 Janar 2018		Drejtori	Sektorë	Nr.Punonjës	30 Tetor 2019	Drejtori	Sektorë	Nr.Punonjës
	Kabineti	-	-	16 + 2	Kabineti	-	-	16 + 2
Drejtori të përgjithshme	Drejtoria e P. në fushën e drejtësisë	3	7	27	Drejtoria e P. në fushën e drejtësisë	3	7	27
	D. P. e kodifikimit dhe harmonizimit të legjislatcionit	2	5	19	D. P. e kodifikimit dhe harmonizimit të legjislatcionit	2	5	19
	D. P. rregullatorë e çështjeve të drejtësisë	3	9	41	D. P. rregullatorë e çështjeve të drejtësisë	3	9	41
	D. P. ekonomike dhe shërbimeve mbështetëse	2	7	39	D. P. ekonomike dhe shërbimeve mbështetëse	2	7	39
Drejtori	Drejtoria e Auditimit	1	-	5	Drejtoria e Auditimit	1	-	5
Totali		11	28	149		11	28	149

Burimi: MD, Përpunuar nga Grupi i auditimit

Nga auditimi i përputhshmërisë së strukturës organizative, konstatohet se MD funksionon me 11 Drejtori dhe 28 Sektorë, në zbatim të urdhrin nr. 238 datë 13.12.2017 i cili ka hyrë në fuqi më 1 Janar 2018 dhe citon:

pika 2/a: shtohen 2 pozicione në Kabinet;
pika 2/b: shtohet 1 pozicion në “ Sektorin e Administrimit të Aseteve dhe Shërbimeve Mbështetëse”, pjesë e “ Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse”. pika 3: numri i punonjësve të MD të jetë, gjithsej 149 veta.

- Nga auditimi i përputhshmërisë së Rregullores së Brendshme “Për Organizimin dhe Funksionimin e MD-së”, me strukturën organizative të saj, u konstatua se:

1. Në rregulloren e brendshme strukturat përbërëse të ministrisë janë kabineti, drejtoria, sektori dhe zyra. Zyra sipas kësaj rregulloreje konsiderohet si pjesë përbërëse e strukturës së sektorëve dhe drejtorive. Emërtimi i saj si pjesë e strukturës bie në kundërshtim me ligjin nr. 90/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore”, kreu III “Organizimi i Brendshëm i Institucioneve të Administratës Shtetërore”, neni 11 “Struktura e ministrisë”, pika 1 “Ministria organizohet në këto struktura organizative hierarkike:

- a) sekretari i përgjithshëm;
- b) drejtoritë e përgjithshme;
- c) drejtoritë;
- ç) sektorët dhe

neni 12, pika 1 “Sektori është struktura administrative më e ulët e organizimit të brendshëm të aparatit të ministrisë” si dhe ligji organik i institucionit nr.8678, datë 14.5.2001 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, neni 8 *Strukturat organizative në Ministrinë e Drejtësisë*, ku përcaktohet sërish i njëjti nivel hierarkik si në ligjin nr. 90/2012.

Pra në të njëjtin arsyetim sa trajtuar më sipër, mungesa e saj ndikon negativisht në qartësinë e veprimtarisë administrative e ligjore në vijueshmëri dhe krijon risk të lartë operacional.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në "MINISTRINË E DREJTËSISË"

b) Personeli dhe vendet e lira.

- Nga krahasimi i vendeve të plotësuara me strukturën organike të muajit Tetor 2019, vihen re 24 vende pune të lira të përmbledhura në tabelën e poshtëshënuar:

Tabela nr.2.2 "Kategoritë e lira sipas plotësimit të strukturës organike Tetor 2019"

Kategoria e pozicionit të nëpunësit civil	Pozicioni në MD	Tetor 2019
I-b	-	1
II-a	drejtor i përgjithshëm	2
II-b	drejtor	7
III-a	përgjegjës sektori	3
III-b	specialist	9
IV-a	shofer	1
IV-b	specialist protokolli	1
Total		24

Burimi: MD, Përpunuar nga grupi i auditimit

Nga auditimi i strukturës konstatohet mungesë në pozicione drejtuese e specialistësh, kryesisht në Drejtorinë e Hartimit të Legjislacionit: 1 drejtor, 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë. Në Drejtorinë e Auditimit 1 drejtor, 1 specialist, (1 punonjës i pezulluar). Në Sektorin e Burimeve Njerëzore 2 specialistë.

- Për periudhën Janar – Tetor 2019 rekrutimi i punonjësve është bazuar në VKM nr. 766 datë 26.12.2018 "Për punësimin e studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të shërbimit civil, për vitin 2019", në procedurat e konkurimit pranë Departamentit të Administratës Publike (DAP), referuar publikimeve të bëra për vende vakante pune në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit". Në muajin Mars 2019 kanë nënshkruar kontratë individuale 1 vjeçare me MD, 8 të rinj sipas pozicioneve e sektorëve përkatës janë paraqitur në tabelën e poshtëshënuar:

Tabela nr. 2.3 "Emërimi i studentëve të ekselencës, VKM nr.766 datë 26.12.2018"

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni	Spektori
1	Roland Stafa	Specialist	Spektori i Projekteve IPA dhe Donatorëve
2	Megi Çela	Specialiste	Spektori i Projektit Antikorrupsion
3	Elsa Gjini	Specialiste	Spektori i Reformave Ligjore dhe Përafrimit të Legjislacionit
4	Klobeta Zylyfi	Specialiste	Spektori i Vlerësimit të Akteve Nënligjore dhe Marrëveshjeve
5	Artens Lazaj	Specialist	Spektori i Vlerësimit të Akteve Nënligjore dhe Marrëveshjeve
6	Kristina Puci	Specialiste	Spektori për Drejtësinë Penale për të Miturit
7	Enea Babameto	Specialist	Spektori i Monitorimit të Institucioneve të tjera të Varësisë
8	Izaura Çollaku	Sp/Redakt.	Spektori i Arkiv - Protokollit

Burimi: MD, Përpunuar nga grupi i auditimit

U audituan me përzgjedhje të rastësishme, diplomat e Elsa Gjinit, Artens Lazaj dhe Enea Babameto, të cilat rezultuan në përputhshmëri me termin "student ekselent" dhe kanë përfunduar studimet universitare duke filluar nga viti 2017 e në vijim me mesatare 9.00 – 10.00.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

- Rekrutimet e tjera janë bërë në bazë të VKM nr.16 datë 16.01.2019 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2019, në njësitë e qeverisjes qendrore” për MD, janë përcaktuar 5 punonjës me emërimet përkatëse: 1 operator, 2 punonjës arkivi dhe 2 nëpunës informacioni. Në bazë të VKM nr. 483 datë 10.07.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.16 datë 16.01.2019” për MD, janë përcaktuar 5 operatorë në Aparatin e Drejtësisë. Në bazë të VKM nr. 277 datë 16.05.2018 për disa ndryshime në VKM nr. 395 datë 29.04.2015 “Për miratimin e programit kombëtar të praktikave të punës në administratën shtetërore dhe institucionet e tjera publike”, të ndryshuar, në MD janë punësuar me thirrjen e IV, 17 të rinj.

Pagat e punonjësve në Ministrinë e Drejtësisë janë përcaktuar sipas funksionit dhe kategorisë referuar VKM nr. 187 datë 03.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”, VKM nr. 717 datë 23.06.2009, “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucionit dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”, të ndryshuar.

U audituan listëpagesat për periudhën Janar – Shtator 2019 si muaj të deklaruar, numri i punonjësve të paguar me kohë të plotë dhe kontratë të përkohshme, duke filluar nga emërtesa sipas strukturës, paga bazë, ditë pune, vjetërsia, shtesat e ndalesat e veçanta, llogaritja e ndalesave të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat personale, etj.

Tabela nr. 2.4 Treguesit sipas listëpagesave mujore

Në lekë

Muaji	[15] Paga Totale bruto në lekë	[16] Paga Bruto mbi të cilën llogariten kontributet e sigurimeve shoqërore	[17] Kontribute për sigurimet shoqërore të detyrueshme të punëdhënësit	[18] Kontribute për sigurimet shoqërore të detyrueshme të punëmarrësit	[21] Kontributet Suplementar e të punëmarrësit	[25] Kontribute për sigurimet shëndetësore gj[ithse]	[26] Tatimi mbi të Ardhurat nga Punësimi (TAP) gjithsej në lekë	Paga neto e llogaritur
1	10,773,563	10,406,363	1,560,960	988,608	329,349	366,299	874,124	8,398,332.5
2	10,813,138	10,431,918	1,564,796	991,040	328,176	367,703	874,965	8,435,105.5
3	10,675,351	10,400,779	1,560,129	988,083	323,457	363,125	833,067	8,349,181.5
4	11,021,547	10,723,783	1,608,580	1,018,766	339,187	374,748	893,773	8,582,447.0
5	11,020,565	10,741,582	1,610,871	1,020,420	339,721	374,757	898,329	8,574,716.5
6	10,527,459	10,261,864	1,539,290	974,884	337,962	357,950	864,959	8,170,679.0
7	10,684,096	10,390,771	1,558,626	987,132	335,954	363,277	863,524	8,315,847.5
8	11,491,124	11,186,746	1,678,027	1,062,747	337,621	390,728	914,328	8,981,064.0
9	11,575,601	11,254,336	1,688,159	1,069,170	338,381	393,588	916,630	9,054,626.0
	98,582,444	95,798,142	14,369,438	9,100,850	3,009,808	3,352,175	7,933,699	76,861,999.5

Burimi: llog. e MD në sistemin e-tax të DPT, përpunuar nga grupi i auditimit

Bazuar në të dhënat e mësipërme për periudhën Janar -Shtator 2019 rezultoi se, Fondi i Pagave Bruto sipas librit të pagave paraqitet në shumën 98,107,476.00 lekë, ndërsa pasqyrimi në listëpagesën mujore të deklaruar pranë organeve tatimore paraqitet në shumën 98,582,444.00 lekë ose 474,968,00 lekë më tepër.

Po kështu vlera e pagave neto të punonjësve për këtë periudhë sipas librit të pagave paraqitet në shumën 76,392,807.00 lekë, ndërsa pasqyrimi në listëpagesën mujore të deklaruar pranë organeve tatimore paraqitet në shumën 76,861,999.50 lekë ose 469,192.50 lekë më tepër.

Sa më sipër njësia përkatëse duhet të kryejë sitemimet përkatëse për unifikimin e këtyre vlerave.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në "MINISTRINË E DREJTËSISË"

Nga auditimi i strukturës u konstatua se muajt mars dhe gusht 2019 janë shoqëruar me shumë lirime e emërimë në organikën e MD. Në mars janë liruar 7 punonjës dhe janë emëruar 11 të tjerë. Në gusht janë emëruar 17 punonjës.

Në total për periudhën e auditimit, në MD janë përfshirë 27 punonjës me kontratë pune, sipas VKM nr. 766 datë 26.12.2018 "Për punësimin e studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të shërbimit civil, për vitin 2019", VKM nr.16 datë 16.01.2019 "Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2019, në njësitë e qeverisjes qendrore", VKM nr. 395 datë 29.04.2015 "Për miratimin e programit kombëtar të praktikave të punës në administratën shtetërore dhe institucionet e tjera publike", e ndryshuar. Efektet financiare të të cilëve janë mbuluar nga shpenzimet korrente, të miratuara në buxhetin përkatës të vitit 2019.

-Në lidhje me respektimin e dispozitave ligjore për dhënien e shpërblimeve.

Nga dhënia e shpërblimeve dhe e ndihmave në kryerjen e detyrave gjatë periudhës Janar - Tetor 2019 nga fondi i veçantë prej 600,000 lekë, i cili u konstatua në tabelën detajuese të fondit të veçantë për vitin 2019, të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Buxhetit dhe e Menaxhimit Financiar, janë përdorur 142,000 lekë ose 23.67% të totalit. Këto ndihma janë dhënë në rast fatkeqësie dhe dalje në pension, konform VKM nr. 929 datë 27.11.2010 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë", të ndryshuar.

-Pagesa për ndërpreje funksioni janë kryer në vlerën 483,894 lekë, në bazë të VKM nr. 548 datë 27.07.2016 "Për miratimin e kriterëve, rregullave dhe të procedurave për përfitimin e pensioneve shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit", i ndryshuar, pas largimit nga funksioni.

Fondi i veçantë është akorduar sipas ligjit 99/2018 "Për buxhetin e vitit 2019" dhe në zbatim të Udhëzimit Plotësues nr. 1 datë 17.01.2019 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019". Pas miratimit të kërkesës së bërë për akordim fondi, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Buxhetit dhe e Menaxhimit Financiar në MD, ka bërë transferimin e shumës të përfituesi.

- Zbatimi i vendimeve të gjykatës

Nga auditimi mbi zbatimin e vendimeve të gjykatës për punonjësit e larguar konstatohet se: Për periudhën objekt auditimi janë paguar për vendime gjyqësore të formës së prerë, për largimin nga puna 9 gjyqëfitues. Në zbatim të nenit 66/1 të Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar dhe Urdhrit nr. 5151, datë 28.10.2015 të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike "Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil", MD ka krijuar bazën e të dhënave si dhe me urdhrat e ministrit nr. 66/3, datë 17.07.2017 dhe nr. 961, datë 23.01.2018, të ndryshuar ka ngritur Komisionin e Posaçëm "Për shqyrtimin e fakteve dhe rrethanave të reja të lindura pas marrjes së vendimit gjyqësor të formës së prerë".

Ky komision me cilësinë e organit kolegjal (i ngritur me vonesë, vonesa të ardhura si pasojë e 3 emërimeve në pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm,) ka marrë në shqyrtim të gjitha faktet dhe rrethanat e lindura për ekzekutimin e vendimeve për punonjësit e larguar padrejtësisht nga puna si dhe i është drejtuar DAP për të regjistruar gjyqëfituesit në listëpritje deri në mundësinë e sistemimit të tyre. Nga 9 gjyqëfitues, 3 prej tyre:

Një gjyqëfitues nuk ka pranuar të sistemohet në MD, në një pozicion me kategorinë më të ulët të ofruar nga komisioni i posaçëm, pasi vendi i tij i punës është zënë (suprim);



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Një gjyqëfitues nuk ka pranuar pozicionet e ofruara me gjithë institimin e komisionit të posaçëm;

Ndërsa një gjyqëfituesi ka ndërruar jetë;

Pagesa e këtyre 3 gjyqëfituesve prej 4,501,553 lekë është bërë pas rakordimit të Drejtorisë së Buxhetit me Drejtorinë e Tatimeve.

Titulli i Gjetjes nr. 1:	Evidentohen diferenca midis librit të pagave dhe listëpagesave mujore
Situata:	Nga auditimi rezultoi se, për periudhën Janar -Shtator 2019 u evidentuan mospërputhje midis vlerës totale të Fondit të Pagave Bruto dhe Listëpagesave mujore. Sipas librit të pagave Fondi Bruto paraqitej në shumën 98,107,476 lekë, ndërsa pasqyrimi në listëpagesën mujore të deklaruar pranë organeve tatimore ishte paraqitur në shumën 98,582,444 lekë me një ndryshim në (+474,968 lekë). Po kështu vlera e pagave neto të punonjësve për këtë periudhë sipas librit të pagave paraqitej në shumën 76,392,807 lekë, ndërsa llogaritja e pagës neto pas ndalesave të punëmarrësit sipas listëpagesës mujore të deklaruar pranë organeve tatimore llogaritej në shumën 76,861,999 lekë, me një ndryshim në (+469,192 lekë). Diferencat e evidentuara midis dy dokumentave kanë të bëjnë me pasqyrim jo të saktë të treguesve financiarë mujorë në listëpagesën mujore të deklaruar nga ana e subjektit të audituar.
Kriteri:	Ligji nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar Ligji nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”
Ndikimi/Efekti:	Përputhshmëria dhe Rregullshmërinë në mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit mbi pagat.
Shkaku:	Mungesë mbikëqyrje nga hallkat përgjegjëse.
Rëndësia:	E mesme

✚ Drejtimi 3: “Auditimi i veprimeve financiare të institucionit”

-Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve kryer me bankën.

Nga auditimi i veprimeve të kryera përmes bankës për periudhën 01.01.2019 deri me 30.10.2019, në pagesat e kryera me urdhër shpenzime nuk u konstatuan mangësi në hartimin dhe mbajtjen e dokumentacionit justifikues për lëvrimin e tyre. Urdhër shpenzimet kishin të bashkëlidhur dokumentin justifikues si faturat, kontratat e lidhura për blerjet e shërbimet, proces verbalet dhe aktet e marrjes në dorëzim të mallrave apo shërbimeve.

-Janë kryer pagesa për shërbime me blerje të vogla, të ndara në disa kontrata me disa grup mallrash apo shërbimesh të ngjashme.

-Për periudhën objekt auditimi 2019, Ministria e Drejtësisë (MD) në cilësinë e Autoritetit Kontraktor (AK) ka kryer prokurime me procedurë “blerje me vlerë të vogël” 26, në vlerën prej 5,166,224 me TVSH dhe “sistem dinamik blerje të biletave të transportit ajror ndërkombëtar” 32, në vlerën 5.634,090 lekë konkretisht të dhënat si më poshtë:

Pasqyra nr.1



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Viti 2019 në lekë

Shpenzime	Lloji i procedurës	Procedurë	Realizuar (me TVSH)
Blerje me vlerë të vogël		26	5.166.224
Blerje nën 100,000 lekë		27	812.501
Sistem Dinamik Blerje		32	5.634,090
Kerkese për Propozim (riparim mirembajtje automjeteve)		1	1.033.800
Mini kontrata në vijim marrëveshjes kuader (leter, kancelari, tonera) nga ABP		7	2.948.698
TOTAL		93	15,595,313
Investime	Lloji i procedurës	Procedurë	Realizuar (me TVSH)
Blerje me vlerë të vogël		2	498.840
Mini kontrata në vijim marrëveshjes kuader (kompjuterë, UPS) nga AKSHI		2	802.548
Total		4	1.301.388
TOTALI		97	16.896.701

Burimi MD, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga të dhënat e tabelës vendin më të madh në zërin "shpenzime" e zënë blerjet nëpërmjet sistemit dinamik të biletave të transportit ajror ndërkombëtar. Për vitin 2019, ky zë është parashikuar në vlerën 7,000,000 lekë dhe deri në periudhën 30.10.2019 (periudha objekt i auditimit) është realizuar në vlerën 5.634.090 lekë.

Autoriteti Kontraktor bazuar në Udhëzimin e Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) nr.4, datë 09.01.2018 "Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin me mjete elektronike", pika 3, në fillim të vitit buxhetor ka ngritur Komisionin e Sistemit Dinamik (SD) për blerjen e biletave i përbërë prej 3 anëtarësh. Komisioni në zbatim të pikës 4 të udhëzimit të sipërcituar, ka bërë në çdo rast llogaritjen e fondit limit pas nxjerrjes së autorizimit për pjesëmarrje nga titullari/ministri, duke ju referuar treguesit të çmimeve në internet dhe përzgjedhur çmimin më të ulët.

Mbi bazën e fondit limit të llogaritur nga Komisioni, titullari i AK/personi i autorizuar prej tij, referuar pikës 5 të Udhëzimit ka nxjerr urdhër prokurimet përkatëse dhe procedura e prokurimit është kryer nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik (SPE).

Në 07 (shtatë) Urdhër Shpenzime të audituara, për pagesat e biletave për udhëtime jashtë vendit rezultoi si më poshtë:

Urdhër Prokurim	Fondi Limit/lekë	OE -fitues	Urdhër Shpenzimi	Situata
Nr.32, datë 01.02.2019	192,120	Odisea Travel&Tours	Nr.65,datë 26.02.2019, likujduar 182,473 lekë	1.Ftesa për pjesëmarrje në konferencën me temë "Progresi dhe Regresioni..." zhvilluar në Londër në datat 05.02-06.02.2019 është dërguar me datë 08.01.2019. 2.Autorizimi për pjesëmarrjen e 4 personave është nxjerrë datë 31.01.2019. Nuk argumentohet numri i pjesëmarrësve. 3. Procedura e prokurimit realizuar datë 01.02.2019. Procedura realizohet në një afat shumë të shkurtër nga data e udhëtimit. Pasoja-studimi i tregut në këto afate të limituara çon në riskun e përzgjedhjes së çmimit më të lartë, pasi biletat e avionit bliheshin ditën e nisjes apo ditë të afërt me nisjen.
Nr.83,datë	456,630	Odisea	Nr.97,datë	1.Ftesa për nënshkrimin e marrëveshjes

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”**

25.02.2019		Travel&Tours	19.03.2019, Likujduar 455,500 lekë	së...zhvilluar në Vienë në datat 27.02-02.03.2019 është dërguar me datë 18.02.2019 . 2.Autorizimi për pjesmarrjen e 6 personave është nxjerrë datë 21.02.2019 . Nuk argumentohet numri i pjesmarrësve. 3. Procedura e prokurimit realizuar datë 26.02.2019 . Procedura realizohet në një afat shumë të shkurtër nga data e udhëtimit. Pasoja-studimi i tregut në këto afate të limituara çon në riskun e përzgjedhjes së çmimit më të lartë, pasi biletat e avionit bliheshin ditën e nisjes apo ditë të afërt me nisjen.
Nr.238, datë 04.04.2019	529,950	Odisea Travel&Tours	Nr.183,datë 23.04.2019 Likujduar 428,880 lekë	1.Ftesa për pjesëmarrje në Berlin nuk gjendet bashkangjitur praktikës dhe as praktikës së veprimeve me arkën. 2.Autorizimi për pjesmarrjen e 5 personave në Berlin datë 7.04.-09.04.2019 është në datë 04.04.2019 .Nuk argumentohet numri i pjesmarrësve. 3. Procedura prokurimit realizuar datë 05.04.2019 . Procedura realizohet në një afat shumë të shkurtër nga data e udhëtimit. Pasoja-studimi i tregut në këto afate të limituara çon në riskun e përzgjedhjes së çmimit më të lartë, pasi biletat e avionit bliheshin ditën e nisjes apo ditë të afërt me nisjen.
Nr.337, datë 03.06.2019	160,695	AmadeusTravel&Tours	Nr.373,datë 25.6.2019 Likujduar 116,560 lekë	1.Ftesa për pjesëmarrje në konferencën “24 International Gathering” në Berlin në datë 6-8.06.2019 nuk ka datë. 2.Autorizimi për pjesmarrjen e 1 personi është nxjerrë datë 03.06.2019 . 3. Procedura prokurimit realizuar datë 03.06.2019 . Procedura realizohet në një afat shumë të shkurtër nga data e udhëtimit. Pasoja-studimi i tregut në këto afate të limituara çon në riskun e përzgjedhjes së çmimit më të lartë, pasi biletat e avionit bliheshin ditën e nisjes apo ditë të afërt me nisjen.
Nr.339, datë 10.06.2019	330,602	Odisea Travel&Tours	Nr.375,datë 25.6.2019 Likujduar 321,360 lekë	1.Ftesa për vizitë zyrtare zhvilluar në Bruksel në datë 11.06.2019 është dërguar me datë 29.05.2019 . 2.Autorizimi për pjesmarrjen e 2 personave është në datë 10.06.2019 . 3. Procedura prokurimit realizuar datë 11.06.2019 . Procedura realizohet në një afat shumë të shkurtër nga data e udhëtimit. Pasoja-studimi i tregut në këto afate të limituara çon në riskun e përzgjedhjes së çmimit më të lartë, pasi biletat e avionit bliheshin ditën e nisjes apo ditë të afërt me nisjen.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Nr.342/1, datë 14.06.2019	500,690	Odisea Travel&Tours	Nr.376,datë 25.6.2019 Likujduar 490,200 lekë	1.Ftesa për vizitë zyrtare zhvilluar në Strasburg në datë 17.06.2019 është dërguar me datë 07.06.2019. 2.Autorizimi për pjesmarrjen e 2 personave është në datë 13.06.2019. 3. Procedura prokurimit realizuar datë 14.06.2019. Procedura realizohet në një afat shumë të shkurtër nga data e udhëtimit. Pasoja-studimi i tregut në këto afate të limituara çon në riskun e përzgjedhjes së çmimit më të lartë, pasi biletat e avionit bliheshin ditën e nisjes apo ditë të afërt me nisjen.
Nr.310 datë 21.05.2019	675,212	Explorer travel&Tours	Nr.326,datë 07.6.2019 Likujduar 469,670 lekë	1.Ftesa për vizitë zyrtare zhvilluar në Otava në datë 29-31.05.2019 është datë 12.4.2019. 2.Autorizimi për pjesmarrjen e 2 personave është në datë 21.05.2019. Procedura prokurimit realizuar datë 22.05.2019. Procedura realizohet në një afat shumë të shkurtër nga data e udhëtimit. Pasoja-studimi i tregut në këto afate të limituara çon në riskun e përzgjedhjes së çmimit më të lartë, pasi biletat e avionit bliheshin ditën e nisjes apo ditë të afërt me nisjen.

Referuar konstatimit të sipërm mbi mungesën e argumentimit të numrit të pjesmarrësve në çdo takim/event në procedurat e sistemit dinamik të blerjeve për bileta të transportit ndërkombëtar, Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr.20468, datë 11.11.2019 ka sjellë në vëmendje të Ministrisë së Drejtësisë në lidhje me shpenzimet për udhëtime dhe dieta marrjen e masave të menjëhershme për kufizimin e numrit të pjesëmarrësve, pasi nga analiza e kryer nga kjo ministri mbi përdorimin e fondeve buxhetore vërehen rritje të konsiderueshme të nivelit të shpenzimeve në zërin udhëtime dhe dieta për periudhën Janar-Tetor 2019.

-Nga auditimi me zgjedhje i shpenzimeve të kryera me procedurë “blerje me vlerë të vogël” konstatohet se është ngritur Komisioni i blerjeve me vlerë të vogël në zbatim të Udhëzimit të APP nr.3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, pika 2. Për çdo rast nga titullari/personi i autorizuar prej tij ka nxjerrë urdhër prokurimin i cili shoqërohet me ftesën për ofertë që përgatitet nga Komisioni.

Procedura është kryer në SPE.

U audituan me zgjedhje praktikat e prokurimit me blerje të vogël në të cilat nuk ka asgjë për t’u theksuar si më poshtë:

1.Urdhër Shpenzimi nr.229, datë 08.05.2019, likujduar OE “S.L.M.” në vlerën 625,500 lekë për blerje materiale pastrimi. Komisioni me Procesverbalin datë 27.03.2019, ka bërë llogaritjen e fondit limit në vlerën 613,476 lekë pa tvsh.Me llogaritjen e fondit ka dalë Urdhër prokurimi nr.230, datë 01.04.2019 nga titullari i AK.

Malli është marrë në dorëzim nga Komisioni marrjes në dorëzim me procesverbalin datë 15.04.2019 i cili rezulton si nga verifikimi i treguesve sasiore ashtu dhe i treguesve cilësorë në përputje me kërkesat dhe specifikimet teknike të kërkuara.

2. Urdhër Shpenzimi nr.250, datë 16.05.2019, likujduar OE “BT SOLUTIONS” në vlerën 445,320 lekë për blerje tonera për printera. Komisioni me Procesverbalin datë 24.04.2019 ka bërë llogaritjen e fondit limit në vlerën 400,000 lekë pa tvsh.Me llogaritjen e fondit ka dalë Urdhër prokurimi nr.259, datë 25.04.2019 nga titullari i AK.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Malli është marrë në dorëzim nga Komisioni marrjes në dorëzim me procesverbalin datë 15.04.2019 i cili rezulton si nga verifikimi i treguesve sasiorë ashtu dhe i treguesve cilësorë në përputje me kërkesat dhe specifikimet teknike të kërkuara.

3.Urdhër Shpenzimi nr.250, datë 16.05.2019, likujduar OE “HYMERI KLEEMANN” në vlerën 106,500 lekë për shërbim mirambajtje ashensori. Nga AK është mbajtur procesverbali datë 18.04.2019 për konstatimin e defekteve për mirëmbajtjeën e 2 ashensorëve. Punimet janë marrë në dorëzim nga Komisioni marrjes në dorëzim me procesverbalin datë 30.04.2019.

-Inventarizimi i pasurisë së institucionit.

Ministria e Drejtësisë ka kryer inventarizimin e aktiveve, rregullisht një herë në vit, në zbatim të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kapitulli III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”. Bazuar në këtë udhëzim çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës (Kap.IV, pika 74).

Për vitin 2018 inventarizimi i aktiveve (realizuar në fillim të vitit 2019) është kryer duke u bazuar në urdhrin e Ministrit nr. 52, datë 13.02.2019 ndryshuar më urdhrin nr.52/1, datë 29.03.2019, sipas të cilit është ngritur komisioni për inventarizimin fizik të aktiveve, në zbatim të nenit 12, pika 2/b dhe nenit 15, pika 4 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, pikat 73, 74 dhe pika 81 dhe 82 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, si dhe nenit 7 (Inventari i aktiveve dhe detyrimeve), të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet.

Komisioni me procesverbalin datë 27.02.2019 ka bërë dorëzimin e fletëve të inventarit të aktiveve në zyrat e institucionit.

Inventarizimi i realizuar me datë 04.03.-14.03. 2019 filloi me mbajtjen e procesverbalit datë 04.03.2019 në të cilin ishte fiksuar numri rendor i fletë hyrjes dhe fletë daljeve të fundit në magazinë.

Komisioni i ngritur ka bërë verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në magazinë për periudhën 01.01.2018-31.12.2018.

Në përfundim të inventarizimit nuk ka rezultuar diferenca të gjendjes së tyre fizike me të dhënat e regjistruara në kontabilitet, të mallrave në magazinë dhe në përdorim.

Nga dokumentacioni i dorëzuar komisioni ka bërë verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në ngarkim/përdorim të personelit të njësisë publike dhe të firmosura nga secili nëpunës në përputhje me pikën 85/a të UMF nr. 30, datë 27.12.2011.

Komisioni ka bërë verifikimin në vend të të gjithë aktiveve në zyrat e institucion, në përdorim/ngarkim të personeli, dhe pastaj nga sasia e verifikuar në vend është bërë krahasimi me vlerat kontabël të regjistruar në librat e magazinës me fletë hyrjet dhe fletë dalje, ku nuk është konstatuar diferenca.

Nga komisioni i inventarizimit në relacionin drejtuar titullarit është bërë një përmbledhje totale të aktiveve që ka institucioni në dispozicion, me listë të bashkëngjitur, të ndara në pajisje elektronike, pajisje zyre, Instalime teknike,makineri, paisje,vegla pune, mjete transporti etj, si dhe krahasimit të gjendjes konkrete të tyre me të dhënat përkatëse të librave të sektorit të financës e buxhetit, ku nuk ka rezultuar diferenca.

Komisioni i inventarizimit ka sugjeruar listën e materialeve që ndodhen në gjendjen stok të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në "MINISTRINË E DREJTËSISË"

cilat për shkak të kohës shumë të gjatë të qëndrimit në magazinë nga momenti i blerjes janë bërë të papaërdorshme. Komisioni propozon që këto materiale duhet të bëhen dalje nga magazina dhe të asgjësohen. Gjithashtu në inventarin e magazinës, figurojnë dhe aktivet e blera gjatë viteve 2017-2018 për institucionin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për të cilat është i pamundur inventarizimi për shkak se janë në përdorim nga ky institucion që nga data e hyrjes pa u zbatuar procedurat e parashikuara në Udhëzimin nr.30/2011 për kalim kapital pa pagesë për dorëzimin e tyre dhe dalje nga magazina e MD. Në këto kushte Komisioni merr në konsideratë gjendjen e aktiveve sipas kontabilitetit.

Në inventarin e magazinës figurojnë dhe aktivet e propozuara për nxjerrje jashtë përdorimit nga Komisioni i inventarizimit të magazinës për vitin 2017, proces i cili ka përfunduar dhe Komisioni në Relacionin e tij përgatitur për miratim tek Ministri (në proces) ka arritur në konkluzionin se:

"-Aktivet e listuara në numrin rendor 1-14, 37-40, 45, 59-70 (të relacionit) nxjerrjen jashtë përdorimit nëpërmjet shitjes si material mbeturine.

-Aktivet e listuara në numrin rendor 15-36, 41-43, 49-58, nxjerrjen jashtë përdorimit nëpërmjet shitjes në gjëndjen që janë.

-Aktivet e listuara në numrin rendor 44, 46-48 nxjerrjen jashtë përdorimit nëpërmjet asgjesimit përfundimtar.

-Aktivi i listuar në numrin rendor 71 nxjerrjen jashtë përdorimit duke e kaluar pa pagesë në ndonjë institucion tjetër të varësisë".

MD ka kryer dhe inventarizimin e aktiveve gjendje të automjeteve dhe të Bibliotekës nga ku Komisioni me relacionin datë 01.01.2019 ka filluar punën me marrjen në dorëzim nga Nëpunësi Zbatues të fletëve të inventarit të Bibliotekës dhe të automjeteve me procesverbalin datë 27.02.2019. Në përfundim Komisioni ka sugjeruar nxjerrjen jashtë përdorimit të dy automjeteve që gjenden tek Rezervat e shtetit në Lundër tip BENZ 200 me targë TR 2263 G dhe tip Volkswagen Vento me targë TR 7801 A si dhe marrjen e masave për ngritjen e Bibliotekës së MD, krijimin e një ambienti të përshtatshëm për funksionimin e saj.

Titulli i Gjetjes nr. 1:	Mbi çmimet e biletave të paguara nga institucioni për udhëtime jashtë vendit
Situata:	<p>Nga auditimi rezultoi se, pjesën më të madhe në zërin "shpenzime" e zënë blerjet nëpërmjet sistemit dinamik të biletave të transportit ajror ndërkombëtar. Për vitin 2019, ky zë është parashikuar në vlerën 7,000,000 lekë dhe deri në periudhën 30.10.2019 (periudha objekt i auditimit) është realizuar në vlerën 5.634.090 lekë.</p> <p>Në 07 procedura të audituara me një vlerë shërbimi të paguar që shkon 2,464,643 lekë, dokumentacioni bashkëlidhur praktikës nuk arrin të argumentoj numrin e nevojshëm për pjesëmarrje në këto takime/evente.</p> <p>Në të gjitha rastet procedura realizohet në një afat shumë të shkurtër nga data e udhëtimit, duke sjellë si pasojë mungesë të studimit të tregut rrjedhojë e afate të limituara, rrit riskun e përzgjedhjes së çmimit më të lartë, pasi biletat e avionit bliheshin ditën e nisjes apo ditë të afërt me nisjen, kur edhe çmimet kapin nivelet e tyre të larta.</p> <p>Mbi mungesën e argumentimit të numrit të pjesëmarrësve në procedurat e sistemit dinamik të blerjeve për bileta të transportit ndërkombëtar, Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 20468 prot, datë 11.11.2019, ka sjellë gjithashtu në vëmendje të Ministrisë së Drejtësisë shpenzimet për udhëtime dhe dieta, si dhe marrjen e masave të menjëhershme për kufizimin e numrit të pjesëmarrësve, pasi nga analiza e kryer nga kjo ministri mbi përdorimin e fondeve buxhetore vërehen rritje të konsiderueshme të nivelit të shpenzimeve në zërin udhëtime dhe dieta për periudhën Janar-Tetor 2019. Lidhur sa më sipër, evidenton nevojën për një qasje</p>



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

	më të kujdesshme nga ana e hallkave përkatëse për përdorimin me ekonomicitet të fondeve shtetërore në këtë drejtim.
Kriteri:	Ligji nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm” neni 8, pika 1, neni 9, pika 1 dhe neni 12, pika 3, germa a, Ligji nr.99, datë 03.12.2018 “Për Buxhetin e vitit 2019”, Udhëzimi Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë” nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Kap.I, pika 1, 40 dhe 48, germa a.
Ndikimi/Efekti:	Risku i përzgjedhjes së çmimit më të lartë në rastet kur bileta blihet në data të afërta me datën e nisjes së udhëtimit.
Shkaku:	Nxjerrja me vonesë e autorizimit për pjesmarrjen në këto evente nga momenti i ardhjes së ftesës nga organizatorët
Rëndësia:	E lartë

✦ Drejtimi 4: “Prokurimet e fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime”

Në bazë të auditimit pranë intucionit të Ministrisë së Drejtësisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, për periudhën 01.01.2019 deri në 30.10.2019, janë prokuruar 3 (tre) procedura me vlerë të fondit limit prej 43,156,082 lekë pa tvsh, me burim financimi nga të ardhurat e Buxhetit të Shtetit (të cilat u audituan nga grupi i audituesve) dhe 1(një) procedurë me objekt ” Rehabilitimi emergjent i arkives dhe rrjeti kompjuterik i zyrës së arkiv-protokollit të Ministrisë së Drejtësisë”. Për sa më sipër, ju bëj me dije se;

1). Ministria e Drejtësisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, ka realizuar procedurën me objekt ” Rehabilitimi emergjent i arkives dhe rrjeti kompjuterik i zyrës së arkiv-protokollit të Ministrisë së Drejtësisë”, e cila është zhvilluar e klasifikuar në nivelin “Sekret” me fond limit në vlerën prej 60,208,742 lekë pa tvsh, aktualisht ndodhet në fazën e zbatimit të kontratës nga kontraktuesi. Kjo procedurë nuk është audituar nga grupi i audituesve të KLSH-së, për shkak se grupi i auditimit nuk ka Certifikatë Sigurie të Nivelit të Klasifikuar (DSIK).

Titullari i Ministrisë së Drejtësisë, në zbatimin e bazës ligjore, ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror” i ndryshuar, VKM nr. 701, datë 22.10.2014 “Për miratimin e rregullave “Për sigurimin e informacionit të klasifikuar në fushën industriale”, VKM-së nr. 188, datë 04.03.2015 “Për miratimin e rregullave për sigurimin e personeli”, VKM nr.189 datë 04.03.2015 “Për sigurimin fizik të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, të NATO-s, BE-së, Shteteve dhe Organizatave të tjera Ndërkombëtare”, VKM nr. 312, datë 16.3.2011 “Për miratimin e rregullores “për punën me informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr. 7092/5, datë 22.11.2017 “Për ndarjen e zonave të sigurisë në Ministrinë e Drejtësisë dhe strukturat në varësi dhe godinat në administrim të saj”, Urdhrit të Ministrit nr. 7092/4, datë 22.11.2017 “Për listën e dokumenteve të klasifikuara “Sekret Shtetëror” në Ministrinë e Drejtësisë, në përputhje me bazën ligjore dhe nënligjore, ka miratuar procedurën e klasifikuar “sekret”.

Kështu, kjo procedurë në bazë të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 4 (fusha e zbatimit) ku shprehet se “Ky ligj zbatohet për të gjitha procedurat e prokurimit publik, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenet 5, 6, 7, 8 e 9 të këtij ligji” si dhe neni 6 (Kontrata sekrete, kontratat që kërkojnë masa të veçanta sigurie dhe kontratat që diktohen nga interesa thelbësore të shtetit) ku shprehet, “Ky ligj nuk zbatohet në përzgjedhjen e fituesve të kontratave publike, në rast se zbatimi i tyre kërkon masa të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në "MINISTRINË E DREJTËSISË"

veçanta sigurie, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, në fuqi, ose në rast se një gjë e tillë diktohet nga interesat thelbësorë të shtetit.", është i përjashtuar dhe për tu publikuar në sistemin e app.gov.al (SPE).

2). Shërbim projektim me vlerë 1,116,465 lekë pa tvsh, realizuar në bashkëpunim me Universitetin Politeknik të Tiranës në mbështetje të VKM-së nr.188, datë 13.03.2019 "Për ofrimin nga institucionet publike të Arsimit të Lartë të shërbimeve, në përputhje me veprimtarinë e tyre, për Institucionet e Qeverisjes Qendrore dhe institucionet në varësi të tyre".

Nga ky shërbim, është ofruar realizimi i preventivit të projekt-zbatimit dhe vlerën e përllogaritur të kontratës, për objektin e rikonstruksionit të Arkivës Shtetërore të Sistemit Gjyqësor, me vendndodhje Lundër/Tiranë.

Nga auditimi, u konstatua se, me Urdhër nr.4304/1 prot datë 28.05.2019 për ngritje Grupi I Punës "Për përgatitjen e detyrës së projektimit për projektin me objekt "Rikonstruksion I Arkivës Shtetërore të Sistemit Gjyqësor, Lundër Tiranë" si dhe mbështetur në shkresat nr.321 datë 03.08.2018.

Ky investim, do të kryhet në mesin aktual me nr.pasurie 867/18, me emertim "Depo nr.5" Lundër- Tiranë me sipërfaqe të përgjithshme 960 m² ka kaluar në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Brendshme tek Ministria e Drejtësisë, nëpërmjet VKM-së nr.37 datë 16.01.2013, për sistemin e arkivave të gjykatave shqiptare. Në Memon e datës 29.05.2019 me shkresë nr.4304/2 prot , grupi i punës ka dhënë informacion të detajuar mbi Detyrën e Projektimit për projektin me objekt "Rikonstruksion i Arkivës Shtetërore të Sistemit Gjyqësor". Gjithashtu, grupi i punës ka sugjeruar që ky shërbim të realizohet me UPT, duke e vlerësuar nga sektori i prokurimeve mbi procedurën e realizimit të shërbimit.

Kështu, me Memo nr.4304/3 prot datë 29.05.2019, nga sektori i prokurimeve publike, është argumentuar se:

"Në VKM nr.188, datë 13.03.2019 "Për ofrimin nga institucionet publike të arsimit të lartë të shërbimeve, në përputhje me veprimtarinë e tyre, për institucionet e qeverisjes qendrore dhe institucionet në varësi të tyre" dhe konkretisht në pikën 1, përcaktohet "Kryeministria, ministritë e linjës, institucionet e qeverisjes qendrore apo institucionet në varësinë e tyre të kërkojnë fillimisht, sipas nevojave, shërbimeve me fonde buxhetore, si konsulenca, studime apo ekspertiza nga institucionet publike të arsimit të lartë, sipas fushave të veprimit."

Në këtë kontekst, hartimi i projektzbatimit (*specifikime teknike, projekte/planimetri, grafik punimesh, preventive me çmime e zëra punimesh, etj*) nga ish-titullari zj. Katrin Treska me detyrë Sekretar i Përgjithshëm, ka miratuar që, në zbatim të VKM nr.188, datë 13.03.2019, ky shërbim të realizohej në bashkëpunim me UPT , duke e finalizuar hartimin dhe miratimin e Kontratë Shërbimi nr.4728/1 prot, datë 14.06.2019 "Hartimi i projektzbatimit për rikonstruksionin e godinës së Arkivës gjyqësore, Lundër".

Në përfundim, me urdhër nr.4728/4 prot datë 17.07.2019 "Për ngritjen e grupit për marrjen në dorëzimin të Projekt-zbatimit me objekt "Rikonstruksioni i godinës së arkivës shtetërore së sistemit të gjyqësorit Lundër" në vijim të kontratës së shërbimit nr.4728/1 prot datë 14.06.2019 si dhe Urdhër-shpenzimi nr.602 datë 23.09.2019 në vlerën prej 1,339,758 lekë me tvsh.

procedura dhe shërbimi janë në përputhshmëri me aktet ligjore dhe nënligjore të aplikuara.

3). Procedurë e hapur me objekt "Rikonstruksioni i Arkivës Shtetërore të Sistemit Gjyqësor" me fond limit total, i shtrirë në 2 (dy) vite financim në vlerën prej 40,934,000 lekë pa tvsh, nga ku:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Vlera e financimit për vitin 2019 prej 33,684,000 lekë pa tvsh dhe

Vlera e financimit për vitin 2020 prej 7,250,000 lekë pa tvsh

Nga auditimi u konstatua se, njësia e prokurimit në bazë të Urdhër Prokurimi nr.428 (nr.6276/1 prot, datë 10.09.2019, referuar neneve 45 e 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 26 (kontrata për punë publike), ka hartuar dhe më pas janë miratuar nga titullari i AK, të cilat janë publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike në APP.

Vendosja e kërkesave kualifikuese është bërë në përputhje me bazën ligjore dhe nënligjore.

Të dhënat e përgjithshme të tenderit:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Rikonstruksion i Arkives Shtetore te Sistemit Gjyqesor		
1. Urdhër Prokurimi nr. 6276/1 prot, datë 10.09.2019	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: sipas Urdherit te Prokurimit nr. 6276/1 prot, datë 10.09.2019 1. Fatbardh Vrioni 2. Marsuela Aliaj 3. Gojart Laci (Ing. Ndertimi) Hartuesi i fondit limit, Sipas projekt-preventivit	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhëri nr. 6276/2 prot, date 10.09.2019, i ndryshuar, 1. Blerina Semanjaku Kryetar 2. Nezir Hoxha Anetar 3. Entela Muha Anetar
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedure e Hapur”		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 40,934,000 leke pa tvsh	6. Oferta fituese (pa tvsh)	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)
8. Data e hapjes së tenderit Date 16.10.2019, ora 10:00.	9. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike (40 OE) a) b)
11. Ankimime ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK	13. Përgjigje Ankesës nga KKP
b. Zbatimi i Kontratës		
14. Lidhja e kontratës	15. Vlera e kontratës (me tvsh)	
16. Mbik i punimeve me kontratë nr.	17. Urdher-shpenzime	
18. Situacioni Përfundimtar/Faturë Malli;	19. Afati i kontratës në dite 4 muaj	

Kjo procedurë, është në process vlerësimi nga KVO për shpalljen e operatorit ekonomik fitues.

4). Procedura kërkesë me propozim me objekt “Riparim dhe mirëmbajtje automjetesh për vitin 2019” me fond limit 1,077,082 lekë pa tvsh, është konstatuar se përlllogaritja e vlerës së fondit limit, nga grupi i punës i ngritur me urdhër nr.35 datë 01.02.2019 të titullarit të AK, është realizuar në përputhje me vlerën kontabël dhe norma e amortizimit të cdo mjete motorik sipas ligjit nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, udhëzimin nr. 30 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” si dhe është bazuar në evidenca për çdo mjet (letër shërbimesh), totali i kilometra të përshkruara përgjatë viteve të mëparshme, duke identifikuar saktë nevojën për riparime dhe shërbim të mjeteve motorike, sipas përcaktimeve të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 59 (përlllogaritja e fondit limit).



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në "MINISTRINË E DREJTËSISË"

Gjithashtu, hartimi i specifikimeve teknike, vlerësimi, shpallja e OE fitues si dhe ekzekutimi i dertanishëm i kontratës nr.3849 prot datë 07.05.2019, vlerësohet në përputhshmëri me bazën ligjore dhe nënligjore të prokurimeve publike.

Të dhënat e përgjithshme të tenderit:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Riparim dhe mirëmbajtje automjesh		
1. Urdhër Prokurimi nr. 982/2 prot, datë 11.03.2019	3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit: sipas Urdherit te Prokurimit nr. 982/2 prot, datë 11.03.2019 4. Fatbardh Vrioni 5. Ornela Bleta 6. Nezir Hoxha (Ing. Mekanik)	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër. nr. 982/3 prot, date 11.03.2019 1. Edvin Morava Kryetar 2. Marsuela Aliaj Anetar 3. Arjan Koçiaj Anetar
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit "Kërkesë për Propozim"	Hartuesi i fondit limit, Urdheri nr. 982 prot, datë 01.02.2019 1. Fatbardh Vrioni 2. Gojart Iaci 3. Nezir Hoxha (Ing. Mekanik)	
5.Fondi Limit (pa tvsh) 1,077,082 leke pa TVSH	6. Oferta fituese (pa tvsh) 861,500 leke pa TVSH	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 215.582 lekë pa TVSH
8. Data e hapjes së tenderit Date 02.04.2019, ora 10:00.	9.Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike (2 OE) a) "Auto Manoku Servis" sh.p.k. Kualifikuar b) "Kadit" sh.a. Skualifikuar
11. Ankimime Nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK	13. Përgjigje Ankesës nga KKP
b. Zbatimi i Kontratës Mallrave		
14. Lidhja e kontratës Nr. 3849 prot, date 07.05.2019	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 1,033,800 leke me tvsh	
16.Mbiki kontratë nr.	17.Urdher-shpenzime	
18- Situacioni Përfundimtar/Faturë Malli;	19. Afati i kontratës në dite Deri me 31.12.2019	

Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se, përzgjedhja e operatorit ekonomik fitues Auto Manoku Servis shpk, me vlerë kontrate prej 1,033,800 lekë me tvsh, është realizuar në përputhshmëri me bazën ligjore të përcaktimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

➤ Drejtimi 5: "Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe veprimtarisë së strukturës së auditimit të brendshëm"

-Planifikimi dhe miratimi i programeve strategjike dhe vjetore të auditimeve, realizimi i programit vjetor të auditimit, si dhe ndjekja e zbatimit të masave të rekomanduara.

Në zbatim të programit të auditimit, dhe drejtimit të mësipërm u auditua përputhshmëria e veprimtarisë së subjektit me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi dhe verikimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara janë në përputhje me bazën e parimeve të profesionalizmit, të efikasitetit, të përgjegjësisë dhe korrektësisë në zbatimin e legjislacionit në fuqi, në bazë të të cilit ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm

Për veprimtarinë e kësaj drejtorie për periudhën nën auditim Janar-Tetor 2019, grupit i auditimit trajtoi dokumentacionin e paraqitur nga kjo drejtori dhe përkatësisht:

- Struktura dhe organika miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 238 datë 31.12.2017.
- Plani strategjik 2018-2020 për auditimin e brendshëm.
- Plani vjetor 2019 si dhe ai strategjik 2019-2021.
- Programet e auditimeve të zhvilluara gjatë periudhës nën auditim.
- Të tjera lidhur me këtë drejtim auditimi.

Baza ligjore mbi të cilën bazohet veprimtaria administrative.

- Ligji Nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”
- VKM nr. 83 datë 03.02.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të njësisë të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar.
- VKM nr.160, datë 02.03.2016 “Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e komitetit të auditimit të brendshëm në njësitë publike.
- Manuali i Auditimit të Brendshëm në sektorin publik miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100 datë 25.10.2016.
- Të tjera akte ligjore, nënligjore e rregullative.

Njësia e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Drejtësisë referuar strukturës organizative të miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 238 datë 13.12.2017 është e organizuar në nivel drejtorie dhe ka të parashikuar një staf prej pesë punonjësish (1+4), Drejtorin dhe 4 specialistë. Prej muajit Dhjetor 2017 pozicioni i drejtuesit të kësaj njësie rezulton vakant duke krijuar një boshllëk në drejtimin e saj. Me Urdhrin nr. 2969 datë 12.03.2018 të Ministrit të Drejtësisë, një specialist i kësaj drejtorie është caktuar për kryerjen e detyrave të Drejtorit në DAB deri në emërimin e drejtuesit të përhershëm. Drejtuesi i komanduar e ka ushtruar funksionin edhe gjatë vitit 2019 deri në marrjen e masës së pezullimit ndaj tij.

Aktualisht kjo drejtori funksionon vetëm me dy auditues nga të cilët një auditues i emëruar në këtë funksion më datë 23.08.2019, ende në periudhë prove.

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Drejtësisë si objekt auditimi ka rreth 35 institucione. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, përfshihet si objekt auditimi por duke qënë se kjo drejtori ka njësi auditimi të vetën, njësitë në varësi të saj nuk janë evdientuar si objekt auditimi por pavarësisht kësaj ato mbeten objekt auditimi i DAB së Ministrisë së Drejtësisë si njësi varësie.

Sipas të dhënave të subjektit të audituar rezultoi se, DAB ka hartuar planin vjetor të auditimit për vitin 2019 dërguar Drejtorisë së Harmonizimit Financiar me shkresën nr. 9411/1 prot, datë 19.10.2018 në të cilin parashikohet të realizohen 12 auditime nga 17 të tillë të parashikuar në planin strategjik 2018-2020, dërguar Drejtorisë së Harmonizimit Financiar me shkresën nr.438 prot, datë 23.03.2018, pra me 5 (pesë) auditime më pak.

Për periudhën nën auditim Janar-Tetor 2019 janë zhvilluar 7 (shtatë) angazhime auditimi nga të cilat, 3 (tre auditime) janë auditime të paplanifikuara në planin vjetor dhe vetëm 4 (katër) janë pjesë e planit. Nga angazhimet e zhvilluara gjithsej, në 3 (tre) auditime ka përfunduar angazhimi, në 2 (dy) auditime është hartuar raporti paraprak dhe në 2 (dy) raste auditimi ndodhet në proces, Tabela 5.1 më poshtë:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Tabela nr.5.1 Pasqyra planifikim viti 2019-realizim për 10 mujorin

Nr.	Subjekti i planifikuar për Auditim (Plani strategjik 2018-2020)	Niveli i vlerësimit të riskut	Realizuar	Janar-Tetor 2020	Komente
1	Aparati i Ministrisë së Drejtësisë	I lartë	Aparati i Ministrisë së Drejtësisë		
2	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës	I lartë	Drejtoria e Përgjithshme e Burjeve –Investimet 2018		<i>jashtë planit</i>
3	Komisioni Shtetëror i Ndihmës Juridike	I lartë	Komisioni Shtetëror i Ndihmës Juridike		
4	Instituti i Mjekësisë Ligjore	I lartë	Instituti i Mjekësisë Ligjore		
5	Zyra e Përmbartimit Vlorë	I lartë	Instituti i Mjekësisë Ligjore (prokurimet 2015)		<i>jashtë planit</i>
6	Zyra e Përmbartimit Shkodër	I lartë	Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit		<i>jashtë planit</i>
7	Zyra e Përmbartimit Durrës	I lartë			
8	Zyra e Përmbartimit Korçë	I lartë	Zyra e Përmbartimit Korçë		
9	Zyra e Përmbartimit Fier	I lartë			
10	Zyra e Përmbartimit Berat	I lartë			
11	Zyra e Përmbartimit Lushnjë	I lartë			
12	Fondet IPA	I lartë			

Plani vjetor 2020 dhe ai strategjik për vitet 2019-2022 ka marrë aprovimin nga Komiteti i Auditimit të Brendshëm me Vendimin nr. 2 datë 10.10.2019 dhe është miratuar nga Ministri i Drejtësisë me Urdhrin nr. 468 datë 11.10.2019. Ky plan është përcjellë drejt Ministrisë së Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit me shkresën nr.6668/1 prot. datë 17.10.2019, pra brenda afeteve të parashikuara.

Në materialet e disponuara deri në këtë fazë të auditimit nuk disponohen materiale shpjeguese lidhur me devijimet në planin vjetor dhe shtimin e tre auditimeve të reja. Po kështu që ndryshimet e planit nuk rezulton të jenë miratuar prej Komitetit të Auditimit të Brendshëm referuar VKM nr.114 datë , Kreu III. Pika 1/b ku përcaktohet se,

*1.Komiteti i auditimit të Brendshëm e ushtron veprimtarinë brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore të njësisë publike ku ngrihet dhe mbulon veprimtarinë e auditimit të brendshëm, duke përfshirë dhe njësitë e varësisë, dhe ka për kompetencë për:
b) shqyrtimin dhe dhënien e rekomandimeve për planin strategjik e vjetor të auditimit të brendshëm dhe të gjitha ndryshimet e planit gjatë vitit.*

Në planin vjetor të auditimeve për vitin 2020 i nisur me shkresën e cituar më sipër nuk rezultojnë të jenë përfshirë auditimet të cilat nuk mund të realizohen gjatë vitit 2019 të cilat aktualisht janë 8 (tetë) të tillë. Nga të gjitha hallkat përgjegjëse, për hartimin, monitorimin si dhe miratimin e planit vjetor mungojnë spjegimet lidhur me spostimin/anashkalimin e subjekteve të parashikuara për auditim gjatë vitit 2019 por të porealizueshëm në kushtet aktuale. Mospërfshirja e tyre në planin e ardhshëm si auditime të porealizuara, shkëput vijueshmërinë dhe ul besueshmërinë për hartimin e një plani bazuar në një vlerësim objektiv të riskut për vitin në vijim.

Për periudhën nën auditim Janar-Tetor 2019, nëse do të shohim veprimtarinë audituese në harkun kohor do të shohim se ajo zë vetëm një pjesë të shkurtër kohore përgjatë periudhës dhe mbulimi me auditim nuk ka qenë i plotë duke sjellë mosezaurim të planit vjetor të parashikuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Përputhshmërie” për periudhën 01.01.2018-31.07.2019 dhe afat auditimi 27.08.2019-29.03.2019 pra 3 ditë kalendarike me drejtim auditimi “Shpenzime jashtë vendit, udhëtim dhe djeta”.

7. Në programin e angazhimit nr.7155/1 prot. datë 21.10.2019, në subjektin **Instituti i Mjekësisë Ligjore** me lloj auditimi auditim i kombinuar “I sigurisë, përputhshmërisë, financiar dhe performancës” periudhë auditimi (ska) dhe afat auditimi 21.10.2019-25.10.2019 pra 5 ditë kalendarike. Drejtimet e auditimit përfshin sistemin e prokurimeve.

Tabela nr.5.2 Pasqyra e auditimeve të realizuara për 10 mujorin 2019

Nr.	Subjekti i Audituar	Periudha e Audituar	Afati i Auditimit	Lloji i Auditimit	Grupi i Auditimit	shenime
1	Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit	1.1.2018-31.12.2018	22.2.2019-15.3.2019	Auditim i Shërbimit të Sigurisë	Arjan Drita & Gentjan Thoma	Perfunduar (pritet plan veprimi)
2	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve -Investimet 2018	1.12.2015-30.4.2019	18.3.2019-22.3.2019	Auditim i kombinuar (tematik)	Arjan Drita & Gentjan Thoma	Perfunduar
3	Komisioni Shtetëror i Ndihmës Juridike	1.12.2015-30.4.2019	9.5.2019-17.5.2019	Auditim i Shërbimit të Sigurisë	Arjan Drita & Gentjan Thoma	Ne proces (ka kaluar Raporti paraprak)
4	Zyra e Përmbarimit Korçë	1.6.2017-30.6.2019	4.8.2019-16.8.2019	Auditim i kombinuar	Arjan Drita & Gentjan Thoma	Ne proces
5	Aparati i Ministrisë së Drejtësisë	1.1.2018-31.7.2019	27.8.2019-29.8.2019	Auditim i qëllimit	Arjan Drita & Gentjan Thoma	Perfunduar
6	Instituti i Mjekësisë Ligjore	Prokurimi i vitit 2015	21.10.2019-26.10.2019	Auditim tematik	Gentjan Thoma & Adriana Kalemaj	Proces (ka kaluar raporti parapra)
7	Instituti i Mjekësisë Ligjore	01.01.2017 - 30.06.2019	17.06.2019- 12.07.2019	Auditim i Shërbimit të Sigurisë	Arjan Drita & Gentjan Thoma	proces

Lidhur sa më sipër konstatohet se, njësia publike thuhet se në të gjitha rastet nuk është njoftuar 10 ditë përpara si dhe në dosje nuk gjendet argumentim lidhur me këtë mungesë si përcaktohet në pikën 4.1.4 të Manualit të Auditimit të Brendshëm/2016 ku citohet se,

4.1.4 Drejtuesi i NJAB si rregull, duhet të njoftojë njësinë publike 10 ditë pune përpara takimit fillestar për përfshirjen në bashkëpunim dhe komunikim të plotë midis njësisë dhe grupit të auditimit,

Në çdo rast të auditimit pa njoftim paraprak, Drejtuesi i NJAB është i detyruar të përfshijë në dosjen e auditimit argumentimin për mos kryerjen e njoftimit.

Evidentohet se, në planin e auditimit për vitin 2019 por dhe planet strategjikë 2018-2020 dhe 2019-2021 nuk parashikohen auditime tematikë për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna drejt subjekteve të audituar. Zbatimi rekomandimeve të lëna është përfshirë si nën pikë në drejtimet e auditimit në rastet e auditimeve të plota ndërsa në auditimet tematikë kjo pikë nuk rezulton e përfshirë. Nisur nga ritmet e auditimit dhe numri i subjekteve objekt auditimi nga kjo strukturë, bën që zbatimi i rekomandimeve nga subjekti i audituar të rishikohet pas periudhave të zgjatura të cilat mund të shkojnë deri në disa vite. Mungesa e veprimeve aktive për zbatimin e rekomandimeve në një kohë të shpejtë nuk i lejon manaxhimit të lartë mundësi, të informohet mbi masat e marra nga subjekti i audituar çka mund të ndikojë në ngadalësimin e zbatimit apo moszbatim të tyre. Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve trajtohet në pikën 4.1.13 të Manualit për AB/2016 ku përcaktohet se,



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

4.1.13 ...Audituesit e brendshëm vlerësojnë përshtatshmërinë, efektivitetin dhe afatet e veprimeve të ndërmarra nga menaxhimi për adresimin e çdo rekomandimi të auditimit. Kjo njihet si “ndjekja e procedurave” dhe mund të bëhet pjesë e angazhimit të auditimit për vitin që vjen, kur një gjë e tillë është përfshirë në planin strategjik të auditimit të brendshëm, ose si një angazhim i veçantë, nëse nuk është planifikuar ndonjë angazhim auditimi në atë sistem.

4.1.13.2 Kur nuk është planifikuar angazhim auditimi në vitin në vazhdim, audituesit duhet t'i mundësojnë një raport të shkurtër titullarit të njësisë, për progresin e bërë në zbatimin e rekomandimeve të rena dakord më parë.

Në këto raste rishikimi i zbatimit të rekomandimeve mund të realizohet në auditimin e radhës të subjektin publik si pikë e veçantë e programit të auditimit.

-Në programet e auditimit përfshihet si drejtim i veçantë auditimi dhe Teknologjia e Informacionit, megjithëse specialistët në grupet e auditimit nuk janë të diplomuar apo të kenë formim profesional të nevojshëm për këtë fushë auditimi referuar pikës 2.4.4 të Manualit të Auditimit/2016 ku përcaktohet se,

2.4.4 Auditimi i Teknologjisë së Informacionit (TI) ... përfshin vlerësimin e kontrolleve të vendosura nga menaxhimi me ndihmën e infrastrukturës së TI-së në lidhje me ruajtjen e aseteve, integritetin e të dhënave dhe funksionimin efektiv, për të arritur qëllimet dhe objektivat e njësisë publike.

Për shkak të natyrës së kësaj fushe audituesi i brendshëm duhet të ketë njohuri specifike të teknologjisë së informacionit dhe të gëzojë ekspertizën e nevojshme në kryerjen e këtij lloji auditimi. Auditimi i TI, ndjek të njëjtat parime si çdo angazhim tjetër auditimi.

Auditimi për këtë fushë mjaftohet me verifikime sipërfaqësore dhe nuk jep sigurim mbi sistemet. Sa më sipër, konkluzioni i nxjerr nga auditimi për këto fusha nuk jep siguri objektive dhe nuk e ndihmon menaxhimin në arritjen e qëllimeve dhe objektivave të tyre, për përmirësimin e sistemeve të kontrollit dhe përdorimit me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve publike.

✓ *Vlen të theksohet se, stafi i paplotësuar gjatë periudhës nën auditim, tkurrja e numrit të auditimeve gjithsej, përzgjedhja tematike, shpërndarja disproporcionale sipas periudhave, të programeve të auditimit, si dhe afatet e shkurtra për përmbushjen e tyre, nuk krijojnë siguri të arsyeshme për përmbushjen e plotë dhe me cilësisë të objektivit të kësaj strukture për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë e sektorit publik.*

Ndër angazhimet e mbyllura dhe ato në proces të kryera nga DAB në Ministrinë e Drejtësisë është edhe Drejtorja e Përmbartimit Tiranë, evaduar gjatë vitit 2019. Ky angazhim është realizuar në zbatim të programit të auditimit nr.10613/1 prot, datë 19.10.2018, me lloj auditimi auditim i kombinuar “Financiar, përputhshmërie, performance, teknologjisë së informacionit” për periudhën 01.10.2016-31.10.2018 dhe afat auditimi 29.10.2018-30.11.2018 pra 33 ditë kalendarike. Drejtimet e auditimit përfshin fushëveprimin e subjektit të audituar. Projekt Raporti është dërguar në subjektin e audituar me shkresën nr. 5202 prot dt 08.07.2019. Nuk ka patur observacion lidhur me materialin e përcjellë dhe Raporti Përfundimtar i Auditimit për këtë institucion varësie është përcjellë me shkresën nr.5202/1 prot. datë 30.09.2019.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Megjithëse auditimi në këtë institucion është realizuar gjatë vitit 2018, Raporti Përfundimtar i Auditimit mban datën 30.09.2019. Pra ka vonesa të tejzgjatura dhe të paargumentuara në evadimin e materialeve. Në këtë angazhim janë caktuar tre auditues nga të cilët një auditues është larguar nga detyra më datë 12.03.2019 i cili nuk rezulton të ketë firmosur materialin së bashku me një nga anëtarët e tjerë të grupit. Po kështu në dosjen e auditimit nuk ndodhet ndarja e detyrave e cila e bën të paqartë situatën. Materiali është përcjellë prej titullarit të institucionit i firmosur vetëm nga një auditues nga tre gjithsej.

- ✓ Në gjetjet e trajtuara në këtë auditim e përdorur nga ana jonë referuar nenit 16 të ligjit organik të KLSH nr. 105/2014 dhe Standarteve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 1610 “Përdorimi i punës së një audituesi të brendshëm”, në Drejtorinë e Përmbarrimit Tiranë janë evidentuar të ardhura të realizuara të pa derdhura ne buxhetin e shtetit për vitin 2017 dhe 10/mujorin e vitit 2018 në shumën **45,431,414 lekë** si dhe mungesë e detajimit të zërit “Të tjera” në “**Llogarinë Përmbarrimore**”, në shumën 32,511,553lekë.

Nga auditimi në këtë Drejtori ka rezultuar se, të ardhurat e krijuara për vitin 2017 dhe 10/mujorin e vitit 2018 e cila përbëhet nga gjoba gjyqësore, të ardhura nga interesi, tarifë ekzekutimi në shumën 45,431,414.37 lekë, nuk janë administruar konform Ligjit nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare“, nenit 6 “Transferimi i të ardhurave nga taksat kombëtare në Buxhetin e Shtetit“, për arsye se këto të ardhura të krijuara në vite nuk janë derdhur brenda 30 ditëve nga momenti i krijimit të tyre në Buxhetin e Shtetit. Këto të ardhura prej vitesh rezultojnë të jenë derdhur në Buxhetin e Shtetit, duke i lënë këto të holla në llogarinë përmbarrimore pranë bankave të niveleve të dyta, megjithëse kuadri ligjor ka qenë i plotë për transferimin e tyre në Buxhetin e Shtetit. Po kështu zëri “Të tjera” në këtë llogari, në shumën 32,511,553lekë, nuk është e sistemuar sipas dosjeve në ekzekutim (debitorëve) në mënyrë analitike.

Evidenca e të ardhurave të realizuara të pa derdhura ne buxhetin e shtetit nga zyra e Përmbarrimit Tiranë për viti 2017 dhe 10/mujorin e vitit 2018 si më poshtë.

Nr	Përshkrimi	Vlera në Lekë
1	Gjoba gjyqësore	2,708,536
2	Të ardhura nga interesat	667,745
3	Tarifë	42,055,132
	Shuma	45,431,414

Burimi Auditimi i DAB në DP, Tiranë

Sa më lartë evidentohet se, vlera e konsiderueshme e paderdhur në buxhet nga ana e kësaj drejtorie si dhe problematikat e zërave të tjerë të “Llogarisë Përmbarrimore” paraqesin nevojën për vlerësimin dhe adresimin e situatës në shkallë sistemi, për marrjen e masave të duhura organizative dhe eliminimin e këtij fenomeni në të ardhmen.

Një trajtim më i hollësishëm mbi veprimtarinë e DAB do të bëhet në projektraportin e auditimit.

Komiteti i Auditimit të Brendshëm

Komiteti i Auditimit të Brendshëm është organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë publike, si dhe mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm i cili është ngritur pranë Ministrisë së Drejtësisë me Urdhrin e Ministrit nr. 182 datë 06.03.2019.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në "MINISTRINË E DREJTËSISË"

Gjatë vitit 2019 Komiteti i Auditimit të Brendshëm ka zhvilluar tre mbledhje përkatësisht:

-Në mbledhjen e parë të datës 15.03.2019 në të cilën janë zgjedhur Kryetari dhe Sekretari si dhe është miratuar rregullorja e funksionimit të këtij organi.

-Në mbledhjen e dytë të datës 09.05.2019 në të cilën janë shqyrtuar çështje lidhur me veprimtarinë e AB si dhe miratimin e kartës së auditimit të brendshëm, e cila miratuar edhe nga titullari i MD.

-Në mbledhjen e tretë të datës 10.10.2019 në të cilën janë shqyrtuar çështje lidhur me veprimtarinë e AB të Ministrisë si dhe AB e institucionit të varësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve si dhe është miratuar plani strategjik 2020-2022 dhe ai vjetor 2020 të këtyre njësive të auditimit të brendshëm të miratuara në vijim me Urdhrin e Ministrit nr. 468 datë 11.10.2019.

Veprimtaria joefektive e DAB në MD evidenton edhe mangësi të komitetit sa i përket rolit këshillëdhënës, monitorues dhe anlizues të punës së kësaj drejtorie mbi veprimet konkrete të nevojshme për tu ndërmarrë me qëllim, çka mungon deri në këtë periudhë të vitit 2019.

❖ Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe veprimtarisë së strukturës së auditimit të brendshëm

Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli në aparatën e Ministrisë së Drejtësisë ka qenë objekt në auditimin e ushtruar nga KLSH gjatë këtij viti për të cilin Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe masat e rekomanduara janë përcjellë me shkresën nr.1437/9 datë 31.07.2019 subjektit të audituar, pra vetëm disa muaj më parë. Për këtë arsye vëmendje iu kushtua veprimtarisë disa mujore në drejtim të zbatimit të tyre dhe masave të marra nga institucioni për përmirësimin e vazhdueshëm, të sistemeve me qëllim ngritjen e sistemeve efektive të kontrolleve të brendshëm.

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Ministrisë së Drejtësisë për periudhën objekt auditimi, rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

"Nëpunës autorizues" është nëpunësi i nivelit më të lartë të menaxhimit në njësinë publike, përgjegjës për zbatimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha strukturat, programet, veprimtaritë dhe proceset që menaxhohen prej tyre.

"Nëpunës zbatues" është një nëpunës i nivelit të lartë menaxhues të njësisë, i cili është përgjegjës për zbatimin e rregullave që lidhen me menaxhimin financiar, kontabilitetin dhe përgatitjen e pasqyrave financiare të njësisë, si dhe përgjigjet para nëpunësit autorizues të njësisë

"Koordinatori i Riskut" dhe përgjigjet për monitorimin e kontrolleve për minimizimin e risqeve brenda njësisë. Megjithatë, sipas Nenit 10 të Ligjit mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Nëpunësi Autorizues mund të delegojë detyra që kanë lidhje me koordinimin e riskut, një menaxheri tjetër te njësisë në vartësi direkt prej tij.

- Auditimi i brendshëm në rolin e vlerësuesit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe këshilluesit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Në Ministrinë e Drejtësisë Përcaktimi i NA dhe NZ është bërë bazuar në kërkesat e ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor të RSH”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin e administratës shtetërore”. Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe Kontabilitetit në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë ka përcjellë caktimet e Nëpunësit Autorizues dhe atij Zbatues me shkresat më poshtë:

Me shkresën nr.1915/1prot, datë 12.11.2018 Nëpunës Autorizues është caktuar z. Aurel Lamçe.

Me shkresën nr.2914/1prot, datë 26.02.2019 Nëpunës Autorizues është caktuar zj. Katrin Treska.

Me shkresën nr.13640/1prot, datë 19.07.2019 Nëpunës Autorizues është caktuar z. Gentian Deva.

Me shkresën nr.19148/3 prot. datë 29.12.2017 Nëpunës Zbatues është konfirmuar znj. Mirjana Zisi me detyrë Drejtor i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar.

Krijimi i grupeve të menaxhimit strategjik (GMS). Në zbatim të ligjit nr. 10269 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, nga Ministria e Drejtësisë për vitin 2019 është formuar Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), me urdhrin nr. 205 datë 15.03.2019, nr. 205/2 datë 09.07.2019 dhe nr. 473 datë 11.10.2019 “Për krijimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik” i miratuar nga Ministri i Drejtësisë. GMS ka në përbërje Ministrin një Zv. Ministër, Sekretarin e Përgjithshëm, Drejtorët e Përgjithshëm dhe Drejtorët e drejtorive. Sipas programeve janë krijuar edhe ekipet e menaxhimit në nivel programi.

Me shkresën nr. 1883 prot. datë 27.02.2019 është caktuar kordinatori i riskut, specialist në sektorin e financës së institucionit.

Me urdhrin nr. 12283 datë 12.12.2018 është ngritur Ekipi i Menaxhimit të Riskut në MD, ndryshuar nga Urdhri nr. 12283/1 datë 10.12.2018, nr 449 datë 30.09.2019 dhe nr. 450 datë 30.09.2019.

Më datë 16.07.2019 është miratuar Regjistri i Riskut të Aktiveve

Me Urdhrin nr. 6872 datë 19.06.2018 rezulton e miratuar dokumenti “Gjurma standarte të auditimit” në të cilën përcaktohet Proceset e punës, referencat ligjore për kryerjen e tyre, Aktivitetet e kontrollit, si dhe strukturat/personi përgjegjës.

Me Urdhrin nr. 447 prot. datë 30.09.2019 institucioni ka miratuar “Gjurmën e përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” duke përcaktuar gjithashtu proceset nëpërmjet të cilave kalon ky proces.

Me urdhrin nr. 467 prot. datë 11.10.2019 institucioni ka miratuar “Regjistrin e Riskut” për strukturat në nivel drejtorie për Ministrinë e Drejtësisë.

Me urdhrin nr. 469 prot. datë 11.10.2019 institucioni ka miratuar “Hartën e Proceseve” për strukturat në Ministrinë e Drejtësisë.

Lidhur sa më sipër nga ana e subjektit të audituar gjatë periudhës disa mujore vihen re përpjekje për plotësimin e kërkesave mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin por do të veçonim disa fusha ku nevojitet vëmendje e shtuar dhe në kohë të shpejtë nga ana e menaxhmentit .



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Ndarja e detyrave

Në pjesën më të madhe të njësive publike ekzistojnë përshkrimet e punës, të cilat përfshihen në rregulloret e brendshme ose në kontratat e punës. Por ndryshimet e vazhdueshme të strukturave si dhe të formatimit të drejtorive kërkojnë dhe rishikimin në vazhdimësi të rregulloreve të brendshme të institucioneve si rrjedhojë edhe rishikimet e pozicioneve të punës, *gjë e cila nuk është realizuar nga institucioni.*

Informim dhe komunikimi.

Informimi është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen me cilësi të detyrave të ngarkuara. Komunikimi me titullarin dhe nëpunësit e tjerë duhet bërë në formën dhe kohën e duhur për ti ndihmuar ata në përmbushjen e detyrave dhe të përgjegjësive. Menaxherët e njësisë zotërojnë informacion, por jo të mjaftueshëm për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe të kontrollit pasi, zbatimi i ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, nuk është respektuar nga të gjithë hallkat e njësisë dhe se, institucioni nuk ka kryer trajnime për kuptimin dhe zbatimin e ligjit të MFK-së në të gjitha hallkat.

Inventarizimi dhe arkivimi i dosjeve:

Nga auditimi rezultoi se, dosjet e auditimit të brendshëm vijojnë ende të painventarizuara dhe të panumëruara sipas kërkesave të parashikuara në “Normat tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë” të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, çka paraqet nevojën për monitorim të punonjësve përgjegjës si dhe zbatimin e dispozitave ligjore në rast moskryerje apo kryerjes së saj jo në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të sipërcituara.

- Mungesa e një Plani të Kontrollit të Brendshëm (sipas Aneksit nr. 11 të Manualit), i cili është një instrument për përshkrimin dhe organizimin e aktiviteteve të kontrollit (kush, kur dhe si të kontrollosh). Mungesa e planeve të kontrollit kanë ndikuar dhe në mos monitorimin e detyrave që menaxherët i ngarkojnë stafit, mbi cilësinë dhe afatet e përmbushjes së tyre.

-Analiza e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit (Sistemet IT)

Në zbatim të programit të auditimit, dhe drejtimit të mësipërm u auditua përputhshmëria e veprimtarisë së subjektit me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi dhe verikimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara janë në përputhje me bazën e parimeve të profesionalizmit, të efikasitetit, të përgjegjësisë dhe korrektësisë në zbatimin e legjislacionit në fuqi, në bazë të të cilit ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet.

Sistemet e Teknologjisë së Informacionit

Për veprimtarinë e kësaj drejtorie për periudhën nën auditim Janar-Tetor 2019, grupit i auditimit trajtoi dokumentacionin e paraqitur nga subjekti i audituar përkatësisht:

- Dokumentacion kontabël lidhur me regjistrimin në kontabilitet të sistemeve IT.
- Të dhëna mbi pagesat e mirëmbajtjes të kryera nga institucioni për periudhën nën auditim.
- Informacion mbi sistemet dhe funksionin e tyre.
- Të tjera lidhur me këtë drejtim auditimi.

Baza ligjore mbi të cilën bazohet veprimtaria administrative.

-Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në "MINISTRINË E DREJTËSISË"

-Manuali "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".

-Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

-Ligjit Nr. 10 325, datë 23.09.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore",

-VKM-së Nr. 673, datë 22.11.2017, "Për Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit",

-Të tjera akte ligjore, nënligjore e rregullative.

Aktualisht Ministria e Drejtësisë ka në përdorim 6 sisteme të teknologjisë së informacionit. Ndër të cilët citojmë:

1- Regjistri Noterial Shqiptar (RNSH)

Të dhëna mbi sistemin:

a)Kontratë prokurimi: Nr.2128, datë 23.04.2019

b)Autoriteti Kontraktor: Agjencia Kombetare e Shoqerise se Informacionit

c)Institucioni Përfitues: Ministria e Drejtësisë

d)Operator Ekonomik: " Communications Progress "

e)Periudha e mirëmbajtjes: 24 muaj

f)Aktualisht sistemi është në fazën e mirëmbajtjes

g)Grupi i punës i ngritur është krijuar me përfaqësues nga MD dhe AKSHI

h)Ky sistemi hostohet në MD

Në kuadër të VKM Nr. 304, datë 21.5.2014 " Për krijimin e Bazës së të Dhënave Shtetërore të Shërbimit Noterial Shqiptar, Regjistri Noterial Shqiptar (RNSH)" është krijuari baza e të dhënave shtetërore të Shërbimit Noterial Shqiptar, e quajtur Regjistri Noterial Shqiptar (RNSH).

Aktualisht gjendet vetëm urdhëri nr. 356, datë 04.09.2013 "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për regjistrin kombëtar të testamenteve dhe regjistrin kombëtar të dëshmimeve të trashëgimisë" por, *mungon rregullorja e brendshme për përdorimin e këtij sistemi* dhe administrimin e bazës së të dhënave, në zbatim të Ligjit Nr. 10 325, datë 23.09.2010, "Për Bazat e të Dhënave Shtetërore", VKM-së Nr. 673, datë 22.11.2017, "Për Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit", VKM-së Nr. 945, datë 02.11.2012 Për Miratimin e Rregullores "Administrimi i Sistemit të Bazave të të Dhënave Shtetërore". Sipas spjegimeve kjo rregullore është në fazën përfundimtare për miratimin e saj.

2- Sistemi i Menaxhimit Elektronik të Çështjeve të Përmbarimit Gjyqësor (ALBIS)

Të dhëna mbi sistemin:

a)Kontratë prokurimi: Nr. 7260/13, datë 09.02.2017

b)Autoriteti Kontraktor: Ministria e Drejtësisë

c)Institucioni Përfitues: Ministria e Drejtësisë dhe DPP

d)Operator Ekonomik: Bashkimi i operatorëve ekonomik "Soft Solution & Fastech"

e)Periudha e mirëmbajtjes: 48 muaj

f)Aktualisht sistemi është në fazën e mirëmbajtjes

g)Grupi i punës i ngritur është krijuar me përfaqësues nga MD, DPP dhe AKSHI

h)Ky sistemi hostohet në MD



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Bazuar në Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 416, datë 4.7.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 443, datë 16.6.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, regjistrimin, mënyrën e funksionimit, të administrimit e të ndërveprimit dhe për sigurinë e sistemit të menaxhimit elektronik të çështjeve të përmbartimit gjyqësor (ALBIS)”, kjo databazë është ndërtuar për të mundësuar informatizimin e të gjitha proceseve dhe procedurave të përpunimit të çështjeve përmbartimore që realizohen nga përmbartuesit.

Nga ana e sektorit të IT është dërguar draft rregullorja nga ana teknike pranë Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore të Çështjeve të Drejtësisë për përdorimin e këtij sistemi dhe administrimin e bazës së të dhënave, në zbatim të Ligjit Nr. 10 325, datë 23.09.2010, “Për Bazat e të Dhënave Shtetërore”, VKM-së Nr. 673, datë 22.11.2017, “Për Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, VKM-së Nr. 945, datë 02.11.2012 Për Miratimin e Rregullores “Administrimi i Sistemit të Bazave të të Dhënave Shtetërore”. Nuk ka ende një rregullore të miratuar për përdorimin e këtij sistemi.

3- Databaza Qendrore për Bashkëpunimin Ndërgjyqësor me Jashtë

Të dhëna mbi sistemin:

- a) Kontratë prokurimi: Nr. 712/13, datë 27.07.2015
- b) Autoriteti Kontraktor: Ministria e Drejtësisë
- c) Institucion Përfitues: Ministria e Drejtësisë
- d) Operator Ekonomik: “ish Rogat Security, SAS shpk”
- e) Periudha e mirëmbajtjes: 48 muaj
- f) Aktualisht sistemit përfundoi në fund të tetorit 2019*, Grupi i punës i ngritur është krijuar me përfaqësues nga MD dhe AKSHI
- g) Hostohet në ambientet e AKSHIT

Drejtorja e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Ministrinë e Drejtësisë zhvillon bashkëpunimin gjyqësor me autoritetet e huaja, bashkëpunimin ndërmjet prokurorive, gjykatave shqiptare, Interpolit, prokurorive dhe gjykatave të huaja, në zbatim të kushtetutës, akteve ndërkombëtare ku Shqipëria është palë si dhe legjislacionit procedural penal dhe civil vendas.

Sistemi shërben për regjistrimin, ruajtjen, procesimin dhe arkivimin e të dhënave në format elektronik që përbëjnë sistemin e menaxhimit në mënyrë elektronike të dosjeve të ekstradimeve, transferimeve, letër porosive etj. *Nuk ka ende një rregullore të miratuar për përdorimin e këtij sistemi.*

4- Arkiva e Ministrisë së Drejtësisë për Gjendjen Gjyqësore të Shtetasve Shqiptarë nga Institucionet e Huaja

Të dhëna mbi sistemin:

- a) Kontratë prokurimi: Nr.6721/11 datë 07.12.2016
- b) Autoriteti Kontraktor: Ministria e Drejtësisë
- c) Institucion Përfitues: Ministria e Drejtësisë
- d) Operator Ekonomik: “BNT Electronics”
- e) Periudha e mirëmbajtjes: 48 muaj
- f) Hostohet në ambientet e AKSHIT

Funksioni i Dixhitalizimit të Arkivës për Gjendjen Gjyqësore të shtetasve shqiptarë për vepra të kryera jashtë, nëpërmjet indeksimit, skanimit, përpunimit, kërkimit dhe shfrytëzimit e kësaj arkive.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Sistemi i informacionit që përdoret nga stafi i Ministrisë së Drejtësisë, i cili përditëson në kohë reale rekordet kriminale në rrugë elektronike. *Nuk ka ende një rregullore të miratuar për përdorimin e këtij sistemi.*

5- Sistemi elektronik për menaxhimin e funksionaliteteve dhe implementimi i “High Availability” për infrastrukturën qendrore të sistemeve IT në Ministrinë e Drejtësisë

Të dhëna mbi sistemin:

- a) Kontratë prokurimi: Nr. 855/8, datë 26.04.2017
- b) Autoriteti Kontraktor: Ministria e Drejtësisë
- c) Institucioni Përfitues: Ministria e Drejtësisë dhe DPP
- d) Operator Ekonomik: Bashkimi i operatorëve ekonomik “Dega Semos AL dhe S&T Albania”
- e) Periudha e mirëmbajtjes: 48 muaj
- f) Aktualisht sistemi është në fazën e mirëmbajtjes
- g) Grupi i punës i ngritur është krijuar me përfaqësues nga MD, AKSHI
- h) Ky sistemi hostohet në MD

Ky nuk është një sistem i mirëfillitë por infrastrukturë mbështetëse për sistemin e RNSH dhe ALBIS.

6 - Sistemi Elektronik për Dixhitalizimin e Arkivës Gjyqësore (Lundër):

Sistemi Elektronik për Dixhitalizimin e Arkivës Gjyqësore (Lundër), ky sistem nuk është marr në dorëzim nga ana e Ministrisë së Drejtësisë .

Dhoma e serverit

Sipas të dhënave gjate viti 2019 situata në Dhomën e Serverave në MD (e cila ndodhet në katin e tretë të godinës), është përmirësuar duke zëvendësuar metodën e hyrje-daljeve me çelës të thjeshtë me një sistem të mirëfillitë Access Control-i si dhe është instaluar një sistem i ri kondicionimi i përshtatshëm për një dhomë server-ash, çka jep më tepër siguri në ruajtjen dhe mbrojtjen e tyre.

-Referuar ndryshimeve ligjore të VKM nr. 673, datë 22.11.2017, “Për Organizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar, nga ana e institucionit janë ngritur grupet e punës për kalimin kapital të sistemeve dhe konkretisht.

Urdhri nr. 5293/1 prot. datë 18.05.2018 “Mbi personat e ngarkuar për evidentimin dhe kalimin kapital të infrastrukturës hardëare dhe sistemeve IT” janë ngarkuar 5 (pesë) punonjës. Urdhri i Përbashkët nr. 6935 prot. datë 19.05.2018 për përcaktimin e listës së aktiveve dhe kryerjen e procedurave përkatëse nga grupet e caktuara.

Urdhri nr. 9504 prot. datë 18.09.2018 për ngritjen e grupeve të punës për transferimin pa pagesë të infrastrukturës IT janë ngarkuar 3 (tre) punonjës.

Shkresa nr. 8504/2 prot. datë 21.12.2019 “Informacion nga grupi i ngritur.”

Po kështu Ministria e Drejtësisë i është drejtuar AKSHIT me informacione lidhur me sistemet fillimisht me informacionet dhe në tetor 2019 janë dërguar vërtetimet e realizimit . Pra refruar akteve përkatës evidentohen vonesa në përfundimin e këtij kalimi kapital.

Shkresat drejtuar AKSHI-t

Nr. 162/2 prot. datë 01.02.2019 “Dërgohet informacion për sistemet “ALBIS. “RNSH, HIGH AVAILABILITY”, “Dixhitalizimi i Arkivës së MD”,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Nr. 9504/4 prot. datë 21.02.2019 “Përcillet informacion për sistemin “Ndërtimi i databazës qendrore bashkëpunimin ndërgjyqësor me jashtë”.

Nr. 7081 datë 17.10.2019 Vërtetim Realizimi për sistemin “Ndërtimi i databazës qendrore bashkëpunimin ndërgjyqësor me jashtë”

Nr. 7081/1 datë 17.10.2019 “Dërgim informacioni shtesë ”

Nr. 7081/2 datë 17.10.2019 Vërtetim Realizimi për sistemin “Menaxhimi elektronik i çështjeve të përmbarimit”, ALBIS “Albainan Baliffs Information System”.

Nr. 7081/3 datë 17.10.2019 Vërtetim Realizimi për sistemin “Gjendjen gjyqësore të Shtetasve Shqiptarë nga Institucionet e Huaja ”

Nr. 7081/4 datë 17.10.2019 Vërtetim Realizimi për sistemin “Për menaxhimin e funksionaliteteve dhe implementimi i High Availability për infrastrukturën Qendrore të Sitemeve IT në MD”.

Nr. 7081/5 datë 17.10.2019 Vërtetim Realizimi për sistemin “Regjistri Noterial Shqiptar”.

Urdhri nr. 5293/1 prot. datë 18.05.2018 “Mbi personat e ngarkuar për evidentimin dhe kalimin kapital të infrastrukturës hardware dhe sitemeve IT” janë ngarkuar 5 (pesë) punonjës. Urdhri i Përbashkët nr. 6935 prot. datë 19.05.2018 për përcaktimin e listës së aktiveve dhe kryerjen e procedurave përkatëse nga grupet e caktuara.

Urdhri nr. 9504 prot. datë 18.09.2018 për ngritjene grupeve të punës për transferimin pa pagesë të infrastrukturës IT janë ngarkuar 3 (tre) punonjës.

Shkresa nr. 8504/2 prot. datë 21.12.2019 “Informacion nga grupi i ngritur.”

-Lidhur sa më sipër rezultoi se, megjithëse dy nga pesë sitemet IT funksionalë janë alokuar fizikisht tek AKSHI, ato vijojnë të reflektohen në regjistrin e aktiveve të Ministrisë së Drejtësisë. Gjithashtu MD vijon të paguajë pa të drejtë nga buxheti i vetë për periudhën Janar-Tetor 2019 shumën prej **5,862,400 lekë** ndërkohë që këto shpenzime duhet të ishin përballuar nga AKSHI. Pagesa për mirëmbajtje paraqiten si vijon.

-Mirëmbajtje e sistemit Arkiva e Ministrisë së Drejtësisë	100,000 lekë
-Mirëmbajtje e sistemit Bashkëpunimin Ndërgjyqësor me Jashtë	378,000 lekë
-Mirëmbajtje e sistemit High Availability	3,884,400 lekë
-Mirëmbajtje e sistemit ALBIS	1,500,000 lekë

Në kontratën e mirëmbajtjes të lidhura midis MD dhe operatorit ekonomik fitues nuk janë reflektuar ende ndryshimet e parashikuara në pikën 18 dhe 19, dhe 24 të VKM nr. 673, datë 22.11.2017, “Për Organizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, e ndryshuar, ku përcaktohet se,.

18. Institucionet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave duhet të dorëzojnë pranë AKSHI-t 1 (një) kopje të dokumentacionit të plotë të çdo sistemi dhe infrastrukture TIK ekzistuese dhe kodin e burimit. Sitemet dhe infrastruktura TIK ekzistuese kalojnë nën administrimin dhe inventarin e AKSHI-t, së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile përkatëse brenda datës 30 shtator 2018.

19. Për sitemet dhe infrastrukturat TIK të cilat kalojnë në administrim dhe inventar të AKSHI-t dhe që zhvillohen ose mirëmbahen nëpërmjet marrëveshjeve ose kontratave të nënshkruara nga institucionet me palë të treta, të reflektohen ndryshimet përkatëse në këto akte.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në "MINISTRINË E DREJTËSISË"

24. Fondet buxhetore për shërbimet sipas shkronjës "i", të pikës 6, të këtij vendimi, për institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, do të parashikohen në buxhetin vjetor të AKSHI-t. Për të gjitha institucionet jobuxhetore, AKSHI do t'i ofrojë shërbimet kundrejt tarifave. Efektet financiare të kësaj pike fillojnë më 1 janar 2019.

6. AKSHI, në ushtrim të veprimtarisë së saj, kryen edhe këto detyra e përgjegjësi të veçanta, si më poshtë vijon:

i) Përgjigjet për ngritjen, mirëmbajtjen dhe administrimin e sistemeve dhe aplikacioneve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, për infrastrukturën e qendëruar dhe infrastrukturën TIK, për institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave. Ai organizon prokurimin e përqendruar për pajisjet TIK, me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla, dhe për institucionet dhe organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, të cilat, jo më vonë se data 30 qershor, i dërgojnë kërkesë me shkrim AKSHI-t për nevojat e tyre për projektet dhe pajisjet TIK për vitin pasardhës.

Si konkluzion: Mos përfundimi i procesit të transferimit të sistemeve pranë AKSHI-t referuar përcaktimeve ligjore në fuqi e kanë ekspozuar institucionin drejt shpenzimeve të panevojshme nga buxheti i vet lidhur me shpenzimet e mirëmbajtjes për këto sisteme por jo vetëm.

Titulli i Gjetjes nr. 1:	Mbi veprimtarinë 10 mujore të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm
Situata:	<p>Nga auditimi mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Drejtësisë rezultoi se,</p> <p>a. Kjo njësi auditimi referuar strukturës organizative të miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 238 datë 13.12.2017 është e organizuar në nivel drejtorie dhe ka të parashikuar një staf prej pesë punonjësish (1+4), Drejtorin dhe 4 specialistë. Prej muajit Dhjetor 2017 pozicioni i drejtuesit të kësaj njësie rezulton vakant duke krijuar një boshllëk në drejtimin e saj. Me Urdhrin nr. 2969 datë 12.03.2018 të Ministrit të Drejtësisë, një specialist i kësaj drejtorie është caktuar për kryerjen e detyrave të Drejtorit në DAB deri në emërimin e drejtuesit të përhershëm. Drejtuesi i komanduar e ka ushtruar funksionin deri në marrjen e masës së pezullimit ndaj tij në muajin Tetor 2019. Aktualisht kjo drejtori funksionon vetëm me dy auditues nga të cilët një auditues i emëruar në këtë funksion më datë 23.08.2019, ende në periudhë prove megjithëse ajo ka si objekt auditimi apratin e MD-së dhe rreth 34 institucione në varësie.</p> <p>b. Sipas të dhënave rezultoi se, DAB ka hartuar planin vjetor të auditimit për vitin 2019 dërguar Drejtorisë së Harmonizimit Financiar në të cilin parashikohet të realizohen 12 auditime nga 17 të tillë të parashikuar në planin strategjik 2018-2020, pra me 5 (pesë) auditime më pak. Për periudhën nën auditim Janar-Tetor 2019 janë zhvilluar 7 (shtatë) angazhime auditimi nga të cilat, 3 (tre auditime) janë auditime të paplanifikuara në planin vjetor dhe vetëm 4 (katër) janë pjesë e planit. Nga angazhimet e zhvilluara gjithsej, në 3 (tre) auditime ka përfunduar angazhimi, në 2 (dy) auditime është hartuar raporti paraprak dhe në 2 (dy) raste auditimi ndodhet në proces. Në materialet e paraqitura nuk gjenden shpjegime lidhur me devijimet në planin vjetor dhe shtimin e tre auditimeve të reja. Po</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

	<p>kështu që ndryshimet e planit nuk rezultojnë të jenë miratuar prej Komitetit të Auditimit të Brendshëm referuar VKM nr.114 datë , Kreu III. pikës 1/b të tij.</p> <p>c. Në planin vjetor të auditimeve për vitin 2020 nuk rezultojnë të jenë përfshirë auditimet të cilat nuk mund të realizohen gjatë vitit 2019 të cilat aktualisht janë 8 (tetë) të tillë. Nga të gjitha hallkat përgjegjëse, për hartimin, monitorimin si dhe miratimin e planit vjetor mungojnë spjegimet lidhur me spostimin/anashkalimin e subjekteve të parashikuara për auditim gjatë vitit 2019 por të përealizueshëm në kushtet aktuale. Mospërfshirja e tyre në planin e ardhshëm si auditime të përealizuara, shkëput vijueshmërinë dhe ul besueshmërinë për hartimin e një plani bazuar në një vlerësim objektiv të riskut për vitin në vijim.</p> <p>Për periudhën nën auditim Janar-Tetor 2019, nëse do të shohim veprimtarinë audituese në harkun kohor do të shohim se ajo zë vetëm një pjesë të shkurtër kohore përgjatë periudhës dhe mbulimi me auditim nuk ka qenë i plotë duke sjellë mosezaurim të planit vjetor të parashikuar.</p> <p>d. Në angazhimet e kryera gjatë periudhës nën auditim evidentohet se, thuajse në të gjitha rastet njësia që do të auditohej nuk është njoftuar 10 ditë përpara si dhe në dosje nuk gjendet argumentim lidhur me këtë mungesë si përcaktohet në pikën 4.1.4 të Manualit të Auditimit të Brendshëm/2016</p> <p>Në planin e auditimit për vitin 2019 por dhe planet strategjikë 2018-2020 dhe 2019-2021 nuk parashikohen auditime tematikë për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna drejt subjekteve të audituar.</p> <p>Mungesa e veprimeve aktive për zbatimin e rekomandimeve në një kohë të shpejtë nuk i lejon manaxhimit të lartë mundësi, të informohet mbi masat e marra nga subjekti i audituar çka mund të ndikojë në ngadalësimin e zbatimit apo mosezbatim të tyre.</p> <p>Në programet e auditimit përfshihet si drejtim i veçantë auditimi dhe Teknologjia e Informacionit, megjithëse specialistët në grupet e auditimit nuk janë të diplomuar apo të kenë formim profesional të nevojshëm për këtë fushë auditimi referuar pikës 2.4.4 të Manualit të Auditimit/2016. Auditimi për këtë fushë mjaftohet me verifikime sipërfaqësore dhe nuk jep sigurim mbi sistemet.</p> <p>Stafi i paplotësuar gjatë periudhës nën auditim, tkurrja e numrit të auditimeve gjithsej, përzgjedhja tematike, shpërndarja disproporcionale sipas periudhave, të programeve të auditimit, si dhe afatet e shkurtra për përmbushjen e tyre, nuk krijojnë siguri të arsyeshme për përmbushjen e plotë dhe me cilësisë të objektivitetit të kësaj strukture për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë e sektorit publik</p>
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none">-Ligji Nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”-VKM nr. 83 datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar.-VKM nr.160, datë 02.03.2016 “Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e komitetit të auditimit të brendshëm në njësitë publike.-Manuali i Auditimit të Brendshëm në sektorin publik miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100 datë 25.10.2016.
Ndikimi/Efekt:	Mungesë mbi besueshmërinë e funksionimit të MFK në njësitë publike.
Shkaku:	Mungesa të theksuara në personel dhe nivel drejtues.
Rëndësia:	E lartë

**KONTROLLI I LARTË I SHETIT****Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në "MINISTRINË E DREJTËSISË"**

Titulli i Gjetjes nr. 2:	Mbi auditimin e ushtruar nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Drejtësisë pranë Drejtorisë së Përmbarrimit Tiranë
Situata:	Nga auditimi rezultoi se, në raportin Përfundimtar të Auditimit të mbajtur nga DAB të Ministrisë së Drejtësisë pranë Drejtorisë së Përmbarrimit Tiranë, janë evidentuar të ardhura të realizuara të pa derdhura në buxhetin e shtetit konkretisht, të ardhurat e krijuara për vitin 2017 dhe 10/mujorin e vitit 2018 e cila përbëhet nga gjopa gjyqësore, të ardhura nga interesi, tarifë ekzekutimi në shumën 45,431,414 lekë, nuk janë administruar konform Ligjit nr. 9975 datë 28.07.2008 "Për taksat kombëtare", nenit 6 "Transferimi i të ardhurave nga taksat kombëtare në Buxhetin e Shtetit", neni 11 "Tarifa shërbimi", 11/2 "Deklarata për pagesën e tarifave kombëtare" dhe këto të ardhura të krijuara në vite nuk janë derdhur në Buxhetin e Shtetit brenda 15 ditëve nga përfundimi i muajit në të cilin është kryer arkëtimi, si parashikohet në legjislacionin përkatës, por janë lënë në llogarinë përmbarrimore pranë bankave të niveleve të dyta, megjithëse kuadri ligjor ka qenë i plotë për transferimin e tyre në Buxhetin e Shtetit. Po kështu zëri "Të tjera" në këtë llogari, në shumën 32,511,553 lekë, nuk është e sistemuar sipas dosjeve në ekzekutim (debitorëve) në mënyrë analitike. Nga ana DAB janë dhënë rekomandimet përkatëse drejtuar kësaj njësie për përmirësimin e gjendjes por nuk janë marrë masa për shtrirjen e rekomandimit në sistem, pasi fenomeni mund të paraqitet i shtrirë edhe në subjekte të tjerë të kësaj natyre.
Kriteri:	Ligjit nr. 9975 datë 28.07.2008 "Për taksat kombëtare", nenit 6 "Transferimi i të ardhurave nga taksat kombëtare në Buxhetin e Shtetit" neni 11 "Tarifa shërbimi", 11/2 "Deklarata për pagesën e tarifave kombëtare"
Ndikimi/Efekti:	Ekziston risk i shtrirjen e problematikës në gjithë drejtoritë paralele
Shkaku:	Adresim specifik dhe jo në rang sistemi i problematikës
Rëndësia:	E lartë

Titulli i Gjetjes nr. 3:	Mbi transferimet dhe pagesat për mirëmbajtje për sistemet IT
Situata:	Nga auditimi rezultoi se, Ministria e Drejtësisë vijon të paguajë pa të drejtë nga buxheti i vetë kostot e mirëmbajtjes për katër nga pesë sistemet të cilat janë në funksionim. Vetëm gjatë periudhës Janar-Tetor 2019 shpenzimet e mirëmbajtjes së tyre arrijnë shumën prej 5,862,400 lekë ndërkohë që këto shpenzime duhet të ishin përballuar nga AKSHI. Në kontratën e mirëmbajtjes të lidhura midis MD dhe operatorit ekonomik fitues ende nuk janë reflektuar ende ndryshimet e parashikuara në pikën 18 dhe 19, dhe 24 të VKM nr. 673, datë 22.11.2017, "Për Organizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, e ndryshuar, Mospërfundimi i procesit të transferimit të sistemeve pranë AKSHI-t referuar përcaktimeve ligjore në fuqi e kanë ekspozuar institucionin drejt shpenzimeve të panevojshme nga buxheti i vet lidhur me shpenzimet e mirëmbajtjes për këto sisteme por jo vetëm. Megjithëse dy nga pesë sistemet funksionale IT janë alokuar fizikisht tek AKSHI, ato vijnë të reflektohen në regjistrin e aktiveve të Ministrisë së Drejtësisë.
Kriteri:	VKM nr. 673, datë 22.11.2017, "Për Organizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, e ndryshuar, pika 18 dhe 19, dhe 24.
Ndikimi/Efekti:	Shpenzime të panevojshme dhe risk mbi procesin e transferimit.
Shkaku:	Mangësi dhe veprime të ngadalta nga ana e grupeve të punës të institucioneve respective.
Rëndësia:	E lartë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

✚ Drejtimi 6: “Probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit”

❖ Mbi caktimin e nëpunësit autorizues në Institutin e Mjekësisë Ligjore

Nga auditimi i KLSH i cili po ushtrohet paralelisht edhe në Institutin e Mjekësisë Ligjore, institucion në varësi të Ministrit të Drejtësisë, mbi bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit mbi realizimin e procedurave të prokurimit publik, në zbatim të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 56 (titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar), u konstatua se;

-Drejtuesi i institucionit z.Bledar Xhemali nuk gjendet në cilësinë e Nëpunësit Autorizues (NA) të institucionit, por në këtë cilësi është caktuar zj.Valbona Sulejmanllari me detyrë “Përgjegjës sektori në sektorin e menaxhimit të akteve dhe laboratorit”. Kjo sipas shkresave të Ministrisë së Drejtësisë nr.5083 prot, datë 22.09.2017 dhe nr.12396/1 prot, datë 19.09.2017 nga Ministria e Financave me lëndë “Mbi caktimin e Nëpunësit Autorizues të Përkohshëm për IML” sipas rrethanave faktike dhe juridike, si më poshtë vijon:

-Institutin e Mjekësisë Ligjore, institucion në varësi të Ministrit të Drejtësisë, me fillimin e efekteve juridike të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, është përfshirë në skemën e administrimit të shërbimit civil.

-Evidentohet se, B.Xhemali gëzon statusin e nëpunësit civil, pasi ka filluar marrëdhënien e punës në këtë institucion, me aktin administrativ nr.5762/1 prot, datë 26.11.2013, të Ministrit, në pozicionin “Drejtor i Institutit të Mjekësisë Ligjore” të cilin e ka mbajtur deri më datë 20.06.2017, deri në daljen e aktit administrativ nga ish-Ministri i Drejtësisë me shkresë nr.4052/3 datë 20.06.2017 “Njoftim mbi fillimin e ecurisë disiplinore”, shoqëruar me vendimin përfundimtar nr.4052/8 prot, datë 28.06.2017 “Për marrjen e masës disiplinore “largim nga shërbimi civil” për z.Bledar Xhemali.”

Për sa më sipër, Z.Xhemali e ka ankimuar këtë vendim, duke rifituar vendin e punës dhe rikthimi në detyrë në bazë të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nr.3462 datë 13.09.2017, me ekzekutim të përkohshëm deri në momentin e vendimit të Gjykatës së Apelit Administrativ (është në proces ankimimi nga MD).

-Momentalisht, këtë detyrë e ushtron zj.Valbona Sulejmanllari me detyrë përgjegjës sektori në sektorin e menaxhimit të akteve dhe laboratorit, në bazë të shkresave të sipër cituara.

-Në bazë të “Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore” neni 60, janë të përcaktuara detyrimet ligjore të pozicionit të Drejtorit të IML, specifikisht, ky nen përcakton se:

“Drejtori i I.M.L-së është Titullari i Institutit të Mjekësisë Ligjore.

Ai drejton dhe kontrollon veprimtarinë në sistemin e përgjithshëm të ekspertimit mjeko-ligjor, sipas kompetencave të parashikuara në këtë Rregullore.

Drejtori ka të drejtën dhe autoritetin të përfaqësojë I.M.L-në marrëdhënie me të tretët.

Drejtori i I.M.L-së mban përgjegjësi për ligjshmërinë e veprimeve të tij dhe stafit gjatë kryerjes së detyrës dhe kur nuk është i bindur për ligjshmërinë e urdhërave dhe vendimeve që zbaton duhet të informojë menjëherë organet eprorë. Ai nuk është i detyruar të zbatojë një urdhër të paligjshëm.

Drejtori miraton planet e punës të sektorëve në varësi të tij dhe paraqet për miratim në Ministrinë e Drejtësisë planet e punës tremujore dhe vjetore.

Në zbatim të kompetencave të tij, për zbatimin e detyrave nga vartësit, Drejtori nxjerr Urdhëra dhe Udhëzime, të cilat janë të detyrueshme për zbatim nga të gjitha strukturat e I.M.L-së.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Kërkon dhe kontrollon nga të gjithë ekspertët e I.M.L-së, personelin teknik e administrative kryerjen e detyrës me profesionalizëm e korrektësi dhe mbikqyr zbatimin e akteve ligjore e nënligjore në fuqi.”

Grupi i auditimit, vlerëson se, qartësisht disa prej funksioneve të Drejtorit të IML, kufizohen për shkak-pasojë të mospasjes së cilësisë së pozicionit të Nëpunësit Autorizues (NA), kjo në kundërshtim të ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar neni 19, ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar neni 12, për rrjedhojë dhe ushtrimin e kompetencave në fushën e prokurimeve publike në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 56 (titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar).

Si përfundim, grupi i auditimit, vlerëson se ka vonesë të zgjatur në lidhje me miratimin e nëpunësit autorizues (NA) nga Ministria e Drejtësisë në koordinim me Ministrinë e Financave, pasi sipas situatës së mësipërme ky vendim është marrë i mirëqënë dhe si rrjedhojë me ardhjen në detyrë të z.Bledar Xhemali (Drejtor IML) duhet që t’i kalonin dhe detyrat e NA që janë të përcaktuara në bazë të ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar neni 19, ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar neni 12, për rrjedhojë dhe ushtrimin e kompetencave në fushën e prokurimeve publike në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 56 (titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar).

Gjithashtu, nga auditimi rezulton se nga Ministria e Drejtësisë, nuk është berë ende kërkesë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për ndryshimin e Nëpunësit Autorizues të Përkohshëm, ndonëse nga IML me shkresat nr1616 prot datë 21.09.2018 dhe nr.1855 prot datë 09.03.2019, është kërkuar ndryshimi respektiv për caktimin e titullarit të institucionit në pozicionin e nëpunësit autorizues.

❖ *Mbi përkthimin ligjor, kontraktimin e tij si dhe pagesat e kryera nga institucioni për këtë shërbim*

Në zbatim të programit të auditimit, dhe drejtimit të mësipërm u auditua përputhshmëria e veprimtarisë së subjektit me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi dhe verikimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara janë në përputhje me bazën e parimeve të profesionalizmit, të efikasitetit, të përgjegjësisë dhe korrektësisë në zbatimin e legjislacionit në fuqi, në bazë të të cilit ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet.

Për veprimtarinë e institucionit për periudhën nën auditim Janar-Tetor 2019, grupit i auditimit trajtoi dokumentacionin e paraqitur nga kjo drejtori dhe përkatësisht:

- Pagesa të kryera nga institucioni lidhur me shërbimin e ofruar.
- Të tjera lidhur me këtë drejtim auditimi.

Baza ligjore mbi të cilën bazohet veprimtaria administrative.

- Ligji nr.8678, datë 14.5.2001 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në "MINISTRINË E DREJTËSISË"

-Ligji nr.9936, datë 26.6.2008 Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, (i ndryshuar).

-Ligji nr. 9920 "Për Procedurat tatimore në RSH", i ndryshuar,

-Udhëzimi i përbashkët MD dhe MF nr. 3165 datë 12.05.2004, i ndryshuar.

-Të tjera akte ligjore, nënligjore e rregullative.

Nga auditimi mbi pagesat e kryera nga Ministria e Drejtësisë gjatë periudhës Janar-Shtator 2019 rezultoi se, gjatë kësaj periudhe janë kryer pagesa për përkthyesit e njohur nga kjo ministri në listat zyrtare të publikura të cilët sipas të dhënave të institucionit nuk ishin të regjistruar në organet tatimore dhe ndaj tyre është mbajtur tatim në burim në masën prej 15 përqind të vlerës së shërbimit, i cili më pas është paguar nga MD në buxhetin e shtetit. Të dhënat mbi pagesat 9 mujore për këtë kategori shërbimi paraqitet.

USH	Data	Pershkrimi	T.Burim i paguar
89	19.03.2019	Tatim ne burim perkthyesit zyrtare (Janar 2018 - Qershor 2018)	3,601,045
255	17.05.2019	Tatim ne burim perkthyesit zyrtare me listepagese	3,220,683
414	17.07.2019	Tatim ne Burim perkthyesive zyrtare Mars 2019	1,268,117
591	18.09.2019	Tatim ne burim perkthyesit zyrtare Maj 2019	722,391
Totali deri në SHTATOR 2019			8,812,236

Burimi:MD përpunuar nga grupi i auditimit

Vlera totale e shërbimit të kryer nga kjo kategori përkthyesish është **58,748,240 lekë** (8,812,236/15%) ose rreth ¼ e shpenzimeve 9 mujore.

-Po si dhe nga kush kryhet shërbimi i përkthimit të akteve.

Në Ministrinë e Drejtësisë përkthimi i materialeve të cilat dërgohen drejt institucioneve homologe apo anasjelltas kryhen aktualisht nëpërmjet:

- ✓ përkthyesve të punësuar pranë institucionit
- ✓ përkthyesve të njohur të listës të regjistruar pranë organeve tatimore
- ✓ përkthyesve të njohur të listës të pa regjistruar pranë organeve tatimore

Kategoritë e mësipërme janë të evdientuar në listën e përkthyesve të njohur dhe përkthejnë materiale të karakterit administrativ por dhe dokumente të cilat klasifikohen sipas ligjit Nr.8457, datë 11.2.1999 Për Informacionin e Klasifikuar "Sekret Shteteror" për të cilat MD ka publikuar emrat përkatës të përkthyesve që zotërojnë certifikatë sigurie. Të dy grupet e përkthyesve janë të publikuara nga kjo ministri në faqen e saj zyrtare. Vlerat e përkthimit të paguara prej saj janë bazuar në Udhëzimin e përbashkët MD dhe MF nr. 3165 datë 12.05.2004 "Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes, dhe tarifën e shpërblimit të përkthyesve të jashtëm, si dhe tarifën e përkthimit zyrtar që duhet të paguajnë të tretët" ndryshuar me udhëzimin e përbashkët botuar në fletoren zyrtare nr. 63/2005.

1. Evidentohet se, institucioni nuk disponon një mekanizëm të plotë dhe transparent për shpërndarjen e materialeve të përkthimit drejt përkthyesve të njohur prej saj duke bërë që një numër i kufizuar të kryej shërbimin në favor të kësaj ministrie por edhe prej tyre të ketë diferenca domethënëse në vlerat e përfituara, çka në situatën e një çmimi fiks të rregulluar "përkthehet" në më shumë punë e marrë. Kjo mënyrë ka krijuar pabarazi në këtë kategori profesioni ende "të parraegulluar".



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

2. Kontraktimi individual i përkthyesve të cilët megjithëse ushtrojnë veprimtari fitimprurëse nuk janë të regjistruar në organet fiskale siguron një trajtim të pabarabartë dhe diskriminues si dhe krijon një standard jo të përshtatshëm institucional. Nga përkthyesit e kontraktuar kategoria “Të regjistruar” janë pagues të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, tatimeve, TVSH apo Tatim i Thjeshtuar mbi Fitimin/ Tatim mbi Fitimin si dhe Taksa vendore ndërsa kategoria “Të paregjistruar” taksohet në mënyrë lineare me nivelin 15% Tatimit në Burim. Edhe nëse të parët do të kontribonin/paguanin në buxhetin e shtetit po aq në vlerë absolute, përsëri orjentimi tek kjo kategori do të ishte jo i duhur pasi në këtë mënyrë kjo vlerë shërbimi nuk do të ndihmonte zhvillimin dhe forcimin e profesionistëve të licencuar të cilët janë të lidhur drejtpërdrejtë me këtë veprimtari në të ardhurat e tyre, ndryshe nga kategoria tjetër të cilës i referohemi si të ardhura plotësuese, ndërkohë që mënyra aktuale e operimit lë pjesën e konsiderueshme të shërbimit tek kjo e fundit.

Në dispozitat ligjore aktuale për kryerjen e pagesave nga insitucionet publike ndeshemi vetëm me termin “operator ekonomik” referuar kjo Ligjit nr. Nr.9936, datë 26.6.2008 Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, (i ndryshuar), neni 52 “Kryerja e shpenzimeve”, ku sqarohet qartë mënyra si kryhet pagesa ndaj “operatorit ekonomik” dhe dokumenti përkatës për tu paraqitur për pagesë. Pra dokumenti bazë i cili rregullon, strukturën, parimet dhe bazat e procesit buxhetor, marrëdhëniet financiare mbi të cilat kryhet pagesa jep në mënyrë shteruese mënyrën e pagesës dhe definicionin e përfituesit. Gjithashtu mënyra e dakordësuar nga MD bie në kundërshtim edhe me parashikimet Ligjit nr. 9920 “Për Procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, neni 41 “Identifikimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare pa u regjistruar” pika 1 dhe 2 ku përcaktohet se,

1. Kur administrata tatimore identifikon persona, të cilët ushtrojnë veprimtari ekonomiko tregtare pa u regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, vendos masën e bllokimit të mallrave dhe detyron personin të regjistrohet menjëherë në Qendrën Kombëtare të Biznesit, si tatimpagues i tatimit mbi vlerën e shtuar. Masa e bllokimit hiqet pas kryerjes së regjistrimit për veprimtarinë ekonomike, duke aplikuar masat dhe dënimin, sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 121, të këtij ligji.

2. Në rast se një person ushtron veprimtari në fushën e shërbimeve, i pajisur me leje/licencë/autorizim profesional, por nuk e ka regjistruar veprimtarinë në QKB, (përveç sa është parashikuar në pikën 1, të këtij neni, për mallrat që disponon), administrata tatimore u propozon strukturave kompetente pezullimin e lejes/licencës/autorizimit për ushtrim veprimtarie për një periudhë gjashtëmujore.

Pra nëse organet tatimore do të evidentonin një rast të tillë pagese ato menjëherë duhet të merrnin masat mësipërme ndërkohë që në këtë rast ato duhet ti drejtoheshin hipotetakisht vet MD për këto masa. Pra shihet qartë se pagesa e drejtpërdrejtë ndaj individëve me dispozitat e mësipërme, por jo vetëm, gjendet e pambështetur ligjërisht.

3. Moment tjetër me rëndësi nga ana jonë lidhur me përkthimet e akteve evidentohet siguria mbi dokumentacionet e përkthyer nga operatorët e regjistruar dhe individët të cilët ndryshe nga subjektet e regjistruar janë më pak të shfaqur në aspekt të transparencës dhe veprimtarisë publike. Pavarësisht kësaj mungesa e një sistemi rregullator lidhur me marrjen në dorëzim të dokumentacionit, në vlerësimin e ka ekspozuar njësinë drejt risqeve të vazhdueshëm në këtë drejtim për të dy kategoritë e përkthyesve të kontraktuar.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

4. Aktet e mësipërm mbi të cilët bazohet veprimtaria e institucionit lidhur me përkthimet, përkatësisht udhëzimi i përbashkët nr. 3165 datë 12.05.2004 dhe udhëzimi i vitit 2005 për ndryshimin e tij, janë hartuar mbështetur në nenin 12 të ligjit nr.8678, datë 14.5.2001 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, ndërkohë që kjo dispozitë është shfuqizuar me ligjin nr.9694, datë 19.3.2007 pra rreth 12 (dymbëdhjetë) vite më parë.

Vlen të theksohet se, “Shërbimi i përkthimit” nuk disponon një bazë solide dhe të rregulluar me legjislacion specifik por në vijimësi ai është mbështetur në ligjin nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë” dhe udhëzimeve të përbashkëta midis MD dhe ish MF ku përcaktoheshin kriteret e përzgjedhjes për përkthyes të jashtëm dhe tarifat e shpërblimit të cilët do të kontrakttoheshin prej këtij institucioni. Pas ndryshimeve të vitit 2007 në ligjin organik të MD udhëzimi ndonëse me mungesë referimi të saktë ligjore është përdorur në vijimësi si bazë për njohjen e përkthyesve të rinj si dhe kontraktimin e plotë të trupës përkthyesë çdo vit. Ky shërbim nuk është ende një profesion i rregulluar pasi ai nuk përfshihet në, profesionet e parashikuara në Ligjin nr.10171, datë 22.10.2009 “Për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, apo profesioneve të përcaktuara me ligje të veçanta e si i tillë ai nuk gëzon ende bazën e tij rregullative, pavarësisht se “de facto” ky profesion është i kufizuar vetëm për emrat e listës vjetore të publikuar nga MD.

Pavarësisht detyrimit ligjor të Ministrisë së Drejtësisë për përkthimin e akteve në afate ligjore të përcaktuara, kryerja në mënyrë dinamike e këtij shërbimi brenda kornizave ligjore dhe administrative është gjithashtu një detyrim ligjor.

Për këtë çështje vlerësohet e nevojshme rishikimi i bazës ligjore në tërësi mbi “Shërbimin e Përkthimit” referuar ligjit organik të MD dhe akteve nënligjore të nevojshme referuar neni 5 pika 3 si dhe neni 52 pika 3, etj, të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

Po kështu nga ana e MD duhet të vlerësohet me kujdes plotësimi dhe rishikimi i kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së përkthyesve të jashtëm të kontraktuar çështje e cila nuk gëzon mbështetje ligjore dhe nevojitet të rishikohet duke u orjentuar drejt trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues të operatorëve ekonomikë si dhe duke adresuar risqet e nxjerrjes së informacionit që paraqiten gjatë procesit të përkthimit.

Titulli i Gjetjes nr. 1:	Përputhshmëria dhe rregullshmëria në përcaktimin dhe emërimin në pozicionin e Nëpunësit Autorizues (NA), pranë Institutit të Mjekësisë Ligjore.
Situata:	Nga auditimi i KLSH i cili po ushtrohet paralelisht edhe në Institutin e Mjekësisë Ligjore, institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, mbi bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit mbi realizmin e procedurave të prokurimit publik, në zbatim të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 56 (titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar), u konstatua se; <u>-Drejtuesi i institucionit z.Bledar Xhemali nuk gjendet në cilësinë e Nëpunësit Autorizues (NA) të institucionit, por në këtë cilësi është caktuar zj.Valbona Sulejmanllari me detyrë “Përgjegjës sektori në sektorin e menaxhimit të akteve dhe laboratorit”.</u> Kjo sipas shkresave të Ministrisë së Drejtësisë nr.5083 prot, datë 22.09.2017 dhe nr.12396/1 prot, datë 19.09.2017 nga Ministria e Financave me lëndë “Mbi caktimin e Nëpunësit Autorizues të Përkohshëm për IML” sipas



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

	<p>rrethanave faktike dhe juridike, si më poshtë vijon:</p> <p>-Evidentohet se, <u>B.Xhemali</u> gëzon statusin e nëpunësit civil, pasi ka filluar marrëdhënien e punës në këtë institucion, me aktin administrativ nr.5762/1 prot, datë 26.11.2013, të Ministrit, në pozicionin “<i>Drejtor i Institutit të Mjeksisë ligjore</i>” të cilin e ka mbajtur deri më datë 20.06.2017, deri në daljen e aktit administrativ nga ish-Ministri i Drejtësisë me shkresë nr.4052/3 datë 20.06.2017 “<i>Njoftim mbi fillimin e ecurisë disiplinore</i>”, shoqëruar me vendimin përfundimtar nr.4052/8 prot, datë 28.06.2017 “<i>Për marrjen e masës disiplinore “largim nga shërbimi civil” për z.Bledar Xhemali.</i>”</p> <p>Për sa më sipër, Z.Xhemali e ka ankimuar këtë vendim, <u>duke rifituar vendin e punës dhe rikthimi në detyrë në bazë të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë</u> nr.3462 datë 13.09.2017, me ekzekutim të përkohshëm, deri në momentin e vendimit të Gjykatës së Apelit Administrativ (është në proces ankimimi nga MD).</p> <p>Ka vonesë të zgjatura në lidhje me miratimin e nëpunësit autorizues (NA) nga Ministria e Drejtësisë në koordinim me Ministrinë e Financave, pasi sipas situatës së mësipërme ky vendim është marrë i mirëqënë dhe si rrjedhojë me ardhjen në detyrë të z.Bledar Xhemali (Drejtor IML) duhet që t’i kalonin dhe detyrat e NA që janë të përcaktuara në bazë të ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar neni 19, ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar neni 12, për rrjedhojë dhe ushtrimin e kompetencave në fushën e prokurimeve publike në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 56 (titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar).</p> <p>Gjithashtu, rezultoi se, nga Ministria e Drejtësisë, nuk është bërë ende kërkesë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për ndryshimin e Nëpunësit Autorizues të Përkohshëm, ndonëse nga IML me shkresat nr1616 prot datë 21.09.2018 dhe nr.1855 prot datë 09.03.2019, është kërkuar ndryshimi respektiv për caktimin e titullarit të institucionit në pozicionin e nëpunësit autorizues.</p>
Kriteri:	Ligji nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar neni 19, ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar neni 12, për rrjedhojë dhe ushtrimin e kompetencave në fushën e prokurimeve publike në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 56 (titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar).
Ndikimi/Efekti:	Pozicioni dhe realizimi i disa prej funksioneve të Drejtorit të IML, kufizohen për shkak –pasojë të mospasjes së cilësisë së pozicionit të Nëpunësit Autorizues (NA), kjo në kundërshtim të ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar neni 19, ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar neni 12, për rrjedhojë dhe ushtrimin e kompetencave në fushën e prokurimeve publike në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 56 (titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar).
Shkaku:	Vonesë të zgjatur në lidhje me miratimin e nëpunësit autorizues (NA) nga Ministria e Drejtësisë në koordinim me Ministrinë e Financave, pasi sipas situatës së mësipërme ky vendim është marrë i mirëqënë dhe si rrjedhojë me ardhjen në detyrë të z.Bledar Xhemali (Drejtor IML) duhet që t’i kalonin dhe detyrat e NA që janë të përcaktuara në bazë të ligjit
Rëndësia:	E lartë



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Titulli i Gjetjes nr. 2:	Mbi përkthimin ligjor dhe parregullsitë e evidentuara në këtë shërbim.
Situata:	<p>Nga auditimi mbi pagesat e kryera nga Ministria e Drejtësisë gjatë periudhës Janar-Shtator 2019 rezultoi se, gjatë kësaj periudhe janë kryer pagesa për përkthyesit e njohur nga kjo ministri në listat zyrtare të publikura të cilët sipas të dhënave të institucionit ishin të pa regjistruar në organet tatimore dhe ndaj tyre është mbajtur tatim në burim në masën prej 15 përqind të vlerës së shërbimit, i cili më pas është paguar nga MD në buxhetin e shtetit në shumën 8,812,236 lekë .</p> <p>Vlera totale e shërbimit të kryer nga kjo kategori përkthyesish është 58,748,240 lekë (8,812,236/15%) ose rreth ¼ e shpenzimeve 9 mujore.</p> <p>-Po si dhe nga kush kryhet shërbimi i përkthimit të akteve.</p> <p>Në Ministrinë e Drejtësisë përkthimi i materialeve të cilat dërgohen drejt institucioneve homologe apo anasjelltas kryhen aktualisht nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none">-përkthyesve të punësuar pranë institucionit-përkthyesve të njohur të listës të regjistruar pranë organeve tatimore-përkthyesve të njohur të listës të pa regjistruar pranë organeve tatimore <p>Kategoritë e mësipërme janë të evidentuara në listën e përkthyesve të njohur dhe përkthejnë materiale të karakterit administrativ por dhe dokumente të cilat klasifikohen sipas ligjit Nr.8457, datë 11.2.1999 Për Informacionin e Klasifikuar "Sekret Shtetëror" për të cilat MD ka publikuar emrat përkatës të përkthyesve që zotërojnë çertifikatë sigurie. Të dy grupet e përkthyesve janë të publikuara nga kjo ministri në faqen e saj zyrtare. Vlerat e përkthimit të paguara prej saj janë bazuar në Udhëzimin e përbashkët MD dhe MF nr. 3165 datë 12.05.2004 "Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes, dhe tarifat e shpërblimit të përkthyesve të jashtëm, si dhe tarifat e përkthimit zyrtar që duhet të paguajnë të tretët" ndryshuar me udhëzimin e përbashkët botuar në fletoren zyrtare nr. 63/2005.</p> <p>a. Evidentohet se, institucioni nuk disponon një mekanizëm të plotë dhe transparent për shpërndarjen e materialeve të përkthimit drejt përkthyesve të njohur prej saj duke bërë që një numër i kufizuar të kryej shërbimin në favor të kësaj ministrie por edhe prej tyre të ketë diferencë domethënëse në vlerat e përfituara, çka në situatën e një çmimi fiks të rregulluar "përkthehet" në më shumë punë e marrë. Kjo mënyrë ka krijuar pabarazi në këtë kategori profesioni ende "të parraegulluar".</p> <p>b. Kontraktimi individual i përkthyesve të cilët megjithëse ushtrojnë veprimtari fitimprurëse nuk janë të regjistruar në organet fiskale siguron një trajtim të pabarabartë dhe diskriminues si dhe krijon një standard jo të përshtatshëm institucional. Nga përkthyesit e kontraktuar kategoria "Të regjistruar" janë pagues të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, tatimeve, TVSH apo Tatim i Thjeshtuar mbi Fitimin/ Tatim mbi Fitimin si dhe Taksa vendore ndërsa kategoria "Të paregjistruar" taksohet në mënyrë lineare me nivelin 15% Tatimit në Burim. Edhe nëse të parët do të kontribonin/paguanin në buxhetin e shtetit po aq në vlerë absolute, përsëri orjentimi tek kjo kategori do të ishte jo i duhur pasi në këtë mënyrë kjo vlerë shërbimi nuk do të ndihmonte zhvillimin dhe forcimin e profesionistëve të licencuar të cilët janë të lidhur drejtpërdrejtë me këtë veprimtari në të ardhurat e tyre, ndryshe nga kategoria tjetër të cilës i referohemi si të ardhura plotësuese, ndërkohë që mënyra aktuale e operimit lë pjesën e konsiderueshme të shërbimit tek kjo e fundit.</p> <p>Në dispozitat ligjore aktuale për kryerjen e pagesave nga insitucionet publike ndeshemi vetëm me termin "operator ekonomik" referuar kjo Ligjit nr. Nr.9936, datë 26.6.2008 Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, (i ndryshuar), neni 52 "Kryerja e shpenzimeve", ku sqarohet qartë mënyra si kryhet pagesa ndaj "operatorit ekonomik" dhe dokumenti përkatës për tu paraqitur për pagesë. Pra dokumenti bazë i cili rregullon, strukturën, parimet dhe bazat e</p>



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në "MINISTRINË E DREJTËSISË"

	<p>procesit buxhetor, marrëdhëniet financiare mbi të cilat kryhet pagesa jep në mënyrë shteruese mënyrën e pagesës dhe definicionin e përfituesit. Gjithashtu mënyra e dakordësuar nga MD bie në kundërshtim edhe me parashikimet Ligjit nr. 9920 "Për Procedurat tatimore në RSH", i ndryshuar, neni 41 "Identifikimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare pa u regjistruar", pika 1 dhe 2.</p> <p>Pra nëse organet tatimore do të evidentonin një rast të tillë pagese ato menjëherë duhet të merrnin masat mësipërme ndërkohë që në këtë rast ato duhet ti drejtoheshin hipotetikut vet MD për këto masa. Pra shihet qartë se pagesa e drejtpërdrejtë ndaj individëve me dispozitat e mësipërme, por jo vetëm, paraqesiten të kundërta mes tyre.</p> <p>c. Moment tjetër me rëndësi nga ana jonë lidhur me përkthimet e akteve evidentohet siguria mbi dokumentacionet e përkthyer nga operatorët e regjistruar dhe individët të cilët ndryshe nga subjektet e regjistruar janë më pak të shfaqur në aspekt të transparencës dhe veprimtarisë publike. Pavarësisht kësaj mungesa e një sistemi rregullator lidhur me marrjen në dorëzim të dokumentacionit, në vlerësimin e ka ekspozuar njësinë drejt risqeve të vazhdueshëm në këtë drejtim për të dy kategoritë e përkthyesve të kontraktuar.</p>
Kriteri:	<p>-Ligji nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar neni 19, ligji nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar.</p> <p>-Ligji nr. 9920 "Për Procedurat tatimore në RSH", i ndryshuar, neni 41 "Identifikimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare pa u regjistruar", pika 1 dhe 2.</p> <p>-Udhëzimi ipërbashkët MD dhe MF nr. 3165 datë 12.05.2004 "Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes, dhe tarifat e shpërblimit të përkthyesve të jashtëm, si dhe tarifat e përkthimit zyrtar që duhet të paguajnë të tretët" ndryshuar me udhëzimin e përbashkët botuar në fletoren zyrtare nr. 63/2005.</p>
Ndikimi/Efekti:	Dëmtim i konkurrencës midis operatorëve ekonomikë
Shkaku:	Mosplotësim për një kohë të gjatë i bazës ligjore mbi këtë profesion
Rëndësia:	E lartë

❖ Të tjera:

Në KLSH është paraqitur ankesa me nr. 953 prot, datë 21.11.2019, në të cilën ngrihen problematika të cilat lidhen kryesisht me menaxhimin financiar të institucionit dhe procesin e rekrutimit të personelit, por jo vetëm. Meqenëse çështjet e ngritura i përkasin kryesisht periudhave jashtë auditimit, si dhe nevojës për një hetim administrativ të detajuar dhe shumëplanësh, Kontrolli i Lartë i Shtetit, vlerëson të dërgojë pranë Drejtorisë së Inspektimit Financiar në MFE, një kopje të ankesës së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit të mbajtur për Ministrinë e Drejtësisë, për të trajtuar me objektivitet dhe profesionalizëm të gjitha çështjet e ngritura në këtë ankesë.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në "MINISTRINË E DREJTËSISË"

V. KONKLUZIONE

- Institucioni ka funksionuar për një kohë të gjatë në mungesë të një rregullore e cila të përshtatet me strukturën e tij organizative. Pavarësisht deklarimeve pranë DAP, institucioni vijon me një numër të lartë vendesh pune vakantë, mes të cilëve evidentohen edhe nivel drejtues.
- Evidentohen mangësi në procesin e blerjes së biletave për takime/vente ndërkombëtare dhe nuk arrin të argumentohet qartë nevoja e numrit të pjesëmarrësve në to.
- Drejtoria e Auditimit të Brendshëm paraqitet thuhajse "amorfe" sa i përket numrit të personelit por edhe duke mos përmbushur rolin e saj, si "garant" për funksionimin e sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit.
- Nuk arrin të zgjidhen në kohë problematikat e shfaqura në institucionet e varësisë si në rastin e Nëpunësit Autorizues për Institutit të Mjekësisë Ligjore.
- Mungon një bazë e konsoliduar rregulluese mbi profesionin e përkthyesit zyrtar, si për procedurat konkurruese për njohjen e tyre ashtu edhe për kontraktimin nga ana e MD-së, për përkthimet e akteve të saj.
- Përkthimet pavarësisht karakterit sekret/jo sekret janë kryer është nga individë të njohur nga MD por të paregjistruar në organet fiskale, çka sjell konkurrencë të padrejtë drejt operatorëve ekonomikë, por në mungesë të akteve rregullues, kjo veprimtari krijon risk të lartë mbi informacionet e klasifikuara.
- Megjithëse dy sisteme IT fizikisht janë alokuar tek AKSHI, ato ende vijojnë të reflektohen në regjistrin e aktiveve të Ministrisë e cila vijon të paguajë pa të drejtë nga buxheti i vetë, shpenzimet e mirëmbajtjes për to.
- Evidentohen procedura të paplota për transferimin e sistemeve IT duke riskuar kryerjen transferimit sipas detyrimeve ligjore.
- Mungon zbatimi i plotë i dispozitave ligjore që rregullojnë proceset e punës në fushën e MFK-së etj.

A. OPINIONI I AUDITIMIT

-Nga auditimi mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Ministrisë së Drejtësisë, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat ky institucion realizon misionin e tij, (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), janë konstatuar disa mangësi dhe parregullsi. Gjatë auditimit në terren janë të marrë të dhëna të mjaftueshme të cilat mundësojnë dhënien e opinionit.

Opinion i kualifikuar mbi përputhshmërinë

Sipas opinionit të KLSH-së, nga auditimi i përputhshmërisë, i mbështetur në ligjin nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin Ministria e Drejtësisë, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat në gjykimin profesional të audituesit shtetëror të pavarur janë materiale por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e *një opinionit të kualifikuar të përputhshmërisë*.

Baza për opinionin e kualifikuar (ISSAI 4000)

Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs), ISSAI-n 4000 "Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë". Ne jemi të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

pavarur kundrejt subjektit të audituar, mbështetur në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë të ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut dhe materialitetit për subjektin e audituar.

Nga evidencat e marra për veprimtarinë e Ministrisë së Drejtësisë rezultoi se:

Struktura e auditimit të brendshëm paraqitet thujse inekzistente dhe me mangësi personeli të tejzgjatura . Mungon baza ligjore e rregullative për shërbimin e përkthimit dhe prej një kohe të gjatë ka vijuar pagesa e përkthyesve të njohur, të paregjistruar në organet tatimore, e cila krijuar një situatë të disfavorshme dhe jokonkurrese për operatorët ekonomikë të licensuar. Mungon argumentimi, mbi caktimin e numrit të personelit për udhëtimet jashtë vendit si dhe në procedurat e blerjes së biletave në një afat të ngushtë kohor nga dita e nisjes. Transferimi i sistemeve IT, mbetet i përfunduar megjithëse institucioni vazhdon të paguaj nga buxheti i vetë, vlera financiare për mirëmbajtjen e tyre. Nuk arrijnë të zgjidhen në kohë problematikat e shfaqura në institucionet e varësisë. Institucioni vijon funksionimin në mungesë të një rregullore të përshtatur me strukturën e tij organizative. Mungon zbatimi i plotë i dispozitave ligjore që rregullojnë proceset e punës në fushën e MFK-së etj. Mangësitë dhe të metat e mësipërme evidentojnë dobësi në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar të institucionit.

Ne arritëm në konkluzionin se, problematikat e konstatuara kanë ekspozuar institucionin drejt risqeve për përmbushjen e detyrimeve, në zbatim të ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë së tij .

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si *më poshtë*:

B. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1- **Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se, shërbimi i përkthimit zyrtar nuk dispononte ende një bazë ligjore të plotë e cila të rregullonte këtë shërbim, kjo sa i përket procedurave të njohjes si përkthyes, licensimin e tyre, si dhe gjithë aspekteve të nevojshme për një profesion i cili nuk mund të kryhet nga çdokush që njeh një gjuhë të huaj. Ky shërbim në dispozitat ligjore aktuale nuk është klasifikuar ende si një profesion i rregulluar dhe ai nuk përfshihet në, profesionet e parashikuara në ligjin nr. 10171, datë 22.10.2009 “Për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, apo në profesionet e përcaktuara me ligje të veçanta e si i tillë ai nuk gëzon ende bazën e tij rregullative, pavarësisht se “*de facto*” shërbimi i përkthimit zyrtar mbetet administrativisht i kufizuar, vetëm për personat emrat e të cilëve publikohen nga Ministria e Drejtësisë çdo vit në faqen e saj zyrtare. Në vijimësi, Ministria e Drejtësisë ka thirrur konkurrenca për njohje/kontraktim referuar udhëzimeve të përbashkëta të hartuara midis Ministrisë së Drejtësisë dhe ish Ministrisë së Financave të cilët përcaktonin kriteret e përzgjedhjes për përkthyes të jashtëm dhe tarifat e shërbimit për ata që do të kontrakttoheshin nga Ministria e Drejtësisë. Për këtë procedurë institucioni i është referuar Udhëzimit të përbashkët nr. 3165 datë 12.05.2004, i ndryshuar, për njohjen e përkthyesve dhe kontraktimin e tyre, udhëzim i cili në pjesën hyrëse ku trajtohet mbështetja e tij ligjore, i referohet nenit 12 të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, dispozitë kjo e shfuqizuar rreth 12 (dymbëdhjetë) vite më parë, e megjithatë ai



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

është përdorur në vijimësi si bazë për njohjen e përkthyesve të rinj si dhe kontraktimin e plotë të trupës përkthyesve çdo vit. Pra edhe pa një bazë ligjore të dedikuar për përfitimin e titullit “përkthyes zyrtar” institucioni ka vijuar konkurrimet dhe kontraktimet.

Problematikë shfaqet edhe në aspektin e ndarjes së drejtë të punës tek përkthyesit e listës me të cilët është lidhur kontrata vjetore, si dhe risqet e mundshme për përkthimin e materialeve me rëndësi të veçantë, apo të dokumenteve të klasifikuar. Pavarësisht detyrimit ligjor të Ministrisë së Drejtësisë për përkthimin e akteve në afate ligjore të përcaktuara, kryerja në mënyrë dinamike e këtij shërbimi brenda kornizave ligjore dhe administrative është gjithashtu një detyrim ligjor dhe përzgjedhja subjektive e përkthyesve nuk legjitimohet nga kërkesat e ngutshme për përkthime nga ana e saj. Problematikat e përmendura më sipër evidentojnë nevojën për një rregullim të ri ligjor mbi profesionin e “Përkthyesit zyrtar” duke iu referuar ligjit organik të MD, ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 5 pika 3, neni 52 pika 3, etj. Nevojë për rregullim paraqet edhe procesi i përzgjedhjes së përkthyesve të jashtëm për shërbimet e kërkuara nga ana e ministrisë, duke u orientuar drejt trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues në përzgjedhje, si dhe reduktimin e riskut në nxjerrjen e informacionit të klasifikuar gjatë procesit të përkthimit. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 63-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

1.1 Rekomandimi: Ministria e Drejtësisë, të ndërmarrë nismat e nevojshme administrative e ligjore për plotësimin e kuadrit ligjor për “Përkthyesin zyrtar”, për të garantuar profesionistë mbi bazën e meritokracisë, shërbime përkthimi sa më cilësore dhe një veprimtari të rregulluar nga akte ligjore të mirëpërcaktuara.

Brenda datës 29.02.2020

1.2 Rekomandimi: Ministria e Drejtësisë, të plotësoj gjithashtu bazën ligjore mbi procedurat e përzgjedhjes dhe kontraktimit të përkthyesve të jashtëm, duke u orientuar drejt trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues të operatorëve ekonomikë si dhe duke treguar vëmendje të veçantë në reduktimin e riskut të mundshëm për rrjedhjen e informacionit të klasifikuar gjatë procesit të përkthimit.

Brenda datës 29.02.2020

C. MASA ORGANIZATIVE

1- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Drejtësisë rezultoi se,

a. Kjo njësi auditimi referuar strukturës organizative të miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 238 datë 13.12.2017 është e organizuar në nivel drejtorie dhe ka të parashikuar një staf prej pesë punonjësish (1+4), Drejtorin dhe 4 specialistë. Prej muajit Dhjetor 2017 pozicioni i drejtuesit të kësaj njësie rezulton vakant duke krijuar një boshllëk në drejtimin e saj. Me Urdhrin nr. 2969 datë 12.03.2018 të Ministrit të Drejtësisë, një specialist i kësaj drejtorie është caktuar për kryerjen e detyrave të Drejtorit në DAB deri në emërimin e drejtuesit të përhershëm. Drejtuesi i komanduar e ka ushtruar funksionin deri në marrjen e masës së pezullimit ndaj tij në muajin Tetor 2019. Aktualisht kjo drejtori megjithëse ka si objekt auditimi aparatit e MD-së dhe rreth 34 institucione varësie, funksionon vetëm me dy auditues, nga të cilët një auditues është emëruar në këtë funksion më datë 23.08.2019 dhe ndodhet në periudhë prove. Kjo përbërje, krijon risk të lartë për drejtimin, sai përket



KONTROLLI I LARTË I SHETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në "MINISTRINË E DREJTËSISË"

funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë e varësisë, por dhe vetë Ministrinë e Drejtësisë.

b. Sipas të dhënave rezultoi se, DAB ka hartuar planin vjetor të auditimit për vitin 2019 dërguar Drejtorisë së Harmonizimit Financiar në të cilin parashikohet të realizohen 12 auditime nga 17 të tillë të parashikuar në planin strategjik 2018-2020, pra me 5 (pesë) auditime më pak. Për periudhën nën auditim Janar-Tetor 2019 janë zhvilluar 7 (shtatë) angazhime auditimi nga të cilat, 3 (tre auditime) janë auditime të paplanifikuara në planin vjetor dhe vetëm 4 (katër) janë pjesë e planit. Nga angazhimet e zhvilluara gjithsej, në 3 (tre) auditime ka përfunduar angazhimi, në 2 (dy) auditime është hartuar raporti paraprak dhe në 2 (dy) raste auditimi ndodhet në proces. Në materialet e paraqitura nuk gjenden shpjegime lidhur me devijimet në planin vjetor dhe shtimin e tre auditimeve të reja. Gjithashtu ndryshimet e planit nuk rezultojnë të jenë miratuar prej Komitetit të Auditimit të Brendshëm referuar VKM nr. 114 datë , Kreu III. pikës 1/b të tij.

c. Në planin vjetor të auditimeve për vitin 2020 nuk rezultojnë të jenë përfshirë auditimet të cilat nuk mund të realizohen gjatë vitit 2019 të cilat aktualisht janë 8 (tetë) të tillë. Nga të gjitha hallkat përgjegjëse, për hartimin, monitorimin si dhe miratimin e planit vjetor mungojnë shpjegimet lidhur me spostimin/anashkalimin e subjekteve të parashikuara për auditim gjatë vitit 2019 por të përcaktueshëm në kushtet aktuale. Mospërfshirja e tyre në planin e ardhshëm si auditime të përcaktuara, shkaktohet vijueshmërinë dhe ul besueshmërinë për hartimin e një plani bazuar në një vlerësim objektiv të riskut për vitin në vijim.

Për periudhën nën auditim Janar-Tetor 2019, nëse do të shohim veprimtarinë audituese në harkun kohor do të shohim se, ajo zë vetëm një pjesë të shkurtër kohore përgjatë periudhës dhe mbulimi me auditim nuk ka qenë i plotë duke sjellë mosezaurim të planit vjetor të parashikuar.

d. Në angazhimet e kryera gjatë periudhës nën auditim rezultoi se, thuajse në të gjitha rastet njësitë që do të auditohen nuk është njoftuar 10 ditë përpara si dhe në dosje nuk gjendet argumentim lidhur me këtë mungesë si përcaktohet në pikën 4.1.4 të Manualit të Auditimit të Brendshëm/2016.

Në planin e auditimit për vitin 2019 por dhe planin strategjik 2018-2020 dhe 2019-2021 nuk parashikohen auditime tematike për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna drejt subjekteve të audituar.

Mungesa e veprimeve aktive për zbatimin e rekomandimeve në një kohë të shpejtë nuk i lejon manaxhimin të lartë mundësi të informohet mbi masat e marra nga subjekti i audituar, çka mund të ndikojë në ngadalësimin e zbatimit apo mosezaurim të tyre.

Në programet e auditimit përfshihet si drejtim i veçantë auditimi dhe Teknologjia e Informacionit, megjithëse specialistët në grupet e auditimit nuk janë të diplomuar apo të kenë formim profesional të nevojshëm për këtë fushë auditimi referuar pikës 2.4.4 të Manualit të Auditimit/2016. Auditimi për këtë fushë mjaftohet me verifikime sipërfaqësore dhe nuk jep siguri mbi sistemet e audituara.

Stafi i paplotësuar gjatë periudhës nën auditim, tkurrja e numrit të auditimeve gjithsej, përzgjedhja tematike, shpërndarja disproporcionale sipas periudhave, të programeve të auditimit, si dhe afatet e shkurtra për përmbushjen e tyre, nuk krijojnë siguri të arsyeshme për përmbushjen e plotë dhe me cilësisë të objektivit të kësaj strukture për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë e sektorit publik.
Trajtuar më hollësisht në faqet nr 46-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

1.1 Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, të merren masa, për plotësimin e vendeve vakantë në strukturën e miratuar në nivel specialisti dhe Drejtuesi si dhe të ndërmerren hapat e nevojshëm administrativë dhe ligjorë për zgjerimin e kësaj strukture, me qëllim garantimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe evidentimin e rasteve të keqpërdorimit të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike.

Menjëherë

1.2 Rekomandimi: Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të rishikoj planin vjetor për vitin 2020 duke përfshirë në të edhe subjektet të cilat nuk janë audituar prej saj gjatë vitit 2019. Plani i rishikuar, pas mendimit të Komitetit të Auditimit dhe miratimit nga Titullari i Institucionit, të paraqitet rregullisht pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit në MFE me shpjegimet përkatëse.

Menjëherë dhe në vijimësi

1.3 Rekomandimi: Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të programoj auditime të plota, brenda afateve të arsyeshme, dhe të shtrirë në gjithë periudhën vjetore, duke respektuar rigorozisht periudhën e njoftimit si dhe të gjitha hapat e tjerë të hartimit, miratimit dhe dërgimit të raporteve përkatës drejt subjektit të audituar, duke mos krijuar tejkalime afatesh procedural të cilët krijojnë risk të lartë në veprimtarinë e kësaj njësie.

Në vijimësi

2- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, në raportin Përfundimtar të Auditimit të mbajtur nga DAB të Ministrisë së Drejtësisë pranë Drejtorisë së Përmbarrimit Tiranë, janë evidentuar të ardhura të realizuara të pa derdhura në buxhetin e shtetit konkretisht, të ardhurat e krijuara për vitin 2017 dhe 10/mujorin e vitit 2018 e cila përbëhet nga gjoba gjyqësore, të ardhura nga interesi, tarifë ekzekutimi në shumën 45,431,414 lekë, nuk janë administruar konform Ligjit nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, nenit 6 “Transferimi i të ardhurave nga taksat kombëtare në Buxhetin e Shtetit”, neni 11 “Tarifa shërbimi”, 11/2 “Deklarata për pagesën e tarifave kombëtare” dhe këto të ardhura të krijuara në vite nuk janë derdhur në Buxhetin e Shtetit brenda 15 ditëve nga përfundimi i muajit në të cilin është kryer arkëtimi, si parashikohet në legjislacionin përkatës, por janë lënë në llogarinë përmbarrimore pranë bankave të niveleve të dyta, megjithëse kuadri ligjor ka qenë i plotë për transferimin e tyre në Buxhetin e Shtetit. Po kështu zëri “Të tjera” në këtë llogari, në shumën 32,511,553 lekë, nuk është sistemuar sipas dosjeve në ekzekutim (debitorëve) në mënyrë analitike. Nga ana e DAB janë rekomanduar masat përkatëse drejtuar kësaj njësie për përmirësimin e gjendjes por nuk janë marrë masa për shtrirjen e rekomandimit në sistem, pasi fenomeni mund të paraqitet i shtrirë edhe në subjekte të tjerë të kësaj natyre. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 46-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të dërgoj një kopje të raportit të Auditimit të mbajtur pranë Drejtorisë së Përmbarrimit Tiranë në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarrimit dhe të kërkoj, ndjekjen nga ana e saj të problematikës së degëve nëpërmjet nxjerrjes së shkresave njoftuese/qarkoreve lidhur me “Llogarinë Përmbarrimore”, me theks të veçantë derdhjen në buxhet të të ardhurave përmbarrimore (tarifë/gjobë/interesa) si dhe sistemimin e zërit “Të tjera” në këtë llogari.

Brenda datës 31.01.2020

3- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i KLSH i cili u krye paralelisht edhe në Institutin e Mjekësisë Ligjore, institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, mbi bazë të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit mbi realizimin e procedurave të prokurimit publik, në zbatim të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 56 (titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar), rezultoi se;

-Drejtuksi i institucionit z. Bledar Xhemali nuk gjendet në cilësinë e Nëpunësit Autorizues (NA) të institucionit, por në këtë cilësi është caktuar zj. Valbona Sulejmanllari me detyrë “Përgjegjës sektori në sektorin e menaxhimit të akteve dhe laboratorit”. Kjo sipas shkresave të Ministrisë së Drejtësisë nr. 5083 prot, datë 22.09.2017 dhe nr. 12396/1 prot, datë 19.09.2017 nga Ministria e Financave me lëndë “Mbi caktimin e Nëpunësit Autorizues të Përkohshëm për IML” sipas rrethanave faktike dhe juridike, si më poshtë vijon:

-Evidentohet se, B.Xhemali gëzon statusin e nëpunësit civil, pasi ka filluar marrëdhënien e punës në këtë institucion, me aktin administrativ nr. 5762/1 prot, datë 26.11.2013, të Ministrit, në pozicionin “Drejtor i Institutit të Mjeksisë ligjore” të cilin e ka mbajtur deri më datë 20.06.2017, deri në daljen e aktit administrativ nga ish-Ministri i Drejtësisë me shkresë nr. 4052/3 datë 20.06.2017 “Njoftim mbi fillimin e ecurisë disiplinore”, shoqëruar me vendimin përfundimtar nr. 4052/8 prot, datë 28.06.2017 “Për marrjen e masës disiplinore “largim nga shërbimi civil” për z.Bledar Xhemali.”

Për sa më sipër, Z.Xhemali e ka ankimuar këtë vendim, duke rifituar vendin e punës dhe rikthimi në detyrë në bazë të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nr. 3462 datë 13.09.2017, me ekzekutim të përkohshëm, deri në daljen e vendimit të Gjykatës së Apelit Administrativ (vendimi është në proces ankimi nga MD).

Evidentohet vonesë në lidhje me miratimin e nëpunësit autorizues (NA) nga Ministria e Drejtësisë në koordinim me Ministrinë e Financave, pasi referuar situatës së trajtuar më sipër ky vendim është marrë i mirëqenë dhe si rrjedhojë me ardhjen në detyrë të z. Bledar Xhemali (Drejtor IML) duhet që t'i kalonin dhe detyrat e NA që janë të përcaktuara në bazë të ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar neni 19, ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar neni 12, për rrjedhojë dhe ushtrimin e kompetencave në fushën e prokurimeve publike në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 56 (titullari i autoritetit kontraktor ose zyrtari i autorizuar).

Gjithashtu, rezultoi se, nga Ministria e Drejtësisë, nuk është bërë ende kërkesë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për ndryshimin e Nëpunësit Autorizues të Përkohshëm, ndonëse nga IML me shkresat nr. 1616 prot, datë 21.09.2018 dhe nr. 1855 prot, datë 09.03.2019, është kërkuar ndryshimi respektiv për caktimin e titullarit të institucionit në pozicionin e nëpunësit autorizues. Trajtuar më hollësisht në faqet nr 63-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

3.1 Rekomandimi: Nga Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të merren masa për emërimin dhe realizimin e ndryshimit të Nëpunësit Autorizues të Përkohshëm, referuar shkresës së IML me nr. 1616 prot, datë 21.09.2018 dhe nr. 1855 prot datë 09.03.2019, me të cilat është kërkuar ndryshimi respektiv, për caktimin e titullarit të institucionit z. Bledar Xhemali në pozicionin e nëpunësit autorizues.

Menjëherë

4- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, për periudhën Janar -Shtator 2019 u evidentuan mospërputhje midis vlerës totale të Fondit të Pagave Bruto dhe Listëpagesave



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

mujore. Sipas librit të pagave Fondi Bruto paraqitej në shumën 98,107,476 lekë, ndërsa pasqyrimi në listëpagesën mujore të deklaruar pranë organeve tatimore ishte paraqitur në shumën 98,582,444 lekë me një ndryshim në (+474,968 lekë).

Po kështu vlera e pagave neto të punonjësve për këtë periudhë sipas librit të pagave paraqitej në shumën 76,392,807 lekë, ndërsa llogaritja e pagës neto pas ndalesave të punëmarrësit sipas listëpagesës mujore të deklaruar pranë organeve tatimore llogaritej në shumën 76,861,999 lekë, me një ndryshim në (+469,192 lekë). Diferencat e evidentuara midis dy dokumenteve nuk janë të argumentuara dhe përbëjnë një pasqyrim jo të saktë të treguesve, librit të pagës dhe listëpagesës mujore të deklaruar. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 32-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

4.1 Rekomandimi: Ministria e Drejtësisë, të marri masat e nevojshme për kontabilizimin e saktë të pagave dhe kontributeve në sistemin informatik për periudhën Janar-Shtator 2019 dhe kuadrimin e vlerave midis librit të pagave dhe listëpagesave mujore.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi pagesat e kryera nga Ministria e Drejtësisë gjatë periudhës Janar-Shtator 2019, rezultoi se, gjatë kësaj periudhe janë kryer pagesa për përkthyesit e njohur nga kjo ministri në listat zyrtare të publikura të cilët sipas të dhënave të institucionit ishin të pa regjistruar në organet tatimore dhe ndaj tyre është mbajtur tatim në burim në masën prej 15 përqind të vlerës së shërbimit, i cili më pas është paguar nga MD në buxhetin e shtetit në shumën 8,812,236 lekë. Me këtë mënyrë veprimi institucion vijonte prej vitesh.

Vlera totale e shërbimit të kryer nga kjo kategori përkthyesish është **58,748,240 lekë** (8,812,236/15%) ose rreth ¼ e shpenzimeve 9 mujore. Vlerat e përkthimit të paguara prej saj janë bazuar në Udhëzimin e përbashkët MD dhe MF nr. 3165 datë 12.05.2004 “Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes, dhe tarifat e shpërblimit të përkthyesve të jashtëm, si dhe tarifat e përkthimit zyrtar që duhet të paguajnë të tretët” ndryshuar me udhëzimin e përbashkët botuar në fletoren zyrtare nr. 63/2005.

Në Ministrinë e Drejtësisë përkthimi i materialeve të cilat dërgohen drejt institucioneve homologe apo anasjelltas kryhen aktualisht nëpërmjet:

- ✓ përkthyesve të punësuar pranë institucionit
- ✓ përkthyesve të njohur të listës të regjistruar pranë organeve tatimore
- ✓ përkthyesve të njohur të listës të pa regjistruar pranë organeve tatimore

a. Evidentohet se, institucioni nuk disponon një mekanizëm të plotë dhe transparent për shpërndarjen e materialeve të përkthimit drejt përkthyesve të njohur prej saj duke bërë që një numër i kufizuar përkthyesish të kryejnë shërbimin në favor të kësaj ministrie por edhe prej tyre të ketë diferenca domethënëse në vlerat e përfutuara, çka në situatën e një çmimi fiks të rregulluar “përkthehet” në më shumë punë e marrë. Kjo mënyrë ka krijuar pabarazi në këtë kategori profesioni ende “të parregulluar”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

b. Kontraktimi individual i përkthyesve të cilët megjithëse ushtrojnë veprimtari fitimprurëse nuk janë të regjistruar në organet fiskale siguron një trajtim të pabarabartë dhe diskriminues si dhe krijon një standard jo të përshtatshëm institucional. Nga përkthyesit e kontraktuar kategoria “Të regjistruar” janë pagues të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, tatimeve, TVSH apo Tatim i Thjeshtuar mbi Fitimin/ Tatim mbi Fitimin si dhe Taksa vendore ndërsa kategoria “Të paregjistruar” taksohet në mënyrë lineare me nivelin 15% Tatimit në Burim. Edhe nëse të licensuarit do të kontribuonin/paguanin në buxhetin e shtetit njëllor në vlerë absolute, përsëri orientimi tek kategoria e të paregjistruarve, do të ishte e padrejtë, pasi në këtë mënyrë kjo vlerë shërbimi nuk do të ndihmonte zhvillimin dhe forcimin e profesionistëve të licensuar të cilët janë të lidhur drejtpërdrejtë me këtë veprimtari në të ardhurat e tyre, ndryshe nga kategoria tjetër të ardhurat e të cilës u referohemi si të ardhura plotësuese. Aktualisht mënyra e veprimit nga ana e institucionit lë pjesën e konsiderueshme të shërbimit/të ardhurave tek kategoria e dytë e përkthyesve, pra atyre të paregjistruar.

Në dispozitat ligjore aktuale për kryerjen e pagesave nga insitucionet publike ndeshemi vetëm me termin “operator ekonomik” referuar ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 52 “Kryerja e shpenzimeve”, ku sqarohet qartë mënyra si kryhet pagesa ndaj “operatorit ekonomik” dhe dokumenti përkatës për tu paraqitur për pagesë. Pra dokumenti bazë i cili rregullon, strukturën, parimet dhe bazat e procesit buxhetor, marrëdhëniet financiare mbi të cilat kryhet pagesa, jep në mënyrë shteruese mënyrën e pagesës dhe definicionin e “përfituesit”. Gjithashtu mënyra e dakordësuar nga MD bie në kundërshtim edhe me parashikimet ligjit nr. 9920 “Për Procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, neni 41 “Identifikimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare pa u regjistruar”, pika 1 dhe 2 e tij. Nëse organet tatimore do të evidentonin raste pagesash për përkthyes të paregjistruar, ato menjëherë duhet të marrin masat e parashikuara në legjislacionin tatimor, bllokim deri në heqje të licencës për një periudhë gjashtëmujore për këta përkthyes referuar dispozitave të mësipërme. Në këtë rast organet tatimore hipotetikisht duhet ti drejtoheshin vet MD për zbatimin e këtyre masave. Pra shihet qartë se pagesa e drejtpërdrejtë ndaj individëve referuar dispozitave të mësipërme, por jo vetëm, paraqesin mospërputhje të plotë me legjislacionin në tërësi.

c. Moment tjetër me rëndësi nga ana jonë lidhur me përkthimet e akteve është siguria mbi dokumentacionet e përkthyer nga operatorët e regjistruar dhe individët të cilët ndryshe nga subjektet e regjistruar janë më pak të shfaqur në aspekt të transparencës dhe veprimtarisë publike. Pavarësisht kësaj, mungesa e një sistemi rregullator lidhur me marrjen në dorëzim të dokumentacionit, në vlerësimin tonë e ka ekspozuar njësinë drejt risqeve të vazhdueshëm në këtë drejtim për të dy kategoritë e përkthyesve të kontraktuar.

Sa më lartë arrijmë në konkluzionin se, vlera prej **58,748,240 lekë** e shpenzuar nga ana e institucionit për shërbime përkthimi në përkthyes të paregjistruar nuk rezulton të ketë patur efektivitetin dhe efikasitetin e pritshme. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 63-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

1.1 Rekomandimi: Nga Ministria e Drejtësisë, të merren masat e nevojshme për ndërprerjen e shërbimeve të marra nga përkthyes të paregjistruar në organet fiskale, kjo në zbatim të dispozitave ligjore që rregullojnë, funksionimin e sistemit buxhetor, taksat dhe tatimet, si dhe për të shmangur diskriminimin e operatorëve ekonomikë kundrejt konkurrencës së pandershme.

Menjëherë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

1.2 Rekomandimi: Nga Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me organet përkatëse, të merren masat e nevojshme hartimin e një baze rregullative mbi përkthimin e dokumentacioneve të klasifikuara, me qëllim eliminimin e risqeve të mundshëm gjatë kësaj veprimtarie.

Menjëherë

2- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, Ministria e Drejtësisë vijon të paguajë pa të drejtë nga buxheti i vetë kostot e mirëmbajtjes për katër nga pesë sistemet të cilat janë në funksionim. Vetëm gjatë periudhës Janar-Tetor 2019 shpenzimet e mirëmbajtjes së tyre arrijnë shumën prej **5,862,400 lekë** ndërkohë që këto shpenzime duhet të ishin përballuar nga AKSHI. Në kontratën e mirëmbajtjes të lidhura midis MD dhe operatorit ekonomik fitues nuk janë reflektuar ende ndryshimet e parashikuara në pikën 18 dhe 19, dhe 24 të VKM nr. 673, datë 22.11.2017, “Për Organizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, e ndryshuar,

Mospërfundimi i procesit të transferimit të sistemeve pranë AKSHI-t referuar përcaktimeve ligjore në fuqi e kanë ekspozuar institucionin drejt shpenzimeve të panevojshme nga buxheti i vet lidhur me shpenzimet e mirëmbajtjes për këto sisteme por jo vetëm. Megjithëse dy nga pesë sistemet funksionale TI janë alokuar fizikisht tek AKSHI, ato vijojnë të reflektohen në regjistrin e aktiveve të Ministrisë së Drejtësisë, çka tregon mangësi dhe veprime të ngadalta nga ana e grupeve të punës të institucioneve respektive. Vlera e shpenzuar nga ana e institucionit për mirëmbajtjen e sistemeve TI, prej **5,862,400 lekë**, përbën një shpenzim të kryer, jo në përputhje me parimet e efektivitetit dhe efijencës. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 46-62 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

2.1 Rekomandimi: Institucioni të marrë masat e nevojshme, për hostimin e sistemeve IT pranë AKSHI-t referuar përcaktimeve të VKM nr. 673 datë 22.11.2017, e ndryshuar, duke dokumentuar plotësisht transferimin e tyre fizik dhe kontabël si dhe eliminimin e kostove të panevojshme nga buxheti i institucionit për shërbimet e mirëmbajtjes së tyre.

Menjëherë

3- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, pjesën më të madhe në zërin “shpenzime” ose rreth 33% e tyre, e zënë blerjet nëpërmjet sistemit dinamik të biletave të transportit ajror ndërkombëtar. Për vitin 2019, ky zë është parashikuar në vlerën 7,000,000 lekë dhe deri në periudhën 30.10.2019 (periudha objekt i auditimit) është realizuar në vlerën 5,634,090 lekë.

Në 07 (shtatë) procedura të audituara nga 32 gjithsej, me një vlerë shërbimi të paguar që shkon **2,464,643 lekë**, dokumentacioni bashkëlidhur praktikës nuk arrin të argumentoj numrin e nevojshëm për pjesëmarrje në këto takime/evante.

Në të gjitha rastet procedura realizohet në një afat shumë të shkurtër nga data e udhëtimit, duke sjellë si pasojë, mungesë të studimit të tregut rrjedhojë e afateve të limituara dhe rrit riskun e përzgjedhjes së çmimit më të lartë, pasi biletat e avionit bliheshin ditën e nisjes apo ditë të afërt me nisjen, kur edhe çmimet kapin nivelet e tyre të larta.

Mbi mungesën e argumentimit të numrit të pjesëmarrësve në procedurat e sistemit dinamik të blerjeve për bileta të transportit ndërkombëtar, Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 20468 prot, datë 11.11.2019, ka sjellë gjithashtu në vëmendje të Ministrisë së Drejtësisë shpenzimet për udhëtime dhe dieta, si dhe marrjen e masave të menjëhershme për kufizimin e numrit të pjesëmarrësve, pasi nga analiza e kryer nga kjo ministri mbi përdorimin e fondeve buxhetore vërehen rritje të konsiderueshme të nivelit të shpenzimeve në zërin udhëtime dhe dieta për periudhën Janar-Tetor 2019. Lidhur sa më sipër, evidenton nevojën për një qasje më të kujdesshme nga ana e hallkave përkatëse për përdorimin me ekonomikitet të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

fondeve shtetërore në këtë drejtim. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 37-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

3.1 Rekomandimi: Nga Titullari i Institucionit, të merren masa që pas ardhjes së ftesës nga organizatorët për takime/evente jashtë vendit, të nxirret menjëherë autorizimi i pjesëmarrjes në to, në mënyrë që të minimizohet risku i blerjes së biletave me çmim më të lartë si rezultat i kryerjes së procedurës së prokurimit në data të afërta me datën e nisjes së udhëtimit.

3.2 Rekomandimi: Të argumentohet numri i pjesëmarrësve në takime/vente të organizuara jashtë vendit në mënyrë që të optimizohet numri i tyre dhe për rrjedhojë dhe shpenzimet që kryhen për këtë qëllim.

Në vijimësi

VI. ANEKSE

Aneksi I - “Qasja dhe metodologjia e auditimit”

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

ANEKSI I
QASJA DHE METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Materialiteti

Përcaktimi i materialitetit sipas sasisë përfshin gjykimin mbi nivelin maksimal të pranueshëm të shmangies së përputhshmërisë me dispozitat ligjore, rregulloret. Ky materialiteti vlerësohet deri në 2% në nivel grupi dhe llogarie.

Një gabim/anomali është “material”, individualisht ose kur bashkohet me gabime/anomali të tjera, në qoftë se në mënyrë të arsyeshme mund të ndikojë në vendimet e marra nga drejtimi. Pagesat e kryera gjatë periudhës nën auditim sipas llogarive specifike paraqitet në total për vlerën 221,176 mijë lekë dhe materialiteti vlerësohet në nivelin e 4,423 mijë lekëve.

Në disa raste, gabimi edhe pse jo material nga ana sasiore, mund të shfaqet material për nga përmbajtja - duke ndikuar kështu në konkluzionet e auditimit. Çështjet që janë materiale nga natyra ose përmbajtja duhet të zbulohen; e megjithatë mbetet në gjykimin e KLSH-së, nëse për raste të veçanta këto parregullsi/gabime do të merren në konsideratë në raportin dhe opinionin e auditimit.

Përcaktimi i materialitetit nga *ana cilësore* “Një çështje ose grup çështjesh mund të jenë materiale ose për shkak të sasisë, natyrës (karakteristikave të brendshme) ose në varësi të kontekstit të tyre” të cilat do të lidhen me përputhshmërinë e veprimtarisë së institucionit vlerësohen materiale nga ana cilësore për vet impaktin real por dhe ndjeshmërinë publike të cilin ka veprimtaria e MIE.

Vlerësimi i riskut të auditimit

Të kuptuarit e strukturës së kontrollit të brendshëm të njësisë që auditohet, përcaktimi i drejtimeve kryesore të auditimit, Vlerësimin e përgjithshëm mbi ekzistencën dhe funksionimin e kontrollit të brendshëm me qëllim përcaktimin e nivelit të përgjithshëm të riskut të njësisë që auditohet.

Fazat:

Njohja e aktivitetit të subjektit me qëllim identifikimin dhe vlerësimin e riskut të brendshëm. Vlerësimi i sistemeve të Kontrollit të Brendshëm

Përcaktimi i Riskut të Zbulimit, është risku që audituesi nuk do të arrijë të zbulojë një shmangie, e cila nuk është korrigjuar nga vetë sistemet e kontrollit të brendshëm të subjektit.

KLSH aplikon Modelin e Sigurisë, që tregon se niveli i besueshmërisë rrjedh nga dy burime kryesore që janë: sistemet e kontrollit dhe testet thelbësore.

Si pikënisje shërben risku i brendshëm

Risku i brendshëm (jo i lartë = 0.6 dhe i lartë = 1.0)

Gjykohet dhe vlerësohet që në fazën e planifikimit dhe ushtrimit të auditimit të përputhshmërisë, se mund të kemi elementë materialë për vlerësimin e një risku të brendshëm, që lidhet me një nivel të mundshëm të shmangieve përsa i takon përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Gjykohet se ka elementë të **riskut të brendshëm**, që lidhen me procesin e vendimmarrjes, organizimin dhe funksionimin, kuadrin rregullator mbi të cilin ushtrohet veprimtaria por dhe madhësisë së saj risku i brendshëm paraprakisht vlerësohet **Jo i Lartë**.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “MINISTRINË E DREJTËSISË”

Risku i Kontrollit të brendshëm (I ulët = 0.15, I mesëm = 0.25, dhe I lartë = 1.0)

Bazuar në të dhënat paraprake kontrolli i brendshëm ekziston dhe ka të ngjarë të funksionojë në mënyrë efektive dhe të vazhdueshme gjatë periudhës nën auditim. Por bazuar në kompleksitetin e operacioneve të subjektit dhe natyrën e kompleksitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, risku që një anomali materiale mund të ndodhë dhe mund mos të parandalohet ose zbulohet dhe korrigohet në kohë nga sistemet e kontrollit të brendshëm paraprakisht vlerësohet në nivelin *I Mesëm*.

Risikut i zbulimit

Duke qenë se KLSH konsideron *Risikun e Auditimit* në masën 5% duke konsideruar një siguri auditimi prej 95% , *Risku i zbulimit* i përcaktuar mbi modelin e sigurisë.

Bazuar në informacionin paraprak metodologjia e auditimit vlerësohet të bazohet në përzgjedhjen me bazë risku, duke marrë në konsideratë ato kontrole që janë përkatës për objektivat e auditimit, ku rëndësi i jepet edhe gjykimin profesional të audituesit nëse një kontroll i veçuar ose në kombinim me të tjerë, është i përshtatshëm.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti si dhe dokumentacionin shoqërues dhe verifikimin e tyre. Konkretisht, mbi të dhënat e disponuara u aplikuan:

- teste të kontroleve për të verifikuar se si kanë funksionuar sistemet e kontrollit të brendshëm; dhe
- teste të detajeve.